



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 543 Akti

Nr. 597 Vendimi
Tiranë, më 12.12.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Suela Zhegu Kryesuese
Etleda Çiftja Relatore
Xhensila Pine Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prezencë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në datën 7.12.2022, ora 12:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mbylli seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Kudusi Shahu**, me detyrë prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** dhe nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, komisionere Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit Kudusi

Shahu, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Z. Kudus Shahu është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë¹, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).

2. Z. Kudus Shahu, bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.6.2020 me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Suela Zhegu, Etlea Çiftja dhe Alma Faskaj.

3. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; dhe, më pas, nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

4. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin e datës 22.6.2020, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të caktojë kryesuese të trupit gjykues komisioneren Suela Zhegu, të gjithë anëtarët të deklarojnë mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit, si dhe të fillojë hetimi administrativ i thellë dhe i gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit.

5. Në datën 8.7.2020, përmes postës elektronike², trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit për fillimin e procesit të rivlerësimit, mbi përbërjen e trupit gjykues dhe i kërkoi të deklaronte nëse gjendej në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues. Gjithashtu, Komisioni i kërkoi subjektit informacion shtesë, sipas pyetësorit standard.

6. Në përgjigje³ të tij, subjekti i rivlerësimit paraqiti në Komision përgjigjet për pyetësorin standard dhe nuk ka deklaruar kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

7. Komisioni, me vendimin e datës 3.10.2022, vendosi zëvendësimin me short të komisioneres Alma Faskaj me komisioneren Xhensila Pine, për shkak se komisionerja Faskaj mungonte në detyrë për arsye shëndetësore. Ky vendim iu njoftua subjektit të rivlerësimit përmes postës elektronike⁴, si dhe iu kërkua të deklaronte nëse gjendej në kushtet e konfliktit të interesit me

¹Në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

²Email datë 8.7.2020, ora 10:00, “Njoftim për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe kërkesë për informacion shtesë”.

³Email datë 27.7.2020, dorëzuar edhe fizikisht në Komision me nr. *** prot., datë 28.7.2020.

⁴Email datë 3.10.2022.

komisioneren Pine. Në përgjigje⁵ të tij, subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me komisioneren Xhensila Pine, sipas parashikimeve ligjore.

8. Trupi gjykues, me vendimin e datës 11.10.2022, vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit Kudus Shahu vetëm për kriterin e pasurisë, bazuar në relativimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, sipas ligjit nr. 84/2016 dhe të drejtën për të paraqitur prova/shpjegime me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; si dhe (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe me afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta.

9. Në datën 12.10.2022, përmes postës elektronike⁶, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht vetëm për kriterin e pasurisë; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën; si dhe (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative. Në këtë njoftim subjektit iu kërkua të paraqiste edhe shpjegime brenda datës 25.10.2022.

10. Subjekti, me anë të postës elektronike⁷, i kërkoi Komisionit shtyrjen e afatit të datës 25.10.2022, që i është dhënë për të paraqitur prova dhe shpjegime në lidhje me rezultatet e hetimit, për dy nga pikat e prekura në rezultatet e hetimit kryesisht administrativ, që kanë të bëjnë marrjen e dokumentacionit të kërkuara në institucionet e huaja, përkatësisht në Mbretërinë e Bashkuar në lidhje me shtetasin B. H. Sh. Në përgjigje, Komisioni, me anë të postës elektronike⁸, njoftoi subjektin se mund t'i paraqesë shpjegimet dhe provat brenda datës 2.11.2022.

11. Në datën 25.10.2022 subjekti paraqiti pretendimet me shkrim dhe dokumentacionin justifikues, bashkëlidhur pretendimeve në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht për kriterin e rivlerësimit të pasurisë, me anë të postës elektronike⁹ dhe depozitimit në protokoll¹⁰ pranë Komisionit.

12. Më tej, Komisioni, me anë të postës elektronike¹¹, njoftoi subjektin e rivlerësimit se trupi gjykues vendosi ta ftojë për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore lidhur me rezultatet e hetimit për vlerësimin e pasurisë, në datën 2.11.2022, ora 10:00, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative.

13. Pas seancës dëgjimore të datës 2.11.2022, subjekti ka vijuar të paraqesë pranë Komisionit dokumentacionin provues lidhur me kriterin e pasurisë¹².

⁵Email datë 3.10.2022.

⁶Email datë 12.10.2022, "Komisioni – Njoftim mbi përfundimin e hetimit kryesisht mbi procesin tuaj të rivlerësimit".

⁷Email datë 24.10.2022.

⁸Email datë 26.10.2022.

⁹Email datë 25.10.2022.

¹⁰Shpjegime shtesë lidhur me relacionin e rezultateve të hetimit kryesisht për kriterin e rivlerësimit të pasurisë (nr. *** prot., datë 28.10.2022, në Komision).

¹¹Email datë 31.10.2022, "Ftesë për t'u dëgjuar në seancën dëgjimore publike për procesin tuaj të rivlerësimit".

¹²Protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 3.11.2022 dhe nr. *** prot., datë 21.11.2022.

14. Pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancën e datës 2.11.2022 dhe pasi u njoh me kërkesën e tij për çeljen e hetimit administrativ për dy kriteret e tjera të rivlerësimit, atë të figurës dhe aftësive profesionale, Komisioni, me vendimin e datës 3.11.2022, vendosi: (i) të çelë hetimin edhe për dy kriteret e tjera të rivlerësimit, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale; si dhe (ii) të shtyjë vazhdimin e seancës dëgjimore për shpalljen e vendimit, të njoftuar në datën 4.11.2022, ora 9:45, deri në përfundimin e hetimit kryesisht për kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

15. Komisioni njoftoi me anë të postës elektronike¹³ subjektin e rivlerësimit në lidhje me vendimin për shtyrjen e seancës dëgjimore të datës 4.11.2022 dhe çeljen e hetimit kryesisht për kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

16. Më tej, me vendimin e datës 18.11.2022, Komisioni vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit Kudus Shahu për kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, sipas ligjit nr. 84/2016 dhe të drejtën për të paraqitur prova/shpjegime me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40, të Kodit të Procedurave Administrative; si dhe (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe me afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta.

17. Në datën 18.11.2022, përmes postës elektronike¹⁴, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht lidhur me kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën; si dhe (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative. Në këtë njoftim subjektit iu kërkuua të paraqiste edhe shpjegime brenda datës 2.12.2022.

18. Në datën 2.12.2022 subjekti depozitoi pranë protokollit¹⁵ të Komisionit pretendimet me shkrim dhe dokumentacionin justifikues, bashkëlidhur pretendimeve në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht për kriterin e rivlerësimit të figurës dhe aftësive profesionale, si dhe dokumente shtesë lidhur me kriterin e rivlerësimit të pasurisë.

19. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka vijuar të paraqesë shpjegime dhe dokumente provuese lidhur me kriterin e rivlerësimit të pasurisë përmes postës elektronike¹⁶ në datat 3.12.2022 dhe 4.12.2022, si dhe nëpërmjet depozitimit në protokollin¹⁷ e Komisionit.

20. Komisioni, me anë të postës elektronike¹⁸, njoftoi subjektin e rivlerësimit se trupi gjykues vendosi ta ftojë për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore lidhur me rezultatet e hetimit për vlerësimin

¹³Email datë 3.11.2022, ora 15:48.

¹⁴Email datë 18.11.2022, "Komisioni – Njoftim mbi përfundimin e hetimit kryesisht mbi procesin tuaj të rivlerësimit".

¹⁵Shpjegime shtesë lidhur me relacionin e rezultateve të hetimit kryesisht për kriterin e rivlerësimit të figurës dhe të aftësive profesionale (protokolluar me nr. *** prot., datë 2.12.2022, në Komision).

¹⁶Email datë 3.12.2022 dhe datë 4.12.2022.

¹⁷Shkresë nr. *** prot., datë 5.12.2022.

¹⁸Email datë 5.12.2022, "Ftesë për seancë dëgjimore lidhur me procesin tuaj të rivlerësimit për kriterin e figurës dhe profesionalizmit".

e kontrollit të figurës dhe aftësitë profesionale, në datën 7.12.2022, ora 12:30, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative.

21. Bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Kudusi Shahu, bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

II. SEANCA DËGJIMORE

22. Në datën 2.11.2022 u zhvillua seanca e parë dëgjimore në prezencë të subjektit të rivlerësimit, si edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u paraqiti personalisht në seancë.

23. Relatori i çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ, të kryer mbi kriterin e rivlerësimit të pasurisë dhe të kaluara si barrë prove apo për shpjegime.

24. Z. Kudusi Shahu, pasi dëgjoji relacionin, shprehu qëndrimin e tij, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe kërkoi nga trupi gjykues çeljen e hetimit administrativ edhe për kriterin e kontrollit të figurës dhe atë të vlerësimit të aftësive profesionale.

25. Në përfundim të seancës dëgjimore të datës 2.11.2022, subjekti i rivlerësimit Kudusi Shahu kërkoi çeljen e hetimit për kriterin e kontrollit të figurës dhe atë të vlerësimit të aftësive profesionale.

26. Më pas, në datën 7.12.2022 u zhvillua seanca e dytë dëgjimore lidhur me rezultatet e hetimit administrativ për kriterin e kontrollit të figurës dhe atë të vlerësimit të aftësive profesionale në prezencë të subjektit të rivlerësimit, si dhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

27. Relatori i çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ të kryer për kriterin e kontrollit të figurës dhe atë të vlerësimit të aftësive profesionale të kaluara si barrë prove apo për shpjegime.

28. Z. Kudusi Shahu, pasi dëgjoji relacionin, shprehu qëndrimin e tij, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit Kudusi Shahu kërkoi konfirmimin në detyrë.

29. Seanca dëgjimore e datës 7.12.2022 u ndërpre, për të rifilluar në datën 12.12.2022 për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

30. Subjekti i rivlerësimit Kudusi Shahu ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

31. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016.

32. Sipas krerëve IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016: (i) ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror; (ii) DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjekti të rivlerësimit; dhe (iii) KLP-ja është organi ndihmës për vlerësimin profesional, i cili në përfundim të shqyrtimit të dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të pesë dokumenteve të përzgjedhura sipas një sistem objektiv dhe rastësor, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

33. Referuar vendimit nr. 2/2017¹⁹ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

34. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Kudus Shahu, i cili është bërë subjekt deklarues në këtë institucion në vitin 2003 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

35. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave privatë për periudhën 2003 – 2016 dhe në datën 26.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting* 2017. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin dhe ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

36. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat

¹⁹“Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5 të nenit 179/b të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: ‘Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit’. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë’. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: ‘Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse’”.

e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting* 2017; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë në ILDKPKI për vitet 2003 – 2016; (ç) provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) deklaramet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; si dhe (dh) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit e, në vijim, shpjegimet në seancë dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

37. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; si dhe (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

Personat e lidhur apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit që janë hetuar

38. Për efekt të procesit të rivlerësimit, personat që janë hetuar si të lidhur, apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, janë si vijon: (1) E. Sh., bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit – konsiderohet person i lidhur; (2) D. Sh., e bija e subjektit të rivlerësimit – konsiderohet person i lidhur; (3) D. Sh., i biri i subjektit të rivlerësimit – konsiderohet person i lidhur; (4) N. Sh., i biri i subjektit të rivlerësimit – konsiderohet person i lidhur; (5) B. Sh., vëllai i subjektit të rivlerësimit – konsiderohet person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit për shkak të kontributit në pasuritë e subjektit, banesë në rrugën “****” dhe apartament në ***, Kavajë, në vlerën 27.000 euro; (6) F. K. – konsiderohet person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit për shkak të dhënies hua të shumës 5.000.000 lekë në vitin 2006; (7) B. H. – konsiderohet person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit për shkak të dhënies hua të shumës 30.000 euro në vitin 2009; (8) H. Sh. e N. Sh., prindërit e subjektit të rivlerësimit dhe H. B., babai i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit – për kontributin në vlerën 5.000 euro në blerjen e garazhit në Tiranë.

Pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratën e pasurisë *Vetting* 2017 nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur

1. Tokë arë me sipërfaqe 600 m², në *, Tiranë, me vlerë 600.000 lekë**

1.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar tokë arë me sip. 600 m², në ***, Tiranë, me vlerë 600.000 lekë. Si burim krijimi subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursimet nga paga e tij dhe e bashkëshortes ndër vite. Për vërtetimin e deklarimeve subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues²⁰.

²⁰Dokumentet e pronësisë: certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, për tokë arë me sip. 600 m², në ***, Tiranë, z. k. ***, nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, në emër të z. Kudusi Shahu; kartelë e pasurisë së paluajtshme, datë regjistrimi 8.7.2002 dhe shumë të paguar 600.000 lekë, në emër të z. Kujdesi Shahu; kontratë shitjeje për tokë arë me nr. ***, datë 17.6.2002; hartë treguese e regjistrimit; vërtetim datë 19.9.2011, nga noter A. J. V. dhe deklaratë e ish-noterit J. V., për kontratë nr. ***, datë 17.6.2002, sipas së cilës z. Kujdesi Shahu është Kudusi Shahu.

Të ardhurat nga paga: vërtetim nr. *** prot., datë 17.10.2016, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës; vërtetim nr. *** prot., datë 24.10.2016, i Prokurorisë së Përgjithshme; vërtetim nr. *** prot., datë 25.10.2016, i Prokurorisë së Përgjithshme; vërtetim i datës 13.1.2017, i Prokurorisë së Rrethit Tiranë; vërtetim nr. *** prot., datë 21.10.2016, i Prokurorisë

1.2. Nga dokumentacioni i administruar nga ASHK Kamëz-Vorë²¹ rezulton se me kontratën e shitjes nr. ***, datë 17.6.2002, subjekti ka blerë nga shtetasit B. M., K. M. dhe M. M. pasurinë e llojit “arë”, me sip. 600 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, kundrejt shumës 600.000 lekë²². Në kontratë shitësit kanë pohuar se çmimi i shitjes është paguar plotësisht jashtë zyrës noteriale dhe nuk kanë ndonjë pretendim. Referuar kartelës së pasurisë së paluajtshme të datës 4.9.2020, subjekti figuron pronar i pasurisë nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, në ***, Tiranë, ku në seksionin “D” pasqyrohet regjistrimi nr. dok. ***, datë 22.4.2020, me përshkrimin “Mbi këtë pasuri pozicionohet ndërtesa nr. ***, vol. ***, f. ****” dhe shënimi “L. Leg”.

1.3. Nga verifikimi i kartelës së pasurisë së paluajtshme të administruar nga sistemi elektronik i ASHK-së²³ rezulton se pasuria nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, është në pronësi të shtetasit S. S. J., ku në seksionin “C” konstatohet shënimi “Kjo ndërtesë pozicionohet mbi pasuritë ***, vol. ***, f. ****; nr. ***, vol. ****; ***, vol. ***, f. ****; ***, vol. ***, f. ****”. Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 1²⁴, i kërkoi subjektit të shpjegojë lidhjen që ka me shtetasin S. S. J. dhe arsyen e blerjes së pasurisë nr. ***, z. k. ***, në vitin 2002, në kushtet kur kjo pasuri ishte e zënë nga objekti i ndërtuar nga shtetasi i mësipërm.

1.4. Në përgjigje²⁵ të tij, subjekti deklaroi se nuk ka asnjë lidhje me këtë shtetas. Lidhur me informacionin e ASHK-së se mbi këtë pasuri pozicionohet ndërtesa nr. **** në pronësi të shtetasit S. J., shpjegon se ky është një gabim i ASHK-së, pasi referuar hartës treguese të pronës nr. ***, prona me nr. *** është pronë kufitare me pronën e trashëguar dhe sipas tij edhe ndërtesa me nr. *** shtrihet mbi pasurinë nr. ****. Gjithashtu, shpjegon se prona nr. *** është e lirë dhe në posedimin e tij dhe nuk ka asnjë ndërtim mbi to. Për vërtetimin e deklaratimit subjekti ka paraqitur dokumentacionin provues²⁶.

1.5. Në shkresën e datës 7.7.2022, ASHK Kamëz-Vorë sqaron subjektin e rivlerësimit se nga përputhja e planit të rilevimit të paraqitur nga subjekti, që reflekton gjendjen faktike të pasurisë me HTR të zyrës, rezulton mospërputhje grafike dhe në pozicionin gjeografik. Nga kjo mospërputhje rezulton që objekti nr. ***, vol. ***, f. *** nuk është në pozicionin gjeografik sipas faktit. Gjithashtu, ASHK-ja sqaron se saktësimet dhe përmirësimet hartografike janë në proces të vazhdueshëm.

1.6. Gjithashtu, subjekti përcolli edhe koordinatat e kësaj pasurie dhe nga verifikimi i pamjeve në *google earth* konstatohet se mbi këtë parcelë nuk ka ndërtesë. Sa më lart, provohet se objekti i ndërtuar nga shtetasi S. J. nuk ndodhet në tokën e blerë nga subjekti.

1.7. Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e interesit të subjektit me shtetasit B. M., K. K. (M.) e M. K. (M.), nga i cili rezultoi se subjekti nuk ishte në kushtet e konfliktit të interesit²⁷.

pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda; vërtetim nr. *** prot., datë 23.1.2017, i Ministrisë së Mirëqenies Sociale lidhur me pagat *bruto* dhe *neto* të shtetases E. Sh. për periudhën 1.5.1999 – 31.12.2016.

²¹Shkresë nr. *** prot., datë 8.9.2020.

²²Sipas VKM-së Nr. ***, “Për miratimin e çmimeve për trojet urbane brenda vijës së verdhë, për trojet në qytetet dhe komunat, ku investimet nuk janë rentabël, tokën bujqësore, tokën pyjore, livadhet dhe kullotat, për qarqet e Fierit, të Elbasanit, Tiranës, Vlorës, Durrësit dhe Shkodrës” (f. 82) rezulton që çmimi i tokës bujqësore në fshatin *** për m² ishte 461 lekë.

²³Kartela e pasurisë së paluajtshme nr. ***, vol. ***, f. ***, datë 20.5.2022.

²⁴Email datë 21.6.2022.

²⁵Protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.7.2022.

²⁶Shkresë e datës 7.7.2022, e ASHK Kamëz-Vorë, e nënshkruar elektronikisht; planet e rilevimit të pasurive nr. *** dhe nr. ***, z. k. ***; fotografim ajror nga *google earth*.

²⁷Shkresë nr. *** prot., datë 22.6.2022, e Prokurorisë së Posaçme; shkresë nr. *** prot., datë 16.6.2022, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; shkresë nr. *** prot., datë 28.9.2022, e Prokurorisë së Përgjithshme.

1.8. Pas trajtimit dhe arsyetimit të pretendimeve të subjektit, të trajtuara me detaje në vijim të këtij vendimi, të cilat ndikuan në analizën financiare për periudhën 1993 – 2003, të paraqitur në paragrafin 3.65, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie.

1.9. Në përfundim, në lidhje me këtë pasuri, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin nr. 84/2016, si dhe ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e saj.

2. Truall me sipërfaqe 298,3 m² në Tiranë, me vlerë 1.200.000 lekë

2.1. Në deklaratën *Vetting* 2017 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar tokë truall (të banesës) në rrugën “***”, me sip. 298,3 m² (kontratë nr. ***, datë 19.1.2001, truall z. k. ***, me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***), me vlerë 1.200.000 lekë, në bashkëpronësi me familjen. Si burim krijimi subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursimet nga paga e tij për vitet 1991 – 2003 dhe të bashkëshortes për vitet 1999 – 2003. Për vërtetimin e deklarimeve subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues²⁸.

2.2. Nga dokumentacioni i administruar nga ASHK Tirana Veri²⁹ rezulton se sipas kartelës së pasurisë së paluajtshme të datës 21.9.2020, subjekti është pronar i pasurisë truall me nr. pasurie ***, z. k. ***, Tiranë, me sip. 298,3 m², nga të cilat 110,3 m² ndërtesë³⁰. Referuar dokumentacionit të origjinës së regjistrimit rezulton se në kontratën e shitjes nr. ***, datë 19.2.2001³¹, pasqyrohet se shtetasit O. K. etj.³² janë pronarë të një sipërfaqeje trualli të lirë prej 2.996,5 m², nga e cila i shesin blerësit Kudus Shahu truallin me sip. 302,6 m² me çmimin e shitjes 1.200.000 lekë, shumë e cila është likuiduar nga palët jashtë zyrës noteriale.

2.3. Në praktikën e legalizimit të objektit “godinë banimi 2 kate + papafingo + bodrum” në pronësi të subjektit, të administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e ASHK-së³³, konstatohet dokumenti “kontratë sipërmarrjeje për ndërtim në pronën e pronarit”, datë 16.10.1997, i lidhur ndërmjet inxhinierit A. J., në cilësinë e sipërmarrësit, dhe subjektit, në cilësinë e “investitorit dhe pronarit të truallit”, ku përcaktohet se: *“Kudusi Shahu është pronar i një sipërfaqe toke 302,6 m², e ndodhur në rrugën ‘***’, Tiranë. Pronësia e mësipërme vërtetohet me kontratën e shitblerjes së truallit. Pronari i truallit vë në dispozicion të sipërmarrësit pronën e mësipërme për të ndërtuar shtëpi banimi 2 kate + nënçati, me sipërfaqe 100 m²”*.

2.4. Për të saktësuar këtë situatë, Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 1³⁴, i kërkoi subjektit të saktësonte vitin e blerjes së truallit, si dhe të paraqiste dokumentacion provues. Në përgjigje³⁵ të tij, subjekti deklaroi se në vitin 1997 është dakordësuar me pronarët e truallit për pozicionin e parcelës dhe çmimin e shitjes dhe po në këtë vit ka filluar procedurën për pajisjen me certifikatë pronësie të pronarëve të truallit, pasi kishin parregullsi në dokumentacionin pranë ZVRPP-së. Në vijim deklaroi se ka filluar likuidimin e çmimit të blerjes në mënyrë të pjesshme

²⁸Certifikatë për vërtetim pronësie datë 5.5.2015, e pasurisë me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, e llojit “truall”, me sip. 298,3 m², nga të cilat 110,3 ndërtesë, në emër të z. Kudus Shahu; kartelë e pasurisë së paluajtshme nr. ***, z. k. ***, Tiranë; kontratë shitjeje nr. ***, datë 19.2.2001.

²⁹Shkresë nr. *** prot., datë 7.10.2020.

³⁰Gjithashtu pasqyrohet shënimi “Godinë banimi 2 kate + papafingo + bodrum” dhe me aplikimin nr. ***, datë 15.3.2012 është bërë rivlerësimi i pasurisë në shumën 36.425.345 lekë (objekti është trajtuar në pikën 3).

³¹Administruar edhe nga notere M. Ll. me shkresën e datës 11.4.2022.

³²Shtetasit Q. K., L. K., N. L., N. K., M. Ç., F. Ç., M. K., L. S., B. Ç., H. L., E. Xh., I. L., M. L., H. L. dhe R. L..

³³Shkresë nr. *** prot., datë 18.5.2022.

³⁴Email datë 21.6.2022.

³⁵Protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.7.2022.

dhe likuidimi total ka përfunduar në momentin e lidhjes së kontratës nr.***, datë 19.2.2001. Gjithashtu, subjekti shpjegoi se në datën 16.10.1997, me qëllim plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për pajisjen me leje ndërtimi, ka lidhur kontratën për drejtimin teknik dhe zbatimin e punimeve me të ndjerin A. J.. Për vërtetimin e deklarimeve subjekti ka paraqitur dokumentacionin provues³⁶.

2.5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti rezulton se në deklaratën noteriale nr. *** rep., datë 16.10.2000, shtetasit M. Ç. dhe N. K. kanë deklaruar se si përfaqësues të bashkëpronarëve, në datën 16.10.2000 morën nga z. Kudusi Shahu shumën 7.200 USD në lidhje me blerjen nga ana e këtij të fundit të një trualli që ndodhet në Tiranë në rrugën “****” dhe rrugën “****”, me sip. 302,6 m² dhe diferencën prej 120.000 lekësh z. Kudusi Shahu do ta likuidonte me lidhjen e kontratës. Kjo deklaratë noteriale është nënshkruar edhe nga subjekti.

2.6. Në kushtet kur subjekti në atë kohë ushtronte funksionin e prokurorit, Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e interesit të subjektit me shitësit e truallit, nga i cili rezultoi se nuk ishte në kushtet e konfliktit të interesit³⁷.

2.7. Për sa i përket reflektimit në analizën financiare të çmimit të blerjes së truallit në vitin kalendarik përkatës, Komisioni u bazua në dokumentacionin ligjor, konkretisht në kontratën e shitblerjes nr. *** dhe në deklaratën noteriale nr. *** dhe, për pasojë, pasqyroi vlerën 1.080.000 lekë³⁸ si pagesë e kryer në datën 16.10.2000 dhe vlerën 120.000 lekë si pagesë e kryer në datën 19.2.2001.

2.8. Në vijim, Komisioni kreu analizën financiare për periudhën gusht 1997 – shkurt 2001³⁹, duke marrë në konsideratë: (i) të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij⁴⁰; (ii) shpenzimet e jetesës⁴¹; (iii) shpenzimet për pagesën e EKB-së për blerjen e apartamentit në rrugën “****”⁴²; dhe (iv) shpenzimet për blerjen e tokës truall, nga ku rezultoi një mungesë burimesh të ligjshme financiare në vlerën 803.545 lekë për blerjen e truallit dhe kryerjen e shpenzimeve gjatë periudhës gusht 1997 – shkurt 2001.

2.9. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi barrën e provës dhe i kërkoi subjektit të rivlerësimit të paraqesë shpjegime në lidhje me konstatimin se *subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën 803.545 lekë për blerjen e truallit dhe kryerjen e shpenzimeve gjatë periudhës gusht 1997 – shkurt 2001.*

³⁶Kopje të kontratës nr. ***, datë 19.2.2001; deklaratë noteriale nr. *** rep., datë 16.10.2000.

³⁷Shkresë nr. *** prot., datë 22.6.2022, e Prokurorisë së Posaçme; shkresë nr. *** prot., datë 16.6.2022, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; shkresë nr. *** prot., datë 28.9.2022, e Prokurorisë së Përgjithshme.

³⁸Përlllogaritur si diferencë e vlerës 1.200.000 lekë me 120.000 lekë të paguara me lidhjen e kontratës (përafrohet me kursin e këmbimit të kohës për valutën USD, datë 17.10.2000, 1 USD = 149,80 lekë).

³⁹Duke konsideruar që deri në fund të korrikut të vitit 1997 vërehet balancë negative, referuar trajtimit në pikën 14.10 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht).

⁴⁰Për subjektin: vërtetim nr. ***, datë 25.10.2016, nga Prokuroria e Përgjithshme; dhe vërtetim datë 13.1.2017, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Për bashkëshorten: vërtetim nr. ***, nga DRFPP-ja Tiranë.

⁴¹(i) 66% e të ardhurave për periudhën 1994 – 1999; (ii) bazuar në shkresën nr. *** prot., datë 4.3.2019, të ILDKPKI-së për periudhën 2000 – 2016. Në mungesë të të dhënave, për vitin 2001 u konsiderua vlera e vitit paraardhës (108.000 lekë/vit për person), ndërsa vlera për vitin 2007 është saktësuar sipas shkresës nr. *** prot., datë 27.5.2008, të INSTAT-it drejtuar ILDKPKI-së (174.072 lekë/vit për person). Në vitin e lindjes së fëmijëve u konsideruan vetëm muajt që nga muaji i lindjes deri në fund të vitit.

⁴²Referuar trajtimit në pikën 13 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

2.10. Në përgjigje⁴³ të rezultateve të hetimit kryesisht, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar pretendimet e tij lidhur me disa elemente që ndikojnë këtë analizë financiare, të trajtuara në vijim.

2.11. Konkretisht, subjekti ka pretenduar që Komisioni, për efekt të analizës financiare: (i) duhet të marrë në konsideratë edhe të ardhurat e subjektit që nga viti 1991 dhe jo që nga viti 1993, siç ka vepruar Komisioni, bazuar kjo në publikimet e Bankës së Shqipërisë⁴⁴; (ii) duhet të zvogëlojë vlerën e shpenzimeve të jetesës, duke mos përllogaritur shpenzime për periudhën 1991 – 1992⁴⁵, si dhe të saktësojë shpenzimet për periudhën në vijim, konkretisht për periudhën janar 1993 – shkurt 1995⁴⁶ të përllogariten në masën 30% të të ardhurave dhe për periudhën mars 1995 – dhjetor 1999⁴⁷ të përllogariten në masën 40% të të ardhurave; (iii) duhet të përfshijë në analizën financiare mbështetjen financiare nga ana e prindërve të subjektit, të cilët rreth vitit 1997 - 1998 i kanë kaluar një pjesë të kursimeve të tyre, rreth 5.000 USD, për ta ndihmuar ekonomikisht në përballimin e shpenzimeve për jetesë në kushtet kur subjekti kishte shpenzime lidhur me investimin që po kryente për ndërtimin e shtëpisë; (iv) të mbahet në konsideratë që nga ana e subjektit janë krijuar kursime në monedhën USD në mënyrë periodike, çka afekton pasqyrimin në analizën financiare të vlerës në lekë të pagesës së kështit të parë prej 7.200 USD për truallin, vlerë e cila sipas subjektit duhet të jetë 751.200 lekë dhe jo 1.080.000 lekë, siç është përllogaritur nga Komisioni⁴⁸; (v) të konsiderojë shpjegimet dhe provat e paraqitura lidhur me automjetin tip “Renault” me targa *** (trajtuar në pikën 14 të këtij vendimi).

2.12. Në përfundim, referuar përllogaritjeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit për periudhën gusht 1991 – 19.2.2001, subjekti dhe personat e lidhur rezultojnë me një balancë pozitive prej 1.045.211 lekësh⁴⁹ për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive.

⁴³(i) Parashtrime të protokolluara me nr. *** prot., datë 28.10.2022 dhe me email-in datë 25.10.2022; dhe (ii) parashtrime të protokolluara me nr. *** prot., datë 5.12.2022 dhe me email-in datë 3.12.2022 dhe datë 4.12.2022.

⁴⁴Subjekti ka pretenduar: “Ndërkohë që po t’i referohemi edhe publikimit të Bankës së Shqipërisë https://www.bankofalbania.org/Botime/Botime_Periodike/Raporti_Vjetor/Raporti_Vjetor_1995.html, citohet specifikisht ‘Krahasuar me fundin e vitit 1992 aftësia e shqiptarëve për të kursyer vlerësohet të ishte më e madhe. Sipas disa përllogaritjeve të përafërta supozohet se përqindja e kursimeve të popullatës në fund të vitit 1995 të jetë rreth 34% nga 29% që ishte në fund të vitit 1992’. Ky raport është arritur në bazë të supozimit se të ardhurat gjatë kësaj periudhe janë rritur 6.5 herë dhe se pesha e të ardhurave nga pagat është e njëjtë”.

⁴⁵Subjekti ka deklaruar: “Gjatë kohës që kam punuar në Prokurorinë e Kukësit kam jetuar pranë familjes time e cila jetonte në Kukës dhe shpenzimet e jetesës kanë qenë zero, duke realizuar kursim total të të ardhurave nga paga”.

⁴⁶Subjekti ka deklaruar: “Ndërkohë që në kohën kur ushtrija detyrën në Prokurorinë e Përgjithshme dhe vijoja të isha me status beqar dhe i pastrehë jam akomoduar në zyrën e punës deri në momentin që u trajtova me banesë nga Enti Kombëtar i Banesave, ku në datën 8.2.1995 është lidhur kontrata provizore për shitje apartamenti midis Kudusi Shahu, në cilësinë e palës blerëse, dhe Entit Kombëtar të Banesave, në cilësinë e palës shitëse”. Me parashtrimet nr. *** prot., datë 21.11.2022, në cilësinë e provës subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. ***, datë 10.11.2022, të shtetasit Th. J. dhe deklaratën noteriale nr. ***, datë 10.11.2022, të shtetasës P. E..

⁴⁷Subjekti ka shpjeguar se përllogaritja e shpenzimeve në masën 66% të të ardhurave, siç shprehet Kolegji, do të merrte kuptim për pagat të cilat do të shkonin përafërsisht në vlerën 800 USD/vit, ndërkohë që paga e tij në vit e kalon shumën 800 USD. Përllogaritja e shpenzimeve duhej të bëhej në masën 40%, ashtu siç ka orientuar Kolegji për një analizë garantiste, në mungesë të të dhënave të sakta zyrtare apo të dhënave domethënëse kërkimore, vijoi subjekti.

⁴⁸Subjekti ka deklaruar: “Në analizën e kryer janë mbajtur në konsideratë që nga ana ime në mënyrë periodike janë krijuar kursime në monedhën USD. Kujtoj që, që në vitin 1995, nga ana ime kam pasur gjendje në USD në shumën rreth 2.500 USD. Në fund të vitit 1997 kam pasur rreth 5.200 USD. Përmend këtë fakt për të sqaruar që në analizën financiare të kryer nga ekspertët e Komisionit blerja e tokës në shumën 1.200.000 lekë është përllogaritur si pagesa e shumës prej 7.200 USD dhe e diferencës prej 120.000 lekësh. Në këtë rast kursi i këmbimit të dollarëve për blerjen e tokës në shumën 7.200 USD nga Komisioni është bërë me kursin 150 lekë/1 USD. Ky kurs është shumë i lartë dhe afekton analizën financiare në një shumë të konsiderueshme, ndërkohë që referuar publikimeve të Bankës së Shqipërisë në lidhje me kursin e këmbimit përgjatë vitit 1995, kursi fillon me 94,77”.

⁴⁹Referuar tabelës së paraqitur me parashtrime të protokolluara me nr. *** prot., datë 5.12.2022. Në këtë tabelë vërehet se pagat për periudhën janar – shkurt 1995, në vlerën 43.384 lekë, janë paraqitur edhe më vete, edhe si pjesë e të ardhurave për periudhën mars – dhjetor 1995.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

2.13. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore – arsyeton se:

2.14. *Pretendimi i subjektit për të përfshirë në analizën financiare të ardhurat nga paga për periudhën gusht 1991 – dhjetor 1992 nuk mund të pranohet nga Komisioni, në kushtet e arsyetimit të përdorur nga Kolegji i Posaçëm i Apelit në funksion të një qëndrimi orientues në vendimin nr. 15-2021, datë 18.6.2021. Për më tepër, Komisioni çmon se shuma totale e të ardhurave nga paga për këtë periudhë prej 20.625 lekësh është në një masë të tillë që nuk mund ta përmbysë rezultatin përfundimtar.*

2.15. *Lidhur me pretendimin e subjektit sa i përket zvogëlimit të vlerës së shpenzimeve të jetesës, Komisioni analizoi të ardhurat nga paga e subjektit në kuadër të arsyetimit të përdorur nga Kolegji i Posaçëm i Apelit⁵⁰ dhe konstatoi se shuma vjetore e të ardhurave nga pagat e subjektit është dukshëm më e lartë se 800 USD dhe, për rrjedhojë, e konsideron të bazuar pretendimin e subjektit. Në këto kushte, Komisioni ripërlllogariti shpenzimet e jetesës në një shumë prej 830.753 lekësh për periudhën 1993 – 1999⁵¹.*

2.16. *Për sa i përket pretendimit të subjektit për përfshirjen në analizën financiare të vlerës 700.000 lekë (5.000 USD) si mbështetje financiare nga prindërit e tij, Komisioni vëren se kjo e ardhur është pretenduar për herë të parë vetëm pas kalimit të barrës së provës dhe nuk është deklaruar në seksionin e të ardhurave në deklaratën *Vetting*. Për pasojë, ky pretendim u konsiderua i pabazuar.*

2.17. *Pretendimi i subjektit se shuma 7.200 USD është krijuar në mënyrë periodike dhe konvertimi nga lekë në USD është kryer vite më parë, konsiderohet i pabazuar nga Komisioni. Referuar publikimeve të Bankës së Shqipërisë, kursi i këmbimit në datën e lidhjes së kontratës së shitjes ka qenë 1 USD = 149,80 lekë dhe, për rrjedhojë, ekuivalenti i pagesës 7.200 USD në datën e lidhjes së kontratës ka qenë 1.078.560 lekë, pra në vlerë të përafërt me atë të përlllogaritur nga Komisioni. Kjo shpjegon edhe çmimin prej 1.200.000 lekësh të pasqyruar në kontratën e shitjes, e cila është lidhur në datën 19.2.2001, pra pas kryerjes së pagesës prej 7.200 USD. Për rrjedhojë, në analizën financiare, çmimi total i blerjes së kësaj pasurie mbeti në vlerën 1.200.000 lekë, në përputhje me kontratën e shitjes..*

2.18. *Në përfundim të analizimit të pretendimeve të mësipërme dhe pas arsyetimit lidhur me automjetin tip “Renault” (trajtuar në pikën 14 të këtij vendimi), u krye analiza e re financiare për periudhën 1993 – 9.2.2001, nga ku rezultoi një balancë negative prej 53.762 lekësh⁵², e vlerësuar nga Komisioni si një vlerë e papërfillshme, duke konsideruar periudhën e gjatë të përfshirë në analizë.*

⁵⁰Vendim nr. 15-2021, datë 18.6.2021.

⁵¹40% e të ardhurave për këtë periudhë.

⁵²Referohuni tabelës së paraqitur në paragrafin 3.65 të këtij vendimi.

2.19. Si konkluzion, në lidhje me këtë pasuri, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin nr. 84/2016, si dhe ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e saj.

3. Banesë 2 kate + papafingo + bodrum, me sipërfaqe totale 436,1 m², në Tiranë, me vlerë 4.000.000 lekë

3.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar banesë në rrugën “****”, me leje legalizimi nr. ***, datë 3.3.2009, mbi truallin pika 2, me sipërfaqe ndërtimi 110,3 m², 2 kate + papafingo + bodrum, e ndërtuar mbi truallin në z. k. ***, nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***. Vlera: 4.000.000 lekë (nga rivlerësimi nr. ***, datë 15.3.2012, me shumë 36.425.345 lekë), në bashkëpronësi të familjes në pjesë të barabarta. Si burim krijimi subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: kursimet nga paga e tij në vitet 1991 – 2004 dhe të bashkëshortes nga viti 2004; shitjen e apartamentit në rrugën “****”, p. ***, shk. ***, ap. ***, në vlerën 2.000.000 lekë, që është përfituar nga EKB-ja Tiranë. Në seksionin e të dhënave konfidenciale, pasi përshkruan si burim të ardhurat në vitet 1991 – 2004 dhe shitjen e apartamentit në rrugën “****”, të përfituar nga EKB-ja në shumën 2.000.000 lekë, ka deklaruar se në ndërtimin e kësaj banese ka kontribuar në vlerë të papërcaktuar edhe vëllai i tij B. Sh. si rezultat i emigracionit në Greqi dhe Angli (pa kontratë, me deklaratë), i cili gjithashtu ka kontribuar edhe në arredimin dhe rregullimin e banesës në G., duke u bërë automatikisht bashkëpronar me marrëveshje në këtë apartament, duke shfrytëzuar bashkërisht sipas nevojave. Më tej, deklaroi se vlera e përgjithshme e kontributit si në ndërtimin e banesës së mësipërme dhe të asaj në G. arrin afërsisht 27.000 euro. Për vërtetimin e deklarimeve subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues⁵³.

3.2. Lidhur me periudhën e fillimit dhe përfundimit të ndërtimit të objektit, konstatohet se subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* 2017 vitin e fillimit dhe të përfundimit të punimeve të ndërtimit të banesës. Nga shqyrtimi i deklarimeve periodike vjetore, deklarimeve përpara ILDKPKI-së, si dhe atyre në pyetësin standard dhe në pyetësin nr. 1, Komisioni vëren se subjekti ka kryer deklarime kontradiktore lidhur me periudhën e ndërtimit të këtij objekti, pasi: (i) në DIPP-të vjetore e deklaroi si pasuri vetëm në vitin 2004 (dhe jo në vitin 2003); (ii) pranë ILDKPKI-së ka deklaruar se ndërtimi ka filluar në vitin 1997; (iii) në përgjigje të pyetësit standard⁵⁴ ka deklaruar se ndërtimi ka filluar në vitin 2001; (iv) në përgjigje të pyetësit nr. 1⁵⁵ ka deklaruar se banesa është ndërtuar gjatë periudhës 1997 – 2007.

3.3. Duke mos deklaruar kohën e fillimit dhe përfundimit të punimeve në deklaratën *Vetting* 2017, si dhe shpjegimet kontradiktore në deklaratat periodike vjetore dhe në pyetësorë për kohën e fillimit e të përfundimit të punimeve, kohë e cila hedh dritë për përcaktimin e momentit të krijimit të pasurisë, si një element i rëndësishëm për verifikimin e burimeve të krijimit të saj, Komisioni analizoi dokumentacionin e administruar për të qartësuar periudhën e ndërtimit të

⁵³Vërtetim nga dokumentet hipotekore datë 3.4.2012, për pasurinë nr. ***, z. k. ***, Tiranë, në emër të z. Kudusi Shahu; hartë treguese e regjistrimit të pasurisë nr. ***, z. k. ***; leje legalizimi nr. ***, datë 24.3.2009, në emër të z. Kudusi Shahu; kontratë shitjeje apartamenti nr. ***, datë 6.10.2004, nga EKB-ja; vërtetim nga dokumentet hipotekore në emër të EKB-së; hartë treguese e regjistrimit të pasurisë nr. ***, z. k. ***, Tiranë; kontratë shitjeje pasurie e paluajtshme nr. ***, datë 8.10.2004; vërtetim nga dokumentet hipotekore në emër të H. M.; hartë treguese e regjistrimit të pasurisë nr. ***, z. k. ***, Tiranë; vërtetim nga dokumentet hipotekore në emër të b/p Shahu; shkresë nr. *** prot., datë 13.6.2002, e Bashkisë Tiranë; kontratë shitjeje me kusht nr. ***, datë 20.4.1999; deklaratë noteriale nr. ***, datë 24.1.2017, nga z. B. Sh.; dokument i lëshuar në datën 9.8.2002 nga UK I. S. në emër të z. B. Sh..

⁵⁴Email datë 27.7.2020; dorëzuar në Komision me nr. *** prot., datë 28.7.2020.

⁵⁵Protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.7.2022.

këtij objekti, nga ku rezultoi: (i) në formularin e vetëdeklarimit⁵⁶ të objektit për legalizim, në rubrikën “Viti i ndërtimit”, subjekti ka deklaruar vitin 2000, si dhe konstatohen fotot e objektit ku pasqyrohet “3.12.05” dhe vërehet se objekti është i përfunduar; (ii) kontrata e sipërmarrjes për ndërtimin e objektit⁵⁷ është nënshkruar në datën 16.10.1997 dhe parashikon se: “*Punimet do të fillojnë menjëherë dhe do të përfundojnë brenda 12 muajve nga data e fillimit të punimeve*”; (iii) pronësia mbi truallin mbi të cilin është ngritur kjo ndërtesë është fituar në datën 19.2.2001⁵⁸, ndërsa çmimi i blerjes rezulton të jetë paguar në datën 16.10.2000⁵⁹ (7.200 USD) dhe në datën 19.2.2001 (120.000 lekë); (iv) FSHU-ja⁶⁰ informon se sipas sistemit të faturimit kontrata e energjisë elektrike për këtë objekt është lidhur në datën 28.6.2010, ndërsa sipas listës së faturimeve dhe pagesave faturimi dhe pagesat fillojnë nga nëntori i vitit 2010⁶¹; (v) nga dokumentacioni i administruar nga UKT-ja⁶² rezulton se subjekti ka aplikuar për të lidhur kontratën e furnizimit me ujë në datën 14.5.2010, duke i bashkëlidhur lejen e legalizimit nr. ***, datë 24.3.2009 dhe sipas listës së faturimeve⁶³ faturimi i përdorimit dhe shkarkimit të ujit dhe pagesa fillojnë nga dhjetori i vitit 2010.

3.4. Në përfundim të analizimit të fakteve të lartpërmendura rezulton se informacioni në dokumentet shtetërore është i paplotë për të konkluduar lidhur me periudhën e fillimit dhe përfundimit të ndërtimit të objektit.

3.5. Në kushtet e deklarimeve kontradiktore nga ana e subjektit lidhur me periudhën e fillimit dhe përfundimit të ndërtimit të objektit, si dhe në kushtet e informacionit të paplotë në dokumentacionin e administruar, Komisioni verifikoi pamjet imazherike të printuara nga Gjeoportali Kombëtar, konkretisht ortofoto të viteve 1999⁶⁴ dhe 2001⁶⁵ të përcjella nga ASIG⁶⁶, nga të cilat rezultoi se pavarësisht se këto pamje nuk janë plotësisht të qarta, në parcelën konkrete nuk dallohet të ketë ndërtim në proces. Gjithashtu, Komisioni verifikoi edhe pamjet imazherike nëpërmjet platformës *google earth* dhe, bazuar në koordinatat gjeografike të banesës⁶⁷, u konstatua se: (i) në imazhin e datës 17.6.2002 në parcelë vërehet një njollë e zbehtë; (ii) në imazhin e datës 16.2.2003 dallohet çatia e përfunduar e këtij objekti.

3.6. Në përfundim, Komisioni konsideroi vitet 2003 - 2004 si periudhë ndërtimi të objektit, pasi: (i) në vitin 2003, referuar pamjeve imazherike, vërehet çatia e objektit; dhe (ii) në DIPP/2004 subjekti ka deklaruar koston e ndërtesës prej 4.000.000 lekësh, vlerë e cila përputhet me deklarin e bërë nga subjekti në deklaratën *Vetting* 2017.

3.7. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimi të paraqesë shpjegime lidhje me konstatimin se *subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën Vetting*

⁵⁶Administruar nga ASHK-ja me shkresën nr. *** prot., datë 18.5.2022.

⁵⁷Administruar nga ASHK-ja me shkresën nr. *** prot., datë 18.5.2022.

⁵⁸Kontratë shitjeje nr. ***, datë 19.2.2001.

⁵⁹Referuar deklaratës noteriale nr. *** rep., datë 16.10.2000, pronarët e truallit kanë deklaruar se në datën 16.10.2000 kanë marrë nga subjekti shumën prej 7.200 USD.

⁶⁰Shkresë nr. *** prot., datë 20.7.2020.

⁶¹Shkresë nr. *** prot., datë 28.4.2022.

⁶²Shkresë nr. *** prot., datë 29.4.2022.

⁶³Shkresë nr. *** prot., datë 13.6.2022, e UKT-së.

⁶⁴Data e fotografimit 2.11.1999.

⁶⁵Data e fotografimit 15.1.2001.

⁶⁶Shkresë nr. *** prot., datë 1.8.2022.

⁶⁷Përcjellë nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 1.

2017 kohën e fillimit dhe të përfundimit të ndërtimit të banesës, duke mos plotësuar kushtin e parashikuar në pikën 2 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

3.8. Në përgjigje⁶⁸ të tij, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se momenti i fillimit të punimeve të ndërtimit është viti 1997, që është edhe momenti kur është dakordësuar me pronarët e truallit për pozicionin e parcelës dhe për çmimin e shitjes. Subjekti shpjegoi se arsyeja e pagesës në vitin 2000 ka qenë pikërisht sepse e kishte përmbyllur negociatën me palën shitëse pronare të truallit, kishte marrë truallin në posedim pasi kishte filluar punimet dhe nëpërmjet kësaj pagese paraprake i jepte garanci palëve shitëse që interesi i tij për blerjen e pronës ishte real dhe angazhohej të shlyente një pjesë të çmimit të blerjes, sikurse dakordësuar më herët. Nuk ekzistonte në legjislacionin shqiptar asnjë dispozitë ligjore që t'i pengojë palët në disponimin e një të drejte pronësore⁶⁹, sqaroi subjekti.

Në vijim, subjekti shpjegoi se disponimi i pronës për zhvillim është bërë përpara deklaratës noteriale të vitit 2000 për pagesën e shumës 7.200 USD apo kontratës së shitjes të vitit 2001 dhe sipas tij ky fakt provohet nga kontrata e sipërmarrjes e datës 16.10.1997, ku përcaktohet lloji i strukturës që do të ndërtohej. Nga vërtetimi nr. *** prot., datë 6.7.2022, i Njesisë Administrative Nr. ***, Tiranë, pasqyrohet se qytetari Kudus Shahu është banor i kësaj Njesisë Administrative, në adresën: rruga “****”, nd. ***, Tiranë dhe kjo banesë është ndërtuar prej tij nga viti 1997 në vazhdim.

Subjekti përfundoi duke shpjeguar se: *“Komisioni nuk mund t’i referohet pamjeve nga google earth dhe të injorojë kontratën e nënshkruar mes palëve në 1997 që është pikërisht për efekt të qëllimit të ndërtimit të objektit, apo edhe deklaratimin e ALUIZNI-t që i referohet një godine në vitin 2000. Referuar sa më sipër dhe fakteve të cilave Komisioni ka marrë në analizë për të përcaktuar momentin e ndërtimit të objektit, sikurse edhe deklarohet në raport, i referohet vetëm imazheve jo të qarta apo njollave të zbehta e mbi bazën e kësaj paqartësie kërkojnë të qartësojë që koha e ndërtimit është 2003 - 2004, duke injoruar tërësisht aktet si kontrata e sipërmarrjes, pagesa e çmimit të shitjes, deklaratimin të drejtorisë së ALUIZNI-t, e cila në parim merr në shqyrtim objekte që janë në fazë ndërtimi. Sa më sipër, për qëllime të përcaktimit të kohës së ndërtimit, për sa parashtruar më lart, konfirmoj që është viti 1997”.*

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

3.9. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore – arsyeton se:

3.10. Pika 2 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës parashikon se: *“[...] Subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin [...]”.* Pika 1 e

⁶⁸(i) Parashtrime dhe prova të dorëzuara në datën 28.10.2022, me nr. *** prot., si dhe me *email*-in e datës 24.10.2022 dhe datës 25.10.2022; (ii) prova të dorëzuara në datën 2.11.2022 në seancë dëgjimore; (iii) prova të dorëzuara në datën 3.11.2022, nr. *** prot.; (iv) prova të dorëzuara në datën 21.11.2022, nr. *** prot.; (v) parashtrime dhe prova të dorëzuara në datën 2.12.2022, nr. *** prot.; (vi) parashtrime dhe prova të dorëzuara në datën 5.12.2022, nr. *** prot., si dhe me *email*-in e datës 3.12.2022 dhe datës 4.12.2022.

⁶⁹Subjekti ka cituar ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, si dhe vendimin unifikues nr. 1, datë 6.1.2009, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, mbi të drejtën pronësore.

nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 parashikon se: “[...] 1. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive [...]”. Më tej, udhëzimi nr. *** prot., datë 10.10.2016, “Për mënyrën e deklarimit të pasurive në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pika 7 e këtij udhëzimi, përcakton se: “[...] Për çdo pasuri në pronësi, të paluajtshme, të luajtshme, likuiditete, vlerën e aksioneve, letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim etj., subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të duhet të deklarojë burimin në momentin e krijimit për secilën prej tyre, duke bashkëlidhur dokumentacionin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit për secilën pasuri në momentin e fitimit të tyre [...]”.

3.11. Referuar bazës ligjore më lart, nga shqyrtimi i kësaj çështjeje në lidhje me deklarimin e subjektit të rivlerësimit, rezulton se ai nuk ka deklaruar saktë datën e fillimit të ndërtimit të këtij objekti, pasi nga provat dhe faktet e administruara ndërtimi i objektit ka filluar në vitin 2002⁷⁰ dhe jo sikundër pretendon se ka filluar në vitin 1997.

3.12. Pretendimin e subjektit se momenti i fillimit të punimeve të ndërtimit është viti 1997, duke i bazuar argumentet e tij në kontratën e sipërmarrjes datë 16.10.1997 dhe në vërtetimin e Njesisë Administrative Nr. ***, trupi gjykues i Komisionit e gjen të pabazuar, pasi: (i) kontrata e sipërmarrjes së datës 16.10.1997 tregon një angazhim në të ardhmen dhe mbetet në kuadrin e një parashikimi; (ii) momenti i dakordësimit verbalisht me pronarët e truallit për pozicionin e parcelës dhe çmimin e shitjes nuk mund të vërtetojë momentin e fillimit të ndërtimit; (iii) konfirmimi i Njesisë Administrative Nr. ***⁷¹ për vitin e fillimit të punimeve nuk bazohet në ndonjë dokumentacion e gjithashtu në shkresat e Bashkisë Tiranë të paraqitura nga vetë subjekti⁷² nuk paraqitet asnjë e dhënë lidhur me vitin e fillimit të punimeve.

3.13. Një sërë provash të administruara gjatë hetimit administrativ provojnë të kundërtën e pretendimit të subjektit dhe, konkretisht, prova thelbësore e cila kundërshton pretendimin e subjektit janë pamjet imazherike të printuara nga Gjeoportali Kombëtar, konkretisht ortofoto e viteve 1999⁷³ dhe 2001⁷⁴ të përcjella nga ASIG⁷⁵, ku evidentohet qartazi se në parcelën konkrete nuk ka gjurmë ndërtimi në këtë moment dhe ajo gjendet në formë natyrore, çka përjashton në mënyrë absolute fillimin e ndërtimit në vitin 1997. Kjo provë e kërkuar dhe administruar sipas kërkesave të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim përcaktimin e fillimit dhe përfundimit të ndërtimit, është gjithashtu një nga format e përcaktuara për verifikimin e ndërtimeve informale sipas përcaktimeve të VKM-së Nr. 588, datë 10.9.2014⁷⁶ dhe konsiderohet ekuivalent me përdorimin e një harte.

⁷⁰Vërtetuar me anë të pamjeve imazherike nga platforma *google earth*, ku vërehet një njollë e zbehtë, duke nënkuptuar që punimet kishin filluar përpara datës së fotografimit, 17.6.2002.

⁷¹Nr. *** prot., datë 6.7.2022 (paraqitur nga subjekti).

⁷²Në provat e dorëzuara në datën 2.11.2022 në seancë dëgjimore, subjekti ka paraqitur: (i) shkresë nr. *** prot., datë 26.5.2005, të Njesisë Administrative Nr. ***; (ii) shkresë nr. *** prot., datë 9.8.2006, e Bashkisë Tiranë.

⁷³Data e fotografimit 2.11.1999.

⁷⁴Data e fotografimit 15.1.2001.

⁷⁵Shkresë nr. *** prot., datë 1.8.2022.

⁷⁶Në pikën 3, gërmat “a” dhe “b” të VKM-së Nr. 588, datë 10.9.2014, përcaktohet se: “Verifikimi i ndërtimeve informale brenda periudhave kohore të përcaktuara në ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006, ‘Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje’, të ndryshuar, bëhet nëpërmjet të paktën njëres prej formave të mëposhtme: a) përdorimit të produktit të fotografimit

3.14. Në përfundim, lidhur me momentin e fillimit të ndërtimit, si një moment shumë i rëndësishëm për të analizuar ligjshmërinë dhe mjaftueshmërinë e burimeve financiare që kanë shërbyer për krijimin e këtij objekti, Komisioni vlerësoi të konsiderojë pamjet imazherike të *google earth*, një platforme mëse e besueshme për vërtetësinë e informacionit që jep, për shkak se: (i) subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pasakta në deklaratat vjetore⁷⁷ dhe ka qenë i paqartë dhe kontradiktor në deklaratimet e tij pranë ILDKPKI-së dhe gjatë hetimit administrativ; (ii) informacioni i administruar nga institucionet përkatëse është i paplotë.

3.15. Për rrjedhojë, Komisioni vlerëson se, pavarësisht se nuk mund të përcaktohet me saktësi lloji i punimeve të kryera, ndërtimi i objektit ka filluar në vitin 2002 dhe jo në vitin 1997, siç pretendon subjekti.

3.16. Në këto kushte, referuar sa më lart, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë në deklaratën e pasurisë *Vetting*, duke mos deklaruar kohën e fillimit dhe përfundimit të punimeve të ndërtimit, në kundërshtim me përcaktimet e nenit D, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe të shtojcës nr. 2 të ligjit nr. 84/2016, të cilat kërkojnë përcaktimin e qartë të kohës së krijimit të pasurive në pronësi që deklarohen në deklaratën e pasurisë *Vetting*, situatë faktike e cila bie ndesh me parashikimet e nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me vlerën e kostos së ndërtimit të objektit

3.17. Nga dokumentacioni i administruar nga ASHK Tirana Veri⁷⁸ rezulton se sipas kartelës së pasurisë së paluajtshme të datës 21.9.2020, subjekti figuron pronar i pasurisë me nr. ***, z. k. ***, Tiranë, e llojit “truall”, me sip. 298,3 m², nga të cilat 110,3 m² ndërtesë. Në kartelë pasqyrohet shënimi “Leje legalizimi nr. ***, datë 24.3.2009, shuma e paguar 240.823 lekë” dhe tek seksioni “Përshkrim i veçantë” pasqyrohet shënimi “godinë banimi 2 kate + papafingo + bodrum” dhe me aplikimin nr. ***, datë 15.3.2012 është bërë rivlerësimi i pasurisë në shumën 36.425.345 lekë. Në vijim konstatohet se subjekti i rivlerësimit është pajisur me lejen e legalizimit nr. ***, datë 24.3.2009, për objektin “godinë banimi 2 kate + papafingo + bodrum” dhe sipas të dhënave që pasqyrohen në të rezulton që: (i) kjo pasuri është ndërtuar mbi truallin nr. pasurie ***, z. k. ***, Tiranë; (ii) sipërfaqja e ndërtimit është 110,3 m² (njolla e ndërtimit); (iii) sipërfaqe totale e ndërtimit për banim është 436,1 m²; (iv) numri i kateve mbi tokë është 2 kate + papafingo; (v) numri i kateve nën tokë është 1 kat.

3.18. Sipas formularit të vetëdeklarimit “Për legalizim objekti”, pa datë, të përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e ASHK-së⁷⁹, rezulton se subjekti ka aplikuar për legalizimin e objektit “godinë banimi”, me këto të dhëna: “adresa rruga ‘***’, funksioni ‘banim’, vit ndërtimi 2000, sipërfaqe e zënë 303 m², nr. i kateve mbi tokë 2 + P, nëntokë 1, lloji i mbulesës çati”, ndërsa në procesverbalin e konstatimit të datës 31.1.2009, të Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t, qarku

ajror të territorit të Republikës së Shqipërisë për periudhën kohore që ai mbulon; b) imazheve satelitore ose ajrore të përdorimit të përgjithshëm, sipas kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara nga subjektet disponuese [...]”.

⁷⁷Pranuar edhe nga vetë subjekti në parashtrimet e paraqitura në datën 5.12.2022, ku ka deklaruar: “Lidhur me deklarin e kësaj pasurie pranoj që nga ana ime ka pasur pasaktësi në lidhje me këtë pasuri. Në deklaratën e parë pranë ILDKPKI-së nga ana ime nuk është deklaruar kjo pasuri. Mosdeklarimi i kësaj pasurie në deklaratën e parë përpos faktit që ishim të patrajnuar dhe mirinformuar mbi mënyrën se si duhej të plotësohej deklarata, ishte edhe fakti që kjo pasuri nuk kishte akoma një status juridik të përcaktuar. Konkretisht ishte një pasuri (ndërtesë në ndërtim) e paregjistruar, e legalizuar dhe ndërkohë në kohën e deklarinimit nga ana ime nuk kishte një vlerë të saktë të përcaktuar të vlerës së ndërtimit dhe detyrimeve të furnitorëve për materiale dhe ndoshta të punimeve të kryera”.

⁷⁸Shkresë nr. *** prot., datë 7.10.2020.

⁷⁹Shkresë nr. *** prot., datë 18.5.2022.

Tiranë, pasqyrohen të dhënat e objektit, që janë të njëjta me ato të pasqyruara në lejen e legalizimit⁸⁰.

3.19. Në situatën kur subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti dokumentacion ligjor për të vërtetuar koston e objektit të ndërtuar në mënyrë informale, në përputhje me kërkesat e pikës 26 të udhëzimit nr. *** të ILDKPKI-së⁸¹, Komisioni përlllogaritë koston e ndërtimit duke iu referuar çmimeve të përcaktuara ndër vite prej Entit Kombëtar të Banesave, si një standard i arsyeshëm, në mungesë të çdo akti tjetër që provon një vlerë të ndryshme ndërtimi. Kjo metodologji nuk përcakton detyrimisht faktin se kjo vlerë përfaqëson ekzaktësisht koston reale të ndërtimit, por ajo mbetet një vlerë referuese e cila duhet të vlerësohet në drejtim të efektit që do të ketë në vlerësimin e kriterit të pasurisë, në këndvështrim dhe në analizë të të gjitha rrethanave që rezultojnë nga hetimi administrativ⁸².

3.20. Në rastin konkret, referuar arsyetimit lidhur me vitin e ndërtimit të objektit në periudhën 2003 – 2004, rezulton se kostoja e ndërtimit për këtë objekt ka qenë në vlerën 10.261.651 lekë ($436,1 \text{ m}^2 \times 23.530 \text{ lekë/m}^2$)⁸³, përkundrejt vlerës 4.000.000 lekë të deklaruar nga subjekti.

3.21. Lidhur me shpërndarjen e koston së ndërtimit në vitet 2003 dhe 2004, për efekt të analizës financiare, Komisioni pasqyroi në analizën financiare: (i) vlerën 4.000.000 lekë në vitin 2004, referuar deklaramit të subjektit në DIPP-në e këtij viti; dhe (ii) vlerën 6.261.651 lekë në vitin 2003, si diferencë midis vlerës totale prej 10.261.651 lekësh dhe vlerës prej 4.000.000 lekësh të përfshirë në vitin 2004. Për një qëndrim garantist, kjo vlerë u paraqit në fund të vitit kalendarik 2003.

3.22. Për sa i përket shpenzimeve të mobilimit, në përgjigje të pyetësorit standard⁸⁴, subjekti ka deklaruar: *“Lidhur me vlerën e arredimit të shtëpisë sqaroj se ajo është arreduar vit pas vit... dhe nuk disponoj faturat për vlerat e sakta...”*. Gjithashtu, edhe në procesverbalin e datës 1.2.2016 të ILDKPKI-së ka deklaruar: *“Mobilimi i shtëpisë së ndodhur në rrugën ‘***’ është kryer ndër vite me kursimet familjare”*. Me anë të pyetësorit nr. 1⁸⁵, Komisioni i kërkoi subjekti të saktësonte në mënyrë të përafërt shpenzimet vjetore për mobilimin e banesës dhe apartamenteve të tij. Në përgjigje⁸⁶ të tij, subjekti deklaroi se në banesat që zotëron nuk ka sende me vlerë të veçantë apo mobilie të kushtueshme që e kalojnë vlerën 2.500 euro dhe se ka bërë një arredim normal me kursimet e tij ndër vite, për të cilat nuk ka mbajtur shënime, pasi nuk e ka pasur detyrim ligjor.

3.23. Sa më lart, konstatohet se subjekti nuk ka deklaruar vlerën e shpenzimeve të mobilimit/arredimit për asnjërën prej 4 banesave të tij (përfshirë këtu edhe apartamentin e shitur). Në kushtet e mungesës së referencave ligjore për përcaktimin e një vlere për këtë lloj shpenzimi, Komisioni nuk e paraqiti këtë zë me vlerë specifike në analizën financiare (përveçse vlerës së kontribuar nga vëllai, trajtuar në paragrafët 5.46 - 5.47 të relacionit mbi rezultatet e

⁸⁰Sipërfaqja e zënë nga deklaruesi është 298,3 m², sipërfaqja e ndërtimit bazë është 110,1 m², numri i kateve mbi tokë 2k + p, numri i kateve nëntokë 1 dhe sipërfaqe e shfrytëzuar për banim 436,1 m².

⁸¹Pika 26 parashikon se për rastet kur subjektet e rivlerësimit dhe/ose personat e lidhur me të kanë kryer ndërtime, shtesa ose rikonstruksione të pjesshme ose të plota, për banesa ose çdo ndërtim tjetër, duhet të paraqesin dokumentacionin e plotë ligjor, lejen e ndërtimit, preventivin, situacionin e plotë të shpenzimeve të kryera etj.

⁸²Vendim nr. 6, datë 17.3.2022, i Kolegjit.

⁸³Mesatare e kostove për sipërfaqe ndërtimi në qytetin e Tiranës për vitin 2003 (22.615 lekë sipas udhëzimit nr. ***, datë 8.5.2003) dhe vitin 2004 (24.446 lekë sipas udhëzimit nr. ***, datë 4.3.2004).

⁸⁴Email datë 27.7.2020; dorëzuar edhe fizikisht në Komision me nr. *** prot., datë 28.7.2020.

⁸⁵Email datë 21.6.2022.

⁸⁶Protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.7.2022.

hetimit kryesisht), por pesha e kësaj çështjeje do të konsiderohet gjatë analizës së përgjithshme përfundimtare të fakteve dhe rrethanave.

Burimet e krijimit

3.24. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti ka deklaruar si burim krijimi kursimet nga paga e tij në vitet 1991 – 2004, të bashkëshortes nga viti 2004, shitjen e apartamentit të përfituar nga EKB Tiranë, në rrugën “****”, p. ***, shk. ***, ap. ***, në vlerën 2.000.000 lekë. Subjekti i rivlerësimi, në DIPP/2004⁸⁷, kur e ka deklaruar për herë të parë objektin, nuk ka deklaruar burimin e krijimit, por në seksionin e deklarimit të pasurive në pikën 3, ka deklaruar: *“Tërheqje gjendje cash 8.000 USD, përdorim për ndërtim shtëpie”*. Ndërsa në seksionin e deklarimit të detyrimeve ndaj personave juridikë dhe fizikë ka deklaruar: *“Marrë hua 1.000.000 lekë për ndërtimin e shtëpisë nga B. Sh.”*. Si pasojë, Komisioni analizoi deklaratimet e subjektit lidhur me secilin prej burimeve të deklaruara dhe kreu analizën financiare për të verifikuar mjaftueshmërinë e burimeve financiare të ligjshme për secilin prej tyre, si vijon:

i) Kursimet nga paga e subjektit në vitet 1991 – 2004 dhe e bashkëshortes nga viti 2004

3.25. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti nuk ka përcaktuar vlerën e saktë të këtij burimi, por në DIPP/2004 ka deklaruar: *“Tërheqje gjendje cash 8.000 USD, përdorim për ndërtim shtëpie”*. Në deklaratën e parë të pasurisë të vitit 2003, ka deklaruar: *“Gjendje cash 8.000 USD, banesë, kursime në vite”*. Sa më lart, Komisioni kreu analizën financiare për të verifikuar burimin e ligjshëm të vlerës 8.000 USD të deklaruar në vitin 2003.

3.26. Komisioni, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit⁸⁸, mori në konsideratë të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortes së tij për periudhën 1993 – 2003 dhe kreu analizën financiare për këtë periudhë dhe për vitin 2004, të cilat i pasqyroi në përfundim të analizimit të tre burimeve.

*ii) Të ardhura nga shitja e apartamentit në rrugën “****” në vlerën 2.000.000 lekë*

3.27. Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* 2017, të administruar edhe nga EKB-ja⁸⁹, rezulton se ndërmjet Drejtorisë Rajonale të EKB-së Tiranë dhe shtetasve Kudus Shahu dhe E. Sh. është lidhur kontrata noteriale e “shitjes me kusht” nr. ***, datë 20.4.1999 dhe, më pas, në datën 6.10.2004 është lidhur kontrata përfundimtare e shitjes nr. *** ndërmjet Drejtorisë Rajonale të EKB-së Tiranë dhe shtetasve Kudus Shahu, H. Sh., N. Sh., B. Sh., B. Sh. dhe E. Sh., me objekt “shitja e apartamentit të ndodhur në Tiranë, ***, seksioni ***, shkalla ***, apartamenti ***” (trajtuar në pikën 13 të këtij vendimi). Më pas rezulton se me kontratën e shitjes nr. ***, datë 8.10.2004 (të administruar nga ASHK-ja⁹⁰) shtetasit Kudus Shahu, H. Sh., N. Sh., B. Sh., B. Sh. dhe E. Sh. këtë apartament e kanë shitur tek shtetasi H. M.. Në kontratë parashikohet se çmimi i shitjes është në vlerën 2.000.000 lekë, e cila sipas

⁸⁷Subjekti i rivlerësimi e ka deklaruar për herë të parë këtë pasuri në DIPP/2004. Në deklaratën e parë të pasurisë të vitit 2003 subjekti nuk ka kryer asnjë deklaram lidhur me këtë ndërtesë.

⁸⁸Vendim nr. 15-2021(JR), datë 18.6.2021, i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, ku Kolegji në funksion të një qëndrimi orientues, sipas parashikimit të nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, parashtron: *“[...] periudha kohore para ndryshimeve demokratike në vend që përkon me vitet 1991 - 1992, nuk mund të jetë si rregull një periudhë e cila mund të llogaritet në funksion të përcaktimit të ndonjë vlere të kursyer, për shkak të një realiteti të jetuar që ka provuar se monedha zyrtare, leku, në këtë periudhë pësoi një inflacion në nivele shumë të larta e të jashtëzakonshëm, produkt i ndryshimeve politike, sociale dhe ekonomike në vend që e bën të pabesueshme dhe të palogjikshme mundësinë potenciale të kursimit nga të ardhurat nga puna në këto periudha. Për pasojë, pasi monedha vendase hyri në një fazë stabiliteti, pas viteve 1992 - 1993, mundësia për të kursyer mund të konsiderohet si opsion [...]”*.

⁸⁹Shkresë nr. *** prot., datë 7.4.2022.

⁹⁰Shkresë nr. *** prot., datë 7.10.2020.

deklarimit të palëve është likuiduar jashtë zyrës noteriale dhe shitësit deklarojnë se e kanë marrë në dorëzim këtë shumë.

3.28. Nga shqyrtimi i dosjes së privatizimit rezulton se ky apartament ishte në bashkëpronësi me anëtarë të tjerë të familjes (babai, nëna, motra, vëllai) dhe subjekti gëzonte 1/5 pjesë sipas certifikatës së përbërjes familjare të datës 1.12.1992. Por, edhe nëse i referohemi kontratës së shitjes nr. ***, bashkë me bashkëshorten subjekti gëzonte 2/6 pjesë. Gjithashtu rezulton se subjekti nuk ka paraqitur në deklaratën *Vetting* 2017 në pyetësonin standard dhe përpara ILDKPKI-së⁹¹ ndonjë dokument (deklaratë noteriale) që të provojë se bashkëpronarët e tjerë kanë hequr dorë nga çmimi i shitjes apo që ia kanë dhuruar subjektit.

3.29. Komisioni, me anë të pyetësonit nr. 1⁹², i kërkoi subjektit të saktësonte pjesën e tij takuese në shumën që ka përfituar nga çmimi i shitjes së apartamentit të mësipërm, si dhe të paraqesë dokumentacion provues. Në përgjigje⁹³ të tij, subjekti deklaroi se shuma që ka ardhur nga shitja sipas kontratës nr. ***, datë 8.10.2004, prej 2.000.000 lekësh, është përfituar tërësisht prej tij, për shkak se praktika me EKB-në është në emrin e tij dhe këstet e kredisë janë paguar po nga ai. Gjithashtu deklaroi se familjarët e tij, prindërit, gjyshja dhe vëllai, rezultojnë në kontratën me EKB-në vetëm për faktin se në atë moment kanë qenë në të njëjtën certifikatë familjare me të, por *de facto* kanë jetuar në Kukës dhe vëllai në Angli dhe nuk kanë jetuar asnjëherë në këtë banesë. Për vërtetimin e deklaratimit të tij subjekti ka paraqitur praktikën e EKB-së.

3.30. Në përfundim, duke konsideruar se: (i) subjekti deklaroi se shpenzimet për blerjen e këtij apartamenti janë kryer nga ana e tij; (ii) kontrata noteriale e shitjes me kusht me nr. ***, datë 20.4.1999, është e lidhur ndërmjet Drejtorisë Rajonale të EKB-së Tiranë dhe shtetasve Kudusi Shahu e E. Sh.; (iii) në mandatarkëtimet që ndodhen në dosjen e dërguar nga EKB-ja⁹⁴ lidhur me pagimin e kësteve të kredisë dhe në mandatarkëtimet e mbylljes së kredisë⁹⁵ pasqyrohet se arkëtimet janë bërë nga z. Kudusi Shahu – Komisioni i përlllogarit të ardhurat në vlerën 2.000.000 lekë si burim për ndërtimin e banesës, duke i përfshirë ato në analizën financiare.

iii) Kontributi i shtetasit B. Sh. në vlerë të papërcaktuar

3.31. Në deklaratën *Vetting* 2017⁹⁶, subjekti ka deklaruar se në ndërtimin e banesës ka kontribuar në vlerë të papërcaktuar edhe vëllai i tij B. Sh., si rezultat i emigracionit në Greqi dhe Angli (pa kontratë, me deklaratë), i cili ka kontribuar edhe në arredimin dhe rregullimin e banesës në G., ku shuma e përgjithshme e kontributit për të dy objektet është afërsisht 27.000 euro. Për vërtetimin e këtij deklarimi subjekti i rivlerësimi në deklaratën *Vetting* 2017 ka paraqitur: (i) deklaratën noteriale nr. ***, datë 24.1.2017, të shtetasit B. Sh., i cili deklaroi se: “z. Kudusi Shahu është vëllai im dhe për shkak të lidhjes familjare kam kontribuar në vite në ndërtimin e banesës në rrugën ‘***’, si dhe në blerjen dhe rikonstruksionin e apartamentit të ndodhur në *** Durrës... në vlerën monetare totale... 27.000 euro...” dhe këtë shumë e ka dhënë për shkak të mundësisë që ka pasur pasi nga viti 1999 deri në gusht të vitit 2001, pasi ka qenë emigrant në Mbretërinë e Bashkuar; (ii) kopje të dokumentit të lëshuar në datën 9.8.2002

⁹¹Procesverbali i datës 1.2.2016.

⁹²Email datë 21.6.2022.

⁹³Protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.7.2022.

⁹⁴Mandatarkëtimet nr. ***, nr. ***, nr. ***, datë 30.9.1996, nr. *** dhe nr. ***.

⁹⁵Mandatarkëtimet nr. ***, datë 4.3.2003 dhe nr. ***, datë 4.3.2003.

⁹⁶Në seksionin e të dhënave konfidenciale.

nga *United Kingdom I. S.* në emër të shtetasit B. Sh., por nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues për të provuar të ardhurat e fituara nga vëllai.

3.32. Gjithashtu rezulton se në DIPP/2004, në seksionin e deklarimit të detyrimeve ndaj personave juridikë dhe fizikë, subjekti ka deklaruar se ka marrë hua në shumën 1.000.000 lekë nga shtetasi B. Sh. për ndërtimin e shtëpisë. Në vijim, në DIPP-të vjetore nuk ka deklaruar shlyerje të shumës së marrë hua. Në procesverbalin e datës 1.2.2016 të ILDKPKI-së⁹⁷ ka deklaruar se huaja prej 1.000.000 lekësh nga ana e vëllait i është falur⁹⁸.

3.33. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se në ndërtimin e banesës ka kontribuar vëllai i tij B. Sh. dhe ky shtetas konfirmon kontributin e tij në ndërtimin e banesës në rrugën “****”, bazuar në pikën 14 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, shtetasi B. Sh. konsiderohet “person tjetër i lidhur” dhe në zbatim të pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, marrëdhënia ndërmjet tyre konsiderohet marrëdhënie dhurimi, pasi është pa kundërshtim dhe subjekti e ka pranuar. Në këto kushte, subjekti ka detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës së dhuruar nga vëllai i tij B. Sh.

3.34. Lidhur me vlerën 27.000 euro, të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si kontribut i vëllait, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar atë si burim për ndërtimin e banesës në deklarimet periodike vjetore. Po kështu, në procesverbalin e datës 1.2.2016 të ILDKPKI-së⁹⁹, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se vlera 27.000 euro ka shërbyer për blerjen dhe arredimin e apartamentit të blerë nga shoqëria “****” sh.p.k. dhe jo për banesën në fjalë.

3.35. Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 1¹⁰⁰, i kërkoi subjektit të saktësonte shumën e kontributit të vëllait të tij B. Sh. në pasurinë “banesë 2 kate + papafingo + bodrum” dhe në pasurinë apartament në ***, Kavajë, si dhe të specifikojë periudhën e përfitimit të kësaj vlere, mënyrën e përfitimit të saj (*cash* apo me transfertë bankare) dhe të paraqesë dokumentacion justifikues. Në përgjigje¹⁰¹ të tij, subjekti i rivlerësimit deklaroi se shuma e kontributit të vëllait B. Sh. për banesën në rrugën “****” dhe banesën në ***, Kavajë, ka qenë në total 27.000 euro, shumë e cila është përfituar në vite dhe kontributi ka qenë formal pa pasur nevojë për dokumentacion justifikues, pasi ka qenë marrëveshje ndërmjet vëllezërve. Ndërsa për mënyrën e përfitimit deklaroi se transferimi i të ardhurave në pjesën më të madhe është bërë nëpërmjet W. U., por është në vështirësi për të gjetur dokumentacionin përkatës për arsye se ky institucion nuk i ruan dokumentet për një periudhë më tepër se 5-vjeçare.

3.36. Sa më lart, subjekti i rivlerësimit sërish nuk përcaktoi saktësisht vlerën e kontributit të vëllait në secilën banesë apo kontributin në arredimin e apartamentit në ***.

3.37. Lidhur me vlerën 1.000.000 lekë, e deklaruar e falur nga vëllai, rezulton se në procesverbalin e datës 1.2.2016 të ILDKPKI-së¹⁰² subjekti nuk ka deklaruar si burim të ardhurat e vëllait, por ka deklaruar se: “Shtëpia është ndërtuar... me kursimet nga të ardhurat nga paga ime dhe e bashkëshortes dhe më pas nga shitja e apartamentit të përfituar nga EKB-ja në datën 8.10.2004”. Në vijim, në pyetësin standard¹⁰³, në përgjigje të pyetjes nr. 1, ka deklaruar si

⁹⁷Shkresë nr. *** prot., datë 8.4.2022.

⁹⁸Përgjigje pyetjes: “Kontratë huaje me vëllain nuk kam hartuar, vëllai nga viti 1999 ka qenë emigrant në Angli dhe ka pasur të ardhura për dhënien e kësaj shume. Huaja nga ana e vëllait më është falur, pra nuk ekziston më ky detyrim”.

⁹⁹Shkresë nr. *** prot., datë 8.4.2022.

¹⁰⁰Email datë 21.6.2022.

¹⁰¹Protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.7.2022.

¹⁰²Shkresë nr. *** prot., datë 8.4.2022.

¹⁰³Email datë 27.7.2020; dorëzuar fizikisht në Komision me nr. *** prot., datë 28.7.2020.

burim të krijimit të banesës shitjen e apartamentit në rrugën “***”, kontributin e familjes dhe punën në emigracion të vëllait¹⁰⁴. Më pas, në përgjigje të pyetjes nr. 4¹⁰⁵ nuk e deklaroi shumën e dhënë nga vëllai i tij si dhuratë apo si financim, si dhe në përgjigje të pyetjes nr. 9¹⁰⁶, pasi deklaroi ndërtimin e banesës në vitin 2001, nuk ka deklaruar si burim të ardhurat e vëllait, por ka deklaruar vetëm kursimet nga paga e tij për vitet 1991 – 2004, pagën e bashkëshortes nga viti 2004 dhe shitjen e apartamentit rrugën “***” në vlerën 2.000.000 lekë.

3.38. Me anë të pyetësorit nr. 1¹⁰⁷, Komisioni i kërkoi subjektit të saktësonte vitin kur vëllai i tij i ka falur shumën e dhënë hua, të paraqesë dokumentacion ligjor që konfirmon këtë marrëdhënie juridike, si dhe dokumentacion ligjor justifikues të të ardhurave të realizuara nga shtetasi B. Sh., të cilat kanë shërbyer si burim për shumën 1.000.000 lekë. Në përgjigje¹⁰⁸, subjekti ka deklaruar se vëllai i tij B. Sh. në fazën e ndërtimit të shtëpisë, por para vitit 2004, i ka dhënë hua shumën 1.000.000 lekë, e cila ka shërbyer për ndërtimin e saj dhe me kalimin e kohës nuk e ka kërkuar këtë shumë, madje ia ka falur. Gjithashtu deklaroi se ky veprim nuk është pasqyruar me dokumentacion ligjor për shkak të lidhjes familjare.

3.39. Lidhur me dokumentacionin që provon të ardhurat e shtetasit B. Sh. gjatë periudhës prill 1999 – korrik 2002 në shtetin anglez, subjekti i rivlerësimit deklaroi se po bën kërkime për dokumentacionin përkatës dhe do ta vërë në dispozicion të Komisionit sapo t’i mundësohet.

3.40. Në vijim¹⁰⁹, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratën noteriale nr. ***, datë 1.10.2022, të shtetasit G. A., i cili deklaroi se është rezident në Londër, Angli, nga viti 1999 dhe se gjatë këtij viti është takuar me shtetasin B. H. Sh., i cili në atë periudhë ishte pa letra pune për të punuar në Angli. Duke qenë se ishte me dokumente angleze, vijon deklaruesi, dhe aktiviteti i tij ka qenë me punë ndërtimi, shtetasi B. Sh. i ka kërkuar letrat e tij të punës për të punuar për një periudhë kohe të pacaktuar. Më tej, për shkak se rreth vitit 1999 i duhej të shkonte në Greqi, ka pasur mundësi t’i jepte dokumentet e tij të punës, por me kushtin që taksat të paguheshin në emër dhe për llogari të tij. Bashkëlidhur deklaratës gjendet kopja e pasaportës angleze e shtetasit G. A. dhe dokumenti në gjuhën angleze i lëshuar nga autoriteti i shtetit anglez që vërteton të ardhurat e realizuara dhe taksat e paguara në vitet 2000 – 2004. Për periudhën 1999 – 2000 nuk ka të dhëna punësimi për shtetasin G. A., ndërsa për periudhën 2000 – 2001 të ardhurat kanë qenë në vlerën 7.864,8 GBP.

3.41. Në përfundim të hetimit administrativ për tre burimet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 1993 – 2003, ku u konsideruan të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij¹¹⁰, shpenzimet e jetesës¹¹¹, shpenzimet për pagesën e EKB-së për blerjen e apartamentit në rrugën “***”, shpenzimet për blerjen e automjetit, tokë truall dhe tokë arë në ***, kosto e ndërtimit të banesës në rrugën “***”, analizë nga e cila rezultoi një balancë negative në shumën 8.373.890 lekë. Gjithashtu,

¹⁰⁴Lidhur me adresat e banimit.

¹⁰⁵Nëse ka marrë ndonjëherë ndonjë dhuratë më shumë se 500 euro.

¹⁰⁶Nëse ka pasur shpenzim më të madh se 2.500 euro.

¹⁰⁷Email datë 21.6.2022.

¹⁰⁸Protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.7.2022.

¹⁰⁹Nr. *** prot., datë 4.10.2022, në Komision.

¹¹⁰Për subjektin: (1) vërtetim nr. ***, datë 24.10.2016, nga Prokuroria e Përgjithshme (për vitin 1994); (2) vërtetim nr. ***, datë 25.10.2016, nga Prokuroria e Përgjithshme. Për bashkëshorten: vërtetim nr. ***, nga DRFP Tiranë.

¹¹¹(i) 66% e të ardhurave për periudhën 1994 – 1999; (ii) bazuar në shkresën nr. ***, datë 4.3.2019, të ILDKPKI-së për periudhën 2000 – 2016. Në mungesë të të dhënave, për vitin 2001 u konsiderua vlera e vitit paraardhës (108.000 lekë/vit për person), ndërsa vlera për vitin 2007 është saktësuar sipas shkresës nr. ***, datë 27.5.2008, të INSTAT-it drejtuar ILDKPKI-së (174.072 lekë/vit për person). Në vitin e lindjes së fëmijëve u konsideruan vetëm muajt që nga muaji i lindjes deri në fund të vitit.

Komisioni kreu analizën financiare për vitin 2004, duke përfshirë një kosto ndërtimi në vlerën 4.000.000 lekë, ku rezultoi një balancë negative prej 698.124 lekësh.

3.42. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi barrën e provës dhe i kërkoi subjektit të rivlerësimit të paraqesë shpjegime në lidhje me konstatimet se: (i) mungon dokumentacioni justifikues ligjor për të provuar të ardhurat e vëllait që kanë kontribuar në ndërtimin e banesës 2 kate + papafingo + bodrum me sipërfaqe totale 436,1 m²; (ii) subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur mundësi financiare të ligjshme për blerjen e pasurive, ndërtimin e objektit, kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën në kursime gjatë periudhës 1993 – 2003, me një balancë negative prej 8.373.890 lekësh; (iii) subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur mundësi financiare të ligjshme për ndërtimin e objektit dhe kryerjen e shpenzimeve gjatë vitit 2004, me një balancë negative prej 698.124 lekësh.

3.43. Në parashtrimet e tij¹¹², *së pari, lidhur me vlerën e investimit*, subjekti pretendoi të përlllogarit një vlerë totale prej 4.000.000 lekësh si rezultat i fillimit të punimeve në vitin 1997, kostos së ndërtimit mbi bazën e kostove të referuar nga 1997 e në vijim, duke përjashtuar disa zëra, si dhe kostos së ndërtimit në raport me strukturën e objektit. Subjekti ka paraqitur aktekspertizën tekniko-ekonomike, përgatitur nga ing. I. P. në datën 15.11.2022, ku paraqitet një kosto totale e objektit në vlerën 4.183.176 lekë.

3.44. Në këtë akt përshkruhet se punimet për ndërtimin e këtij objekti kanë nisur rreth fundit të vitit 1997 dhe deri në fund të vitit 1999 kanë përfunduar rreth 75-80% të volumeve të përgjithshme të ndërtimit. Godina është përfunduar totalisht dhe është vënë në funksion rreth fundit të vitit 2003, ku ka përfunduar edhe ndërtimi i çatisë, tip papafingo i katit të fundit. Për llogaritjen e vlerës së çdo objekti ndërtimi do duhen të merren për bazë volumet metrike të zërave të punimeve faktike shumëzuar me çmimin njësi të secilit zë punimesh. Për përlllogaritjen e vlerës së ndërtimit janë përdorur çmimet për njësi të hartuara/miratuara për vitin 1998 - 1999 nga Enti Kombëtar i Banesave.

3.45. Në këtë raport është konkluduar: (i) *objekti 2 kate + 1 kat bodrum + 1 kat papafingo, me NP ***, ndodhur në z. k. ***, me sipërfaqe gjurmë ndërtimi të regjistruar 110,3 m², llogaritur mbi sasi të metrike të punimeve faktike të kryera, shumëzuar me çmimet njësi të këtyre zërave është llogaritur nga ana ime me vlerën totale 4.183.176 lekë; (ii) llogaritja e vlerës së ndërtimit të një objekti, referuar kostos mesatare të ndërtimit për vitin 1998 dhe 1999 mendoj se nuk është e saktë, pasi ajo bie ndesh edhe me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 514, datë 15.7.2007, “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit” dhe pikërisht pikën 9 të saj.*

3.46. Në vijim, subjekti theksoi se ky ndërtim është përfunduar pothuajse plotësisht në vitin 2003 dhe se disa rifinitura në vlera të vogla janë kryer më vonë, duke iu referuar punimeve të kryera në vitin 2007. Punimet janë kryer nga skuadra të ndryshme punëtorësh apo specialistësh ndërtimi (të njohur të familjes), si dhe me kontributin në ndërtim të anëtarëve të familjes, kryesisht djemtë e hallës¹¹³, një pjesë e zërave/materialeve të punimeve janë marrë tek të

¹¹²(i) Parashtrime dhe prova të dorëzuara në datën 28.10.2022, me nr. *** prot., si dhe me *email*-in e datës 24.10.2022 dhe datës 25.10.2022; (ii) prova të dorëzuara në datën 2.11.2022 në seancë dëgjimore; (iii) prova të dorëzuara në datën 3.11.2022, me nr. *** prot., (iv) prova të dorëzuara në datën 21.11.2022, me nr. *** prot.; (v) parashtrime dhe prova të dorëzuara në datë 2.12.2022, me nr. *** prot.; (vi) parashtrime dhe prova të dorëzuara në datën 5.12.2022, me nr. *** prot., si dhe me *email*-in e datës 3.12.2022 dhe datës 4.12.2022.

¹¹³Subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. ***, datë 7.11.2022, të shtetasit Sh. T.

njohurit e tyre për të marrë çmime sa më të leverdishme dhe ekonomike, vijoi subjekti. Në vitin 2003 për punimet e kryera në këtë ndërtim dhe materiale të ndryshme të ndërtimit nuk ishin likuiduar në vlerën rreth 3-3.100.000 lekë dhe për këtë qëllim në vitin 2004 është realizuar edhe shitja e apartamentit për të shlyer detyrimet e lindura si më sipërcituar. Deri në vitin 2003 nga ana e tyre ishte likuiduar shuma rreth 1.100.000 lekë. Subjekti shpjegoi se pas shitjes së shtëpisë në vitin 2004 për shlyerjen e detyrimeve të furnitorëve, tashmë kishte një vlerë të shpenzuar për ndërtimin e shtëpisë dhe nga ana e tij në vitin 2004 është deklaruar banesa me vlerë ndërtimi në shumën 4.000.000 lekë.

3.47. Së dyti, lidhur me kontributin e vëllait B. Sh., subjekti deklaroi se i vëllai, në blerjen e apartamentit në *** dhe në ndërtesën e ndërtuar në Tiranë, ka investuar në total 27.000 euro, nga të cilat rreth 1.000.000 lekë janë investuar në ndërtimin e banesës 2 kate + papafingo në Tiranë. Kjo e fundit, pra vlera prej 1.000.000 lekësh, ishte në formë huaje nga të ardhurat që i vëllai kishte realizuar në emigracion në Greqi dhe Angli (pa kontratë) dhe më pas ia ka falur si rrjedhojë e deklaratës noteriale nr. ***, datë 12.12.2016, me anë të së cilës subjekti i ka falur pjesën takuese në apartamentin nr. ***, me sip. 132 m², z. k. ***, vol. ***, f. ***, të cilën e ka përfituar nga çelja e dëshmisë së trashëgimisë së babait të tij¹¹⁴.

3.48. Një pjesë të konsiderueshme të shumave monetare vëllai i ka sjellë nëpërmjet W. U., vijoi subjekti, duke sqaruar se nga ana e tij po vazhdojnë përpjekjet për të marrë informacion nëpërmjet komunikimeve elektronike me zyrat qendrore të W. U.¹¹⁵. Subjekti shpjegoi se e sjell këtë analizë për shkak të pamundësisë së depozitimit të mandateve apo të një informacioni nga W. U. në Shqipëri për vënien në dispozicion të shumave të transfertave/dërgesave të ardhura nga i vëllai kur punonte në Angli, pasi ky informacion nuk disponohet, për shkak të kohës së gjatë kur ka ndodhur transferta. Pavarësisht kësaj, gjatë kërkimeve në ambientet e banimit kanë arritur të gjejnë disa nga mandatet e dërgesave të parave me anë të W. U., të cilat i janë vendosur në dispozicion Komisionit¹¹⁶.

3.49. Ndërkaq, në funksion të sa më sipër, subjekti sqaroi që gjen aplikim edhe neni 32 i ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon që nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t'i vërtetojë Komisionit, institucionit të rivlerësimit, se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Ky rregull zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjet brenda afatit ligjor. Në këtë kontekst, subjekti ftoi Komisionin, si institucion rivlerësimi, të pranojë ekzistencën e shkaqeve të arsyeshme për mosparaqitjen e gjithë mandateve, si dokumente justifikuese për vërtetimin e burimeve të ligjshme të vëllait B. Sh.

3.50. Së treti, lidhur me shpenzimet për mobilimin, subjekti deklaroi se nuk ka sende me vlerë të veçantë apo mobilie të kushtueshme që e kalojnë vlerën 2.500 euro dhe se ka bërë një arredim normal me kursimet ndër vite, për të cilat nuk ka mbajtur shënime, pasi nuk e ka pasur detyrim

¹¹⁴Subjekti ka paraqitur: (i) certifikatë pronësie para çeljes së dëshmisë së trashëgimisë; (ii) certifikatë pronësie pas çeljes së dëshmisë së trashëgimisë; dhe (iii) deklaratë noteriale për heqje dorë, me qëllim regjistrimin e pronës në emër të vëllait.

¹¹⁵Referuar shkresës nr. ***, datë 12.07.2022, të W. U., është e pamundur të vihet në dispozicion dokumentacioni apo informacioni i kërkuar, në zbatim të udhëzimit nr. ***, datë 3.8.2012, të Komisionit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale "Mbi përpunimin e të dhënave personale në sektorin bankar".

¹¹⁶Formularë për tërheqje parash: (i) vlera 779,62 USD në datën 3.6.1999; (ii) vlera 3.235,49 USD në datën 19.10.1999; (iii) vlera 2.904,28 USD në datën 20.7.2000; (iv) vlera 2.000 USD në datën 25.10.2000; dhe (v) vlera 2.801,36 USD në datën 19.2.2001.

ligjor. Arredimi ka ardhur i shpërndarë në kohë, si dhe duke qarkulluar të njëjtat mobilie dhe pajisje, konkretisht në rastin e banesës 2-katëshe, subjekti i rivlerësimit deklaroi se fillimisht ka përdorur të njëjtat mobilie që ka pasur në apartamentin në rrugën “****”, p. ***, shk. ***. ap. ***, përfituar nga EKB-ja Tiranë, duke konsideruar që edhe përfundimi i ndërtimit zgjati në kohë.

3.51. Në përfundim të analizimit të kostos së ndërtimit për banesën objekt hetimi, subjekti ka paraqitur një tabelë të analizës financiare të kryer prej tij, për periudhën gusht 1991 – dhjetor 1993, ku rezulton një balancë pozitive në vlerën 26.723 lekë.

3.52. *Së katërti, lidhur me balancën negative të vitit 2004*, subjekti sqaroi se sikurse ka shpjeguar më lart, ndërtimi dhe çatia e shtëpisë janë ndërtuar që në vitin 2003 dhe kështu që vlera prej 4.000.000 lekësh, e pasqyruar nga Komisioni në analizën financiare të vitit 2004, nuk i përgjigjet faktit. Subjekti ka paraqitur një analizë financiare, ku, në ndryshim nga analiza e Komisionit, pasqyrohet një vlerë investimi prej 3.083.176 lekësh¹¹⁷ dhe shpenzime udhëtimi në shumën 21.546 lekë¹¹⁸ dhe, për rrjedhojë, rezulton një balancë pozitive prej 313.755 lekësh.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

3.53. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratat e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratat në seancë dëgjimore – arsyeton se:

3.54. *Së pari, lidhur me pretendimin e subjektit lidhur me mënyrën e gabuar të përlllogaritjes së investimit bazuar në kostot mesatare të ndërtimit dhe jo në volumet konkrete*, Komisioni çmon se referuar praktikës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në kushtet e mungesës së dokumentacionit justifikues që do të provonte çmimet dhe shpenzimet e kryera nga subjekti për ndërtimin e objektit, referimi në çmimet e përcaktuara në vlerat e kostove të ndërtimit, publikuar nga EKB-ja, është e vetmja referencë ligjore për përcaktimin e çmimeve. Referimi në këto kosto ndërtimi të përcaktuara me vendimet dhe udhëzimet e Këshillit të Ministrave është jo vetëm kriter ligjor i drejtë, por do t'i vendoste të gjitha subjektet e rivlerësimit në një trajtim të barabartë në mënyrën e përlllogaritjeve të vlerave të pasurive të tyre, në kushtet e mungesës së dokumentacionit provues për vlerën e ndërtimeve të tyre, shprehet Kolegji¹¹⁹.

3.55. Komisioni vëren se një aktekspertim i përgatitur pas më shumë se 20 vjetësh nga koha e kryerjes së punimeve nga një inxhinier i përzgjedhur nga vetë subjekti dhe i paraqitur gjatë procesit të rivlerësimit, është një akt jobindës dhe joreferues për llogaritjen e vlerës së ndërtimit.

3.56. Mungesa e çdo gjurme deklarimi në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 për këto punimeve, të deklaruara në pyetësorë/prapësime si punime pothuajse të përfunduara në vitin në fjalë apo mungesa e deklaratimit lidhur me ekzistencën detyrimeve të pretenduara për pagesën e

¹¹⁷Përkundrejt vlerës 4.000.000 lekë të pasqyruar në analizën e Komisionit dhe jo në përputhje me deklaratimin e subjektit në DIPP/2004.

¹¹⁸Përkundrejt vlerës 116.601 lekë të pasqyruar në analizën e Komisionit.

¹¹⁹Vendim nr. 07-2022 (JR), datë 29.3.2022.

materialeve, e kushtëzon Komisionin që ta shpërndajë koston e ndërtimit bazuar në pamjet imazherike dhe në deklarin e subjektit në DIPP/2004.

3.57. Ashtu siç u konkludua në paragrafin 3.15 të këtij vendimi, punimet kanë filluar në vitin 2002, por për shkak se nuk mund të përcaktohet saktësisht lloji apo volumi i punimeve, Komisioni vendosi që vlerën e investimit ta përlllogarisë duke u bazuar në mesataren e koston së ndërtimit për vitet 2002, 2003 dhe 2004 dhe ta shpërndajë në vitet 2003 dhe 2004.

3.58. Më tej, Komisioni, për të garantuar një gjykim sa më garantist, duke marrë në konsideratë në mënyrë hipotetike edhe pretendimin e subjektit në ankim për llogaritjen e koston së ndërtimit, duke zbritur disa elemente të koston nga kostoja e ndërtimi, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, kreu analizën financiare duke zbritur 9,27% nga kostoja totale e ndërtimit¹²⁰.

3.59. Në përfundim të arsytimit të mësipërm, pas ripërlllogaritjeve, vlera e investimit rezultoi 9.128.320 lekë ($436,1 \times 23.070 \text{ lekë/m}^2$ ¹²¹ $\times 90.73\%$ ¹²²), e cila, për efekt të analizës financiare u pasqyrua në vlerën 5.128.320 lekë në fund të vitit 2003 dhe në vlerën 4.000.000 lekë në vitin 2004.

3.60. *Së dyti, lidhur me kontributin nga vëllai*, Komisioni konstaton në analizë të shpjegimeve të subjektit dhe të dokumentacionit ligjor provues të paraqitur gjatë hetimit administrativ, se për sa u përket të ardhurave të vëllait të tij, të deklaruara se janë fituar nga puna si emigrant në Angli, subjekti i rivlerësimit arriti të provojë faktin e qëndrimit të vëllait në këtë shtet, ndërsa për sa i përket faktit të punësimit në këtë periudhë, ndonëse duket se ky qëndrim mund të ketë shërbyer për të punuar dhe krijuar të ardhura, subjekti nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues ligjor, në kuptim të ligjit, marrëdhënien e punës dhe krijimin e të ardhurave në shumën 27.000 euro (ku përfshihet edhe vlera prej 1.000.000 lekësh, objekt analize), si dhe ligjshmërinë e tyre, sipas përcaktimeve të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

3.61. Gjithashtu, subjekti ka qenë kontradiktor dhe konfuz në deklarin e tij, pasi ka bërë deklarime të ndryshme lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie, konkretisht në përgjigje të pyetësorit standard fillimisht e deklaroi si burim kontributin e vëllait të tij në emigracion, ndërsa në vijim nuk e ka deklaruar si burim, e më tej, në procesverbalin e datës 1.2.2016 të ILDKPKI-së nuk e ka deklaruar si burim këtë kontribut.

3.62. Po kështu, Komisioni vëren se në prapësimet e tij subjekti e ka paraqitur këtë vlerë në analizën financiare për periudhën 1991 – 2003 dhe jo në analizën financiare të vitit 2004, siç ka deklaruar në DIPP/2004.

3.63. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, në kuptim të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni vlerëson se nuk është relevante të qenit ose jo në kushtet e aplikimit të këtij neni lidhur me fondet e dërguara me anë të W. U., pasi subjekti nuk arriti të provojë se dërgesat e vlerave monetare ishin krijuar nga burime të ligjshme, për sa kohë nuk u provua punësimi i personit tjetër të lidhur dhe pagesa e detyrimeve tatimore dhe, për rrjedhojë, nuk mund të konsiderohen si të ardhura të ligjshme në procesin e rivlerësimit kalimtar të

¹²⁰Vendim nr. 06-2022 (JR), datë 17.3.2022, referuar vitit 2001, si viti më i afërt në kohë.

¹²¹Mesatare e kostove për sipërfaqe ndërtimi në qytetin e Tiranës, konkretisht të koston për vitin 2002 (22.150 lekë sipas udhëzimit nr. ***, datë 16.10.2002), për vitin 2003 (22.615 lekë sipas udhëzimit nr. ***, datë 8.5.2003) dhe për vitin 2004 (24.446 lekë sipas udhëzimit nr. ***, datë 4.3.2004).

¹²²Për shkak të zbritjes në masën 9,27%.

gjyqtarëve dhe prokurorëve, në kuptim të standardit të vendosur nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

3.64. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka dështuar të provojë të ardhurat e ligjshme të personit tjetër të lidhur për të justifikuar kontributin prej 1.000.000 lekësh për krijimin e kësaj pasurie.

3.65. Në përfundim të arsyetimit të mësipërm, Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 1993 – 2003, të paraqitur në tabelën si vijon:

Tabela nr. 1 – analiza financiare për periudhën 1993 – 2003

Periudha	Përshkrim	Të ardhura	Shpenzim/ pasuri	Gjendje progresive
1993 – 1994	Të ardhurat nga pagat, subjekti	191,794		191,794
1993 – 1994	Shpenzime jetike	-	76,718	115,076
janar – shkurt 1995	Të ardhurat nga pagat, subjekti	43,384		158,460
janar – shkurt 1995	Shpenzime jetike	-	17,353	141,107
8.2.1995	Ap. rr. “****”, pagesa fillestare, mandatarkëtim nr. ***, datë 8.2.1995	-	90,000	51,107
mars – dhjetor 1995	Të ardhurat nga pagat, subjekti	216,918		268,024
mars – dhjetor 1995	Shpenzime jetike	-	86,767	181,257
1996	Të ardhurat nga pagat, subjekti	313,771		495,028
1996	Shpenzime jetike	-	125,508	369,520
1996	Ap. rr. “****”, pagesa këstesh për EKB-në	-	24,818	344,702
janar – korrik 1997	Të ardhurat nga pagat, subjekti	188,874		533,576
janar – korrik 1997	Shpenzime jetike	-	75,550	458,026
23.8.1997	Blerje automjeti me kontratë nr. ***, datë 23.8.1997	-	-	458,026
gusht – dhjetor 1997	Të ardhurat nga pagat, subjekti	134,910		592,936
gusht – dhjetor 1997	Shpenzime jetike	-	53,964	538,972
1997	Ap. rr. “****”, pagesa këstesh për EKB-në	-	54,421	484,551
1998	Të ardhurat nga pagat, subjekti	420,640		905,191
1998	Shpenzime jetike	-	168,256	736,935
1998	Ap. rr. “****”, pagesa këstesh për EKB-në	-	14,835	722,100
1999	Të ardhurat nga pagat, subjekti	498,921		1,221,021
1999	Të ardhurat nga pagat, bashkëshortja	67,671		1,288,692
1999	Shpenzime jetike	-	226,637	1,062,055
1999	Ap. rr. “****”, pagesa këstesh për EKB-në	-	30,940	1,031,115
janar – shtator 2000	Të ardhurat nga pagat, subjekti	315,198	-	1,346,313
janar – shtator 2000	Të ardhurat nga pagat, bashkëshortja	68,218	-	1,414,531
janar – shtator 2000	Shpenzime jetike	-	324,000	1,090,531

16.10.2000	Pagesë 7.200 USD për blerje tokë truall, Tiranë	-	1,080,000	10,531
tetor – dhjetor 2000	Të ardhurat nga pagat, subjekti	105,066	-	115,597
tetor – dhjetor 2000	Të ardhurat nga pagat, bashkëshortja	43,631	-	159,228
tetor – dhjetor 2000	Shpenzime jetike	-	108,000	51,228
janar 2001	Të ardhurat nga pagat, subjekti	42,922	-	94,150
janar 2001	Të ardhurat nga pagat, bashkëshortja	8,088	-	102,238
janar 2001	Shpenzime jetike	-	36,000	66,238
19.2.2001	Pagesë 120.000 lekë për blerje tokë truall, Tiranë	-	120,000	-53,762
shkurt – dhjetor 2001	Të ardhurat nga pagat, subjekti	472,139	-	418,377
shkurt – dhjetor 2001	Të ardhurat nga pagat, bashkëshortja	112,897	-	531,274
shkurt – dhjetor 2001	Shpenzime jetike	-	396,000	135,274
2002	Të ardhurat nga pagat, subjekti	537,270	-	672,544
2002	Të ardhurat nga pagat, bashkëshortja	161,875	-	834,419
17.6.2002	Blerje tokë arë me sip. 600 m ² , ***, Tiranë	-	600,000	234,419
2002	Shpenzime jetike	-	375,456	-141,037
2003	Të ardhurat nga pagat, subjekti	640,961	-	499,924
2003	Të ardhurat nga pagat, bashkëshortja	190,626	-	690,550
2003	Shpenzime jetike	-	406,744	283,806
4.3.2003	Ap. rr. “***”, pagesa përfundimtare për EKB-në	-	386,536	-102,730
31.12.2003	Likuiditete <i>cash</i> , datë 31.12.2003 (8.000 USD)	-	869,520	-972,250
2003	Banesë sip. ndërtimi 436,1 m ² , rr. “***”, Tiranë	-	5,128,320	-6,100,570
	TOTALI	4,775,773	10,876,343	-6,100,570

3.66. Sa më lart, Komisioni konstaton se subjekti dhe personat e lidhur rezultojnë më një balancë negative në vlerën 6.100.570 lekë për kryerjen e shpenzimeve, shtesën e kursimeve, blerjen e pasurive dhe kryerjen e investimit në banesën objekt analize.

3.67. Lidhur me analizën financiare të vitit 2004, Komisioni vlerëson se qëndron konkluzioni fillestar se subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur mundësi financiare të ligjshme për ndërtimin e objektit dhe kryerjen e shpenzimeve gjatë vitit 2004, me një balancë negative prej 698.124 lekësh, për sa kohë që mbetet e pandryshuar vlera e investimit prej 4.000.000 lekësh, bazuar në deklarimin e subjektit në DIPP/2004 dhe vlera e shpenzimeve të udhëtimit prej 116.601 lekësh, referuar arsytimit në paragrafin 15.10 të këtij vendimi.

3.68. Në përfundim, referuar analizës financiare tërësore të investimit të kryer në banesën në rrugën “***”, për të gjithë burimet, rezulton se subjekti dhe personat e lidhur kanë mungesë të burimeve të ligjshme financiare: (i) në vlerën 6.100.570 lekë gjatë periudhës 1993 – 2003 për kryerjen e shpenzimeve, shtesën e kursimeve, blerjen e pasurive dhe kryerjen e investimit në banesën objekt analize, duke u gjendur në kushtet e germës “b” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016; (ii) në vlerën 698.124 lekë gjatë vitit 2004 për kryerjen e shpenzimeve dhe të investimit në banesën objekt analize, duke u gjendur në kushtet e germës “b” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

4. Apartament banimi me sipërfaqe 60 m², në Tiranë, me vlerë 50.500 euro

4.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar apartament banimi me sip. 60 m², në rrugën “****” (kontratë shitjeje me rezervë nr. ***, datë 8.8.2006, kontratë nr. ***, datë 15.2.2016, z. k. ***, nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***), në vlerën 50.000 euro, në bashkëpronësi të familjes në pjesë të barabarta. Si burim krijimi subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursimet nga pagat deri në vitin 2006, pakësim gjendje në vlerën 800.000 lekë dhe 600.000 lekë kursime vjetore, pjesa tjetër marrë hua pa interes nga një i njohur i tij në shumën 5.000.000 lekë. Në seksionin e të dhënave konfidenciale, subjekti ka deklaruar: “...*marrë hua pa interes F. K., i cili ushtron aktivitet tregtar në tregun ***, ‘****’ sh.p.k., në shumën 5.000.000 lekë (pa kontratë, me deklaratë)*”. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues¹²³.

4.2. Nga dokumentacioni i administruar nga sistemi elektronik i ASHK Tirana Veri¹²⁴ (nga notere M. D.¹²⁵ dhe shoqëria “****” sh.p.k.¹²⁶) rezulton se ndërmjet shoqërisë “****” sh.p.k. dhe subjektit të rivlerësimit Kudusi Shahu është lidhur kontrata e shitjes me rezervë nr. *** prot., datë 8.8.2006, me objekt “shitjen e apartamentit tip 6 (kulla 4) me sipërfaqe ndërtimi në total 73 m², i përbërë nga 67 m² sipërfaqe apartamenti plus 6 m² sipërfaqe në pjesën e përbashkët të shkallëve”. Në kontratë parashikohet se palët kanë rënë dakord që çmimi i shitjes të jetë 50.500 euro. Në kontratë përcaktohet se: (i) blerësi ka paguar vlerën 25.000 euro me nënshkrimin e kësaj kontrate; (ii) blerësi do të paguajë vlerën 25.500 euro brenda datës 15.9.2006 dhe se faturat që do të kryhen nga blerësi do të vërtetohen me faturat e shoqërisë. Gjithashtu, kontrata parashikon se kohëzgjatja e saj do të jetë deri në momentin e nënshkrimit të procesverbalit të marrjes në dorëzim të apartamentit të parashikuar brenda janarit të vitit 2007.

4.3. Më pas rezulton se ndërmjet shoqërisë “****” sh.p.k. dhe subjektit Kudusi Shahu është lidhur kontrata e shitjes nr. ***, datë 15.2.2016, me objekt “kalimi i pronësisë së apartamentit me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, me sip. 67 m², z. k. ***, Tiranë, shk. ***, kati ***, ap. ***, kundrejt çmimit 50.500 euro”. Në kontratë pasqyrohet se blerësi e ka paguar paraprakisht të gjithë çmimin e shitjes objekt kontrate sipas kontratës së shitjes me rezervë nr. *** prot., datë 8.8.2006.

4.4. Lidhur me datën e saktë kur subjekti është vënë në posedim të apartamentit, rezulton se sipas informacioni të administruar nga FSHU-ja¹²⁷ kontrata e furnizimit me energji elektrike për këtë apartament është lidhur në datën 6.2.2006 dhe sipas listës së faturimeve dhe pagesave¹²⁸ faturimi i konsumimit të energjisë elektrike në emër të subjektit figuron nga janari i vitit 2007.

¹²³Certifikatë për vërtetim pronësie datë 19.2.2016, në emër të z. Kudusi Shahu; kartelë e pasurisë së paluajtshme nr. ***, z. k. ***, Tiranë; kontratë shitjeje pasurie e paluajtshme nr. ***, datë 15.2.2016; certifikatë për vërtetim pronësie datë 7.11.2014, për apartamentin me nr. pasurie ***, z. k. ***, Tiranë, në emër të shoqërisë “****” sh.p.k.; certifikatë regjistrimi e personit të tatueshëm “****” sh.p.k., me datë regjistrimi 25.1.2000; deklaratë noteriale nr. ***, datë 24.1.2007, e shtetasit F. K.; vërtetim nr. *** prot., datë 25.1.2017, nga DRT-ja Tiranë për të ardhurat e realizuara nga aktiviteti i shoqërisë “****” sh.p.k.; deklaratë e shtetasit F. K. për likuidimin e shumës totale prej 5.000.000 lekësh, të dhënë Kudusi Shahut në vitin 2006.

¹²⁴Shkresë datë 21.4.2022.

¹²⁵Shkresë nr. *** prot., datë 11.4.2022.

¹²⁶Shkresë nr. *** prot., datë 26.4.2022.

¹²⁷Shkresë nr. *** prot., datë 20.7.2020.

¹²⁸Shkresë nr. *** prot., datë 28.4.2022.

4.5. Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e interesit të subjektit me shoqërinë “****” sh.p.k., me përfaqësues A. D., shoqërinë “****” sh.p.k., si dhe me ortakët e kësaj shoqërie (A. D., G. D. e A. D.) dhe nuk rezultoi se subjekti ishte në kushtet e konfliktit të interesit¹²⁹.

Burimet e krijimit

i) Hua në shumën 5.000.000 lekë nga shtetasi F. K.

4.6. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti ka paraqitur fotokopje të deklaratës të shtetasit F. K. të datës 20.12.2012, të vulosur me vulën e shoqërisë “****” sh.p.k., me anë të së cilës deklarohet se ushtron aktivitetin tregtar në tregun “****” dhe se z. Kudusi Shahu i ka shlyer me këste në vite të gjithë detyrimin prej 5.000.000 lekësh¹³⁰, vlerë të cilën e ka marrë për blerje apartamenti pa interesa. Gjithashtu ka paraqitur edhe deklaratën noteriale nr. ***, datë 24.1.2017, të shtetasit F. K., cili ka konfirmuar edhe një herë deklarimin e mësipërm¹³¹. Gjithashtu rezultoi se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar marrjen e huas në shumën 5.000.000 lekë shtetasit F. K. edhe në DIPP/2006¹³².

4.7. *Lidhur me shlyerjen e huas*, subjekti ka deklaruar: (i) në DIPP/2008 shlyerje detyrimi në shumën 1.500.000 lekë dhe gjendje detyrimi në shumën 3.500.000 lekë; (ii) në DIPP/2009 shlyerje detyrimi në shumën 1.000.000 lekë dhe gjendje detyrimi në shumën 2.500.000 lekë; (iii) në DIPP/2011 shlyerje detyrimi në shumën 1.000.000 lekë dhe gjendje detyrimi në shumën 1.500.000 lekë; (iv) në DIPP/2012 shlyerje detyrimi në shumën 1.500.000 lekë dhe gjendje detyrimi 0 (zero) lekë.

4.8. Në kushtet e ekzistencës së marrëdhënies së huas ndërmjet subjektit dhe shtetasit F. K., të konfirmuar nga të dy palët, bazuar në pikën 14 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, ky shtetas konsiderohet “person tjetër i lidhur” dhe, si pasojë, në zbatim të pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës së dhënë hua nga shtetasi F. K.

4.9. Për sa i përket ligjshmërisë së burimit të shumës 5.000.000 lekë, referuar informacionit të përcjellë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë¹³³, rezultoi se shoqëria “****” sh.p.k. nuk ka shpërndarë dividend për periudhën 2000 – 2006. Për këtë arsye, me anë të pyetësorit nr. 1¹³⁴, Komisioni i kërkoi subjektit të saktësonte burimin e të ardhurave të shtetasit F. K. për huan e dhënë. Në përgjigje¹³⁵ të tij, subjekti i rivlerësimit sqaroi se nga komunikimi që ka pasur me z. K., ky i fundit e ka sqaruar se shumën (e dhënë hua) nuk e ka tërhequr nga dividendi i shpërndarë, por e ka tërhequr nga likuiditeti i xhiros së biznesit në formën e “borxhit ndaj pronarit”, i cili është shënuar në regjistrat përkatës të biznesit dhe për shkak të kalimit të kohës së gjatë nuk është në gjendje të paraqesë dokumentacionin justifikues të ngjarjeve ekonomike të ndodhura dhe të kontabilizuara në atë kohë. Për vërtetimin e deklarimit subjekti i rivlerësimit

¹²⁹Shkresë nr. *** prot., datë 28.9.2022, e Prokurorisë së Përgjithshme.

¹³⁰Me shifra ka shkruar 500.000 lekë, ndërsa me fjalë “pesë milionë”.

¹³¹“Me z. Kudusi Shahu kam marrëdhënie të ngushta shoqërore dhe miqësore. Në vitin 2006, për shkak se në atë periudhë do të blinte një apartament në rrugën ‘****’, i kam dhënë cash, jashtë zyrës noteriale, një hua në shumën 5.000.000 lekë në vitin 2006, të cilën e ka shlyer me këste në vite të gjithë shumën e lartpërmendur. Kjo shumë është dhënë për shkak të mundësive të mia pasi unë ushtroj aktivitet tregtar në tregun ‘****’ dhe jam administrator dhe ortak i vetëm i shoqërisë ‘****’ sh.p.k.”.

¹³²Ku ka deklaruar si një nga burimet e krijimit të pasurisë apartament marrje huaje të afërmeve të tij dhe në seksionin e detyrimeve financiare ndaj personave juridikë/fizikë ka deklaruar: “Marrje borxh për blerje apartamenti një të afërmi tim në vitin 2006 pa interesa në shumën 5.000.000 lekë” dhe në seksionin e të dhënave konfidenciale ka deklaruar: “Marrë borxh për blerje apartamenti në vitin 2006, F. K. në shumën 5.000.000 lekë”.

¹³³Shkresë nr. *** prot., datë 18.5.2022.

¹³⁴Email datë 21.6.2022.

¹³⁵Protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.7.2022.

ka paraqitur shkresën nr. *** prot., datë 29.6.2022, të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, ku janë përcjellë zhdoganimet e kryerja nga subjekti tregtar “****” sh.p.k.

4.10. Në vijim të shpjegimeve të subjektit, Komisioni analizoi pasqyrat financiare të shoqërisë tregtare “****” sh.p.k. për periudhën 2000 – 2012 për të verifikuar nëse kjo hua, e cila sipas deklarimeve të subjektit është dhënë në formën e “borxhit ndaj pronarit”, është pasqyruar në pasqyrat financiare të kësaj shoqërie e më tej nëse është reflektuar kthimi i saj sipas deklarimeve të subjektit. Nga analizimi i pasqyrave financiare të përcjella nga DRT-ja Tiranë u konstatua që shoqëria “****” sh.p.k. ka pasur të drejta ndaj ortakut/debitorëve në datën 31.12.2005 shumën 12.000.000 lekë, e cila potencialisht mund të ketë të përfshirë edhe huan e deklaruar nga subjekti në vitin 2006. Po kështu evidentohet që kjo shoqëri ka pasur qarkullime fondesh në shuma të konsiderueshme, bazuar kjo në volumin e lartë të zhdoganimeve të kryer (pa përfshirë TVSH-në) prej 129.823.782 lekësh për vitet 2003 – 2005. Vetëm në vitin 2005 qarkullimi ka qenë në vlerën 36.500.000 lekë pa TVSH (ose 43.800.000 lekë me TVSH), ndërsa gjendja e likuiditeteve në datën 31.12.2005 ka qenë në vlerën 11.246.892 lekë, tregues këta që duken të mjaftueshëm për të kryer transaksionin objekt hetimi.

4.11. Sa më sipër, trupi gjykues i Komisionit arrin në përfundimin se “personi tjetër i lidhur”/huadhënësi F. K. ka pasur burime të ligjshme financiare për dhënien e huas në vlerën 5.000.000 lekë.

4.12. Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e interesit të subjektit me shtetasin F. K. dhe me shoqërinë “****” sh.p.k., nga i cili rezultoi se subjekti nuk ishte në kushtet e konfliktit të interesit¹³⁶.

ii) Kursimet nga pagat deri në vitin 2006 (pakësim i gjendjes në vlerën 800.000 lekë dhe 600.000 lekë kursime vjetore)

4.13. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti ka deklaruar si një nga burimet e krijimit të kësaj pasurie kursimet nga pagat deri në vitin 2006, pakësim gjendje 800.000 lekë, si dhe 600.000 lekë kursime vjetore. Në DIPP/2006 ka deklaruar pakësim gjendje 800.000 lekë dhe 600.000 lekë kursime vjetore.

4.14. Në kushtet kur nuk provohet data e dhënies së huas së deklaruar në vlerën 5.000.000 lekë, e cila prezumohet të ketë shërbyer për të dyja kështet dhe në kushtet e mungesës së dokumentacionit ligjor provues për pagesat e kësteve (mandateve/transfertave bankare), Komisioni kreu analizën financiare në datën 15.9.2006, duke u bazuar në termat e pagesës të cituara në kontratën e porosisë (25.000 euro ditën e nënshkrimit të kontratës, 8.8.2006, dhe 25.500 euro në datën 15.9.2006).

4.15. *Lidhur me pakësimin e gjendjes cash në vlerën 800.000 lekë*, Komisioni analizoi deklaratimet e subjektit lidhur me likuiditet *cash* jashtë sistemit bankar ndër vite (trajtuar në pikën 12 të këtij vendimi). Duke qenë se në DIPP/2005 nuk u konstatuan deklarime lidhur me kursime *cash* jashtë sistemit bankar, me anë të pyetësorit nr. 1¹³⁷, Komisioni i kërkoi subjektit të jepte sqarime se cilave likuiditeteve i referohej për burimin e shumës 800.000 lekë të përdorur për blerjen e apartamentit. Në përgjigje¹³⁸ të tij, subjekti deklaroi se i referohet deklaratës së vitit

¹³⁶Shkresë nr. *** prot., datë 22.6.2022, e Prokurorisë së Posaçme; shkresë nr. *** prot., datë 16.6.2022, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; shkresë nr. *** prot., datë 28.9.2022 e Prokurorisë së Përgjithshme.

¹³⁷Email datë 21.6.2022.

¹³⁸Protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.7.2022.

2003, ku është deklaruar gjendja *cash* në shumën 8.000 USD. Kjo shumë, deklaroi subjekti, është konvertuar me kursin 1 USD = 100 lekë, duke u përfituar shuma 800.000 lekë.

4.16. Komisioni konstaton se subjekti është kontradiktor në deklaratimet e tij, pasi nga analizimi i DIPP-ve për vitet 2003 – 2005 rezultoi se likuiditetet *cash* në vlerën 8.000 USD, të deklaruara në deklaratën e parë të pasurisë të vitit 2003, janë pakësuar 1 vit më vonë, pra në vitin 2004. Sipas deklaratimit në DIPP/2004, vlera prej 8.000 USD është përdorur për ndërtimin e banesës 2 kate + papafingo në Tiranë. Për rrjedhojë, vlera 8.000 USD nuk mund të ketë shërbyer për blerjen e apartamentit në Tiranë dhe, për këtë arsye, ato nuk mund të kenë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit.

4.17. Lidhur me kursimet vjetore prej 600.000 lekësh, Komisioni kreu analizën financiare në datën 15.9.2006 për të verifikuar nëse subjektit dhe personat e lidhur kanë pasur mundësi të ligjshme financiare për të kursyer deri në këtë datë shumën 373.120 lekë (6.173.120 lekë¹³⁹ - 5.000.000 lekë - 800.000 lekë = 373.120 lekë). Në këtë analizë u konsideruan: (i) të ardhurat nga pagat e subjektit¹⁴⁰ dhe bashkëshortes¹⁴¹; (ii) shpenzimet e jetesë sipas ILDKPKI – INSTAT¹⁴²; (iii) shpenzimet për udhëtime nga sistemi TIMS¹⁴³; (iv) pakësimi i gjendjes së llogarive bankare¹⁴⁴; dhe (v) blerja e apartamentit. Të ardhurat e realizuara nga dhënia e kurseve të gjuhës angleze nuk u përfshinë në analizën financiare, sipas trajtimit dhe arsyetimit në pikën 10 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

4.18. Nga analiza financiare e kryer për periudhën 1.1.2006 – 15.9.2006 vetëm për verifikimin e kursimeve në vitin 2006 rezultoi një balancë pozitive në vlerën 188.467 lekë.

4.19. Për rrjedhojë, në përfundim të analizës së kryer për burimet e ligjshme për blerjen e këtij apartamenti, rezultoi një balancë negative prej 800.000 lekësh, si pasojë e deklaratimeve kontradiktore të subjektit lidhur me pakësimin e vlerës 8.000 USD.

4.20. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi barrën e provës dhe i kërkoi subjektit të rivlerësimi të paraqesë shpjegime në lidhje me konstatimin se *subjekti dhe personat e lidhur kanë mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën 800.000 lekë për blerjen e apartamentit me sip. 60 m², në Tiranë.*

4.21. Në përgjigje¹⁴⁵ të tij, subjekti pretendoi se balanca pozitive e rezultuar nga analiza financiare në datën 15.9.2006, e kryer nga Komisioni, nuk mund të përjashtohet dhe të mos përfshihet në mundësinë e kursimit të deklaruar, pra të gjendjes *cash* të kursyer. Analiza nuk i referohet deklaratës vjetore në të cilën edhe pse analizat financiare mund të rezultojnë me diferenca pozitive, për sa kohë nuk ka një deklaratim të gjendjes *cash* të shtuar, nuk merren në konsideratë, vijoi subjekti. Më tej, ai shpjegoi se *në këtë rast jemi në mes të një periudhe deklarimi dhe nuk ka sens logjik që gjendja pozitive e rezultuar të mos përfshihet si gjendje*

¹³⁹Ekuivalenti në lekë sipas shkresës nr. *** prot., datë 26.4.2022, të shoqërisë “*****”. E njëjta vlerë rezulton edhe sipas kursit zyrtar të këmbimit të datës 8.8.2006, 1 euro = 122,24 lekë.

¹⁴⁰Totali i pagave të kredituara në “Raiffeisen Bank”, periudha 1.1.2006 – 15.9.2006.

¹⁴¹Totali i pagave të kredituara në “Credins Bank”, periudha 1.1.2006 – 15.9.2006.

¹⁴²Në mënyrë përpjesëtimore për 8.5 muaj.

¹⁴³Për periudhën 1.1.2006 – 15.9.2006.

¹⁴⁴Diferenca midis gjendjes së llogarive në datën 15.9.2006 me atë të datës 31.12.2005.

¹⁴⁵Parashtrime dhe prova të dorëzuara në datën 5.12.2022, me nr. ***, prot., si dhe me *email*-in e datës 3.12.2022 dhe datës 4.12.2022.

cash e kursyer deri në atë periudhë dhe nëse do të përfshihej kjo diferencë pozitive gjendja e cash e kursyer deri më datën 15.9.2006 do të ishte 561.787 lekë.

4.22. Analiza e ndërtuar, duke përfshirë edhe të ardhurat e bashkëshortes, për të cilat janë paguar tatimet për këto të ardhura, si dhe duke zbritur shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit për shkak se ato janë përballuar nga njerëzit e tij, paraqitet me balancë pozitive në vlerën 101.719 lekë, përfundoi subjekti.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

4.23. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratat e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratat në seancë dëgjimore – arsyeton se:

4.24. *Pretendimi i subjektit se nga ana e Komisionit të merren në konsideratë në analizën financiare të ardhurat e bashkëshortes nga dhënia e kurseve të gjuhës angleze në banesë për vitet 2006 – 2016 në vlerën 3.300.000 lekë, u gjend i pabazuar nga Komisioni, referuar trajtimit dhe arsytimit në lidhje me këto të ardhura në pikën 10 të këtij vendimi.*

4.25. *Për sa i përket pretendimit të subjektit për përfshirjen e balancës pozitive të rezultuar nga analiza financiare në datën 15.9.2006 si gjendje cash e kursyer deri në atë periudhë, Komisioni thekson se balanca negative në vlerën 800.000 lekë nuk lidhet me kursimet potenciale të vitit 2006, por me deklaratat kontradiktore të subjektit për pakësimin e vlerës 8.000 USD.*

4.26. Sipas deklaratimit në DIPP/2004, vlera 8.000 USD është përdorur për ndërtimin e banesës 2 kate + papafingo në Tiranë dhe, për rrjedhojë, kjo vlerë nuk mund të ketë shërbyer për blerjen e apartamentit në Tiranë në vitin 2006. Në kushtet që në vitin 2005 nuk janë deklaruar likuiditete *cash*, duket i pakuptimtë deklarimi i subjektit në DIPP/2006 se apartamenti është blerë me pakësim 800.000 lekë të deklaruar në deklaratën e mëparshme.

4.27. Për më tepër që analiza financiare e paraqitur nga subjekti është kryer deri në fund të vitit kalendarik dhe jo deri në datën 15.9.2006, datë në të cilën është kryer pagesa bazuar në termat e pagesës të cituara në kontratën e porosisë.

4.28. *Lidhur me vlerën e shpenzimeve të udhëtimit, të cilat në analizën e kryer nga subjekti janë pasqyruar në vlerën 8.659 lekë, ajo mbeti e pandryshuar në analizën financiare¹⁴⁶, pasi, siç është shpjeguar në metodikën e analizës financiare¹⁴⁷, nuk është konsideruar marrja përsipër e shpenzimeve nga personat me të cilët është udhëtuar¹⁴⁸, pasi nuk është deklaruar prej subjektit të rivlerësimit në deklaratën periodike vjetore në rubrikën “dhurata dhe trajtime preferenciale”.*

4.29. Referuar në sa më lartarsyetuar, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultatit të hetimit administrativ, për rrjedhojë, subjekti dhe personat e lidhur kanë mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën 800.000 lekë, në datën 15.9.2006, për blerjen e

¹⁴⁶Vlera 147.043 lekë e përlllogaritur nga Komisioni.

¹⁴⁷Subjektit i është vendosur në dispozicion Aneksi nr. 2 – Metodika e analizës financiare, bashkëlidhur relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

¹⁴⁸(i) F. K., deklaratë noteriale nr. ***, datë 5.7.2022; (ii) S. B., deklaratë noteriale nr. ***, datë 6.7.2022

apartamentit me sip. 60 m², në Tiranë, duke u gjendur në kushtet e germës “b” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

5. Apartament me sipërfaqe 95 m², në *, Kavajë, me vlerë 57.000 euro**

5.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar apartament me sip. 95 m², në ***, Kavajë, në vlerën 57.000 euro, me pjesë takuese 50%. Si burim krijimi subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime nga paga e tij dhe e bashkëshortes dhe marrje huaje pa interes nga i afërmi i tij në shumën 30.000 euro, si dhe vazhdon detyrimi i mbartur në shumën 10.000 euro. Në seksionin “detyrime financiare...”, ka deklaruar: *“Marrë hua kushëririt B. Sh. H. për shlyerje apartamenti në ***, në shumën 30.000 euro”*. Në seksionin “të dhëna konfidenciale”, pasi deklaroi kontributin e vëllait të tij B. Sh. në ndërtimin e banesës në rrugën “****”, ka deklaruar se: *“...vëllai ka kontribuar dhe në arredimin dhe rregullimin e banesës në ***, duke u bërë automatikisht bashkëpronar me marrëveshje në këtë apartament, duke e shfrytëzuar bashkërisht sipas nevojave. Vlera e përgjithshme gjithë kontributit si në ndërtimin e banesës sipërcituar në Tiranë dhe asaj në *** arrin afërsisht vlerën 27.000 euro”*. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues¹⁴⁹.

5.2. Në DIPP/2009 subjekti ka deklaruar: *“Apartament me sip. 95 m², i ndodhur ***, Kavajë, i prenotuar në vitin 2009 me vlerë 57.000 euro, me hua të marrë nga kushëri”*¹⁵⁰. Në seksionin “të dhëna konfidenciale”, ka deklaruar: *“Marrë hua nga kushëri B. Sh. H. me banim në Paris, Francë, me vlerë 30.000 euro”*.

5.3. Subjekti nuk e ka deklaruar bashkëpronësinë me vëllain e tij në DIPP/2009. Më pas, në DIPP/2011, ka deklaruar: *“Apartament me sip. 95 m², i ndodhur në ***, Kavajë, i deklaruar në vitin 2009, i prenotuar nga firma ‘****’ në vlerën 57.000 euro, nga të cilat paguar në 2009-ën vlera 30.000 euro, në bashkëpronësi me vëllain, i cili ka detyrimin për të paguar pjesën tjetër të vlerës prej 27.000 euro”*.

5.4. Në përgjigje të pyetësorit standard¹⁵¹, subjekti ka deklaruar: *“Në vitin 2011, blerje apartamenti me sip. 95 m², ***, Kavajë, me vlerë 57.000 euro. Burimi i krijimit kursime nga paga ime dhe e bashkëshortes, si dhe marrë hua pa interes nga i afërmi im B. H. në shumën 30.000 euro. Vazhdon detyrimi ndaj ‘****’ në shumën 10.000 euro”*.

5.5. Në procesverbalin e datës 1.2.2016 të ILDKPKI-së¹⁵² subjekti ka deklaruar se: *“...kontrata e shitblerjes është nënshkruar në emrin tim, por apartamenti është në bashkëpronësi me vëllain tim, sipas deklaratimit tim vëllai ka investuar 27.000 euro për blerje dhe arredim apartamenti...”*.

5.6. Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting* 2017, të administruar edhe nga ASHK-ja Kavajë¹⁵³, Drejtoria Vendore e Zonave të Stimuluara të ASHK-së¹⁵⁴ dhe notere M. Ll.¹⁵⁵, rezulton se ndërmjet shoqërisë “****” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit, dhe subjekti të rivlerësimit, në cilësinë e porositësit, pasi kishin lidhur më parë

¹⁴⁹Certifikatë për vërtetim pronësie datë 12.4.2016; kartelë e pasurisë së paluajtshme, datë regjistrimi 11.4.2016; kontratë për ndërtim apartamenti nr. *** prot., datë 11.2.2011; revokim kontrate nr. ***, datë 11.2.2011; kontratë për ndërtim apartamenti nr. ***, datë 29.5.2009; leje legalizimi nr. ***, datë 26.11.2015; genplan; vërtetim nr. ***, datë 11.1.2017, nga shoqëria “****” sh.p.k.

¹⁵⁰Në kolonën e vlerës së pasurisë ka vendosur 30.000 euro.

¹⁵¹Email datë 27.7.2020.

¹⁵²Shkresë nr. *** prot., datë 8.4.2022.

¹⁵³Shkresë nr. *** prot., datë 10.9.2020.

¹⁵⁴Shkresë nr. *** prot., datë 9.9.2020.

¹⁵⁵Shkresë e datës 11.4.2022.

një kontratë porosie, të cilën më pas e kanë revokuar¹⁵⁶, është lidhur kontrata “për ndërtim apartamenti” nr. *** prot., datë 11.2.2011, ku është parashikuar detyrimi i sipërmarrësit të ndërtojë për subjektin apartamentin *** në vilën nr. ***, me sipërfaqe apartamenti 95 m², kati i parë, i përbërë nga 1 dhomë dite, kënd gatimi, 2 dhoma gjumi, 1 banjo dhe 1 ballkon. Gjithashtu përcaktohet se çmimi i sipërmarrjes është në shumën 57.000 euro, që do të paguhet nga porositësi me firmosjen e kontratës dhe pagesat do të vërtetohen me mandatarkëtimet e lëshuara nga sipërmarrësi. Në deklaratë *Vetting* 2017 subjekti i rivlerësimit ka paraqitur vërtetimin nr. *** prot., datë 11.1.2017, të shoqërisë “****” sh.p.k., e cila vërteton se për llogari të çmimit të porosisë subjekti ka likuiduar vlerën 47.000 euro dhe mbetet debitor ku detyrohet ende të likuidojë vlerën 10.000 euro.

5.7. Sipas kartelës së pasurisë së paluajtshme të përcjellë nga ASHK-ja Kavajë, rezulton se pasuria nr. ***, z. k. ***, e llojit “apartament” me sip. 83 m², sipas regjistrimit të datës 11.4.2016 është regjistruar në pronësi të subjektit dhe bashkëshortes së tij.

5.8. Në vijim rezulton se në emër të subjektit është plotësuar formulari i ALUIZNI-t, “Për kalimin e të drejtës së pronësisë mbi truallin e njësisë së ndërtuar”, datë 11.10.2011. Me kontratën e shitjes nr. ***, datë 6.3.2012, subjekti ka blerë nga ALUIZNI sipërfaqen takuese të truallit të njësisë në bashkëpronësi me banorët e tjerë kundrejt shumës 36.471 lekë, e cila sipas mandatit të “Credins Bank” është paguar paraprakisht nga subjekti në datën 16.12.2009. Gjithashtu, sipas mandatpagesës të datës 16.12.2011, të “Credins Bank”, subjekti ka paguar tarifën e aplikimit të zonave turistike në shumën 979 lekë¹⁵⁷. Më pas, subjekti është pajisur me lejen e legalizimit nr. ***, datë 25.11.2015, për apartamentin me nr. pasurie ***, z. k. ***, me sip. 83 m², me pjesë takuese në parcelën ndërtimore 32,6 m², me adresë fshati turistik “****”, ***, Kavajë.

5.9. Gjithashtu rezulton se sipas mandatpagesës datë 29.12.2015, të “Credins Bank”, subjekti ka paguar shumën 13.000 lekë në favor të ZVRPP-së Kavajë dhe në kartelën e pasurisë së paluajtshme të ASHK-së subjekti dhe bashkëshortja e tij figurojnë bashkëpronarë të pasurisë nr. ***, me sip. 83 m², z. k. ***, vol. ***, f. ***, me vendndodhje në ***, Kavajë.

5.10. FSHU-ja¹⁵⁸ informon se kontrata e furnizimit me energji elektrike e apartamentit është lidhur në datën 14.10.2013 dhe sipas listës së faturimeve faturimi dhe pagesa fillojnë nga tetori i vitit 2013.

5.11. Shoqëria “****” sh.p.k.¹⁵⁹ informon se palët porositëse kanë shlyer detyrimet sipas mandatarkëtimeve, konkretisht: në datën 9.5.2009 është likuiduar shuma 10.000 euro; në datën 29.5.2009 është likuiduar shuma 7.000 euro; në datën 16.6.2009 është likuiduar shuma 10.000 euro; në datën 21.8.2010 është likuiduar shuma 10.000 euro dhe në datën 30.7.2011 është likuiduar shuma 10.000 euro. Gjithashtu kjo shoqëri ka sqaruar se vlera totale e paguar është në shumën 47.000 euro, duke mbetur për t’u paguar shuma 10.000 euro. Bashkëlidhur janë përcjellë kopje të mandatarkëtimeve përkatëse.

5.12. Nga shqyrtimi i mandateve rezulton se në mandatarkëtimin me nr. serie ***, datë 30.7.2011, në shumën 10.000 euro, pasqyrohet në cilësinë e arkëtuesit shtetasi B. Sh.

¹⁵⁶Kontratë “për ndërtim apartamenti”, nr. ***, datë 29.5.2009, e revokuar me aktin noterial “revokim kontrate”, nr. ***, datë 11.2.2011.

¹⁵⁷Në analizën financiare u paraqit vlera totale prej 37.450 lekësh.

¹⁵⁸Shkresë nr. *** prot., datë 13.6.2022.

¹⁵⁹Shkresë nr. *** prot., datë 15.6.2022.

5.13. Nga hetimi administrativ kryesisht rezulton se për sa i përket pagesave për këtë apartament konstatohen mospërputhje midis dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria “****” sh.p.k. dhe deklarimeve të subjektit, si në vijim:

- Shoqëria “****” sh.p.k. informon se në vitin 2009 janë paguar 27.000 euro, ndërkohë që subjekti ka deklaruar se në këtë vit ka paguar 30.000 euro¹⁶⁰.
- Shoqëria “****” sh.p.k. informon se në vitin 2010 janë paguar 10.000 euro, ndërkohë që subjekti nuk ka deklaruar asnjë pagesë gjatë këtij viti kalendarik.
- Shoqëria “****” sh.p.k. informon se në vitin 2011 janë paguar 10.000 euro, ndërkohë që subjekti nuk ka deklaruar asnjë pagesë gjatë këtij viti kalendarik (mandati ku shfaqet vëllai në cilësinë e arkëtuesit).

5.14. Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 1¹⁶¹, i kërkoi subjektit të shpjegojë arsyen që shoqëria “****” sh.p.k. i ka kaluar pronësinë e apartamentit pa shlyer detyrimin në shumën 10.000 euro. Në përgjigje¹⁶² të tij, subjekti deklaroi se pasuria objekt kontrate (e porosisë) është ndërtuar në godinat e kompleksit të shpallur zonë e stimuluar në qëllim krijimin e fshatrave turistikë dhe shoqëria është marrë me procedurën e legalizimit të apartamenteve të të gjithë banorëve të godinës. Në vijim, deklaroi se marrëdhënia e detyrimit me shoqërinë në shumën 10.000 euro vijon të jetë e tillë deri në zgjidhjen e mosmarrëveshjes lidhur me detyrimet financiare që kanë ardhur si pasojë e faturave që ka likuiduar pranë ALUIZNI-t në funksion të procesit të blerjes së truallit. Gjithashtu subjekti deklaroi se nuk ka ndonjë pengesë ligjore për kalimin e pronësisë, pasi Kodi Civil në nenin 747 rregullon pozitat e palëve kur është paguar 2/3 e çmimit të pronës.

5.15. Nga hetimi administrativ kryesisht rezulton se për sa i përket pagesave për këtë apartament konstatohen mospërputhje midis dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria “****” sh.p.k. dhe deklarimeve të subjektit, si vijon:

- Shoqëria “****” sh.p.k. informon se në vitin 2009 janë paguar 27.000 euro, ndërkohë që subjekti ka deklaruar se në këtë vit ka paguar 30.000 euro¹⁶³.
- Shoqëria “****” sh.p.k. informon se në vitin 2010 janë paguar 10.000 euro, ndërkohë që subjekti nuk ka deklaruar asnjë pagesë gjatë këtij viti kalendarik.
- Shoqëria “****” sh.p.k. informon se në vitin 2011 janë paguar 10.000 euro, ndërkohë që subjekti nuk ka deklaruar asnjë pagesë gjatë këtij viti kalendarik (mandati ku shfaqet vëllai në cilësinë e arkëtuesit).

5.16. Për efekt të analizës financiare, Komisioni u bazua në dokumentacionin e përcjellë nga shoqëria “****” sh.p.k.

5.17. Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e interesit të subjektit me shoqërinë “****” sh.p.k., administratorin A. C. dhe ortakun G. S. dhe nuk rezultoi se subjekti ishte në kushtet e konfliktit të interesit¹⁶⁴.

¹⁶⁰Referuar deklarimeve në DIPP-të e viteve 2009 dhe 2011.

¹⁶¹Email datë 21.6.2022.

¹⁶²Protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.7.2022.

¹⁶³Referuar deklarimeve në DIPP-të e viteve 2009 dhe 2011.

¹⁶⁴Shkresë nr. *** prot., datë 22.6.2022, e Prokurorisë së Posaçme; shkresë nr. *** prot., datë 16.6.2022, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; shkresë nr. *** prot., datë 28.9.2022, e Prokurorisë së Përgjithshme.

Burimet e krijimit

i) Kursime nga paga e subjektit dhe e bashkëshortes

5.18. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* 2017 si një nga burimet e krijimit të pasurisë apartament në ***, Kavajë, të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes, ndërkohë që në DIPP/2009, kur ka lidhur kontratën e parë të sipërmarrjes, ka deklaruar si burim vetëm huan e marrë nga kushëriri i tij B. H. në shumën 30.000 euro. Në DIPP/2011, kur ka lidhur kontratën e re të sipërmarrjes, nuk ka deklaruar si burim kursime nga paga e tij dhe e bashkëshortes, por pasi deklaroi se ka paguar shumën 30.000 në vitin 2009 për prenotimin e apartamentit, deklaroi bashkëpronësinë me vëllain e tij dhe detyrimin e këtij të fundit për të paguar pjesën tjetër të vlerës prej 27.000 euro.

ii) Hua në shumën 30.000 euro nga shtetasi B. H.

5.19. Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* 2017 si burim për krijimin e pasurisë apartament në ***, Kavajë, hua nga i afërmi i tij në shumën 30.000 euro. Subjekti, për të provuar deklarinimin e tij, ka paraqitur dokumentacionin provues¹⁶⁵.

5.20. Rezulton se subjekti e ka deklaruar huan e marrë nga shtetasi B. H. në DIPP/2009, kur ka deklaruar për herë të parë pasurinë apartament në ***, Kavajë. Në deklaratën noteriale nr. ***, datë 27.3.2010, të paraqitur në deklaratën *Vetting* 2017 dhe të administruar edhe nga notere M. Ll.¹⁶⁶, shtetasi B. H. deklaroi se në periudhën mars – prill të vitit 2009 i ka dhënë hua pa afat kushëririt të tij Kudusi Shahu vlerën monetare prej 30.000 euro, pa afat, me qëllim përdorimin për nevojat e tij dhe të familjes. Lidhur me kthimin e kësaj vlere ka deklaruar se është dakord që kthimi i saj të realizohet në një periudhë të mëvonshme, herë pas here, sipas mundësive të tij të shlyerjes.

5.21. Deri në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* 2017 kjo hua nuk është shlyer, siç është deklaruar edhe nga subjekti në seksionin e detyrimeve, konkretisht “marrë hua ndaj kushëririt B. Sh. H., banues në rr. ***, për shlyerje apartamenti në ***. Shuma 30.000 euro”.

5.22. Bazuar në pikën 14 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, shtetasi B. H. konsiderohet “person tjetër i lidhur” me subjektin e rivlerësimit për shkak të marrëdhënies së huas që ekziston ndërmjet tyre dhe të pranuar nga të dyja palët dhe, në zbatim të pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, subjekti ka detyrimin të paraqesë dokumentacionin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës së dhënë hua nga shtetasi B. H. Në këto kushte, Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 1¹⁶⁷, i kërkoi subjektit të paraqesë dokumentacionin ligjor justifikues të të ardhurave të realizuara nga shtetasi B. H. deri në mars të vitit 2009. Në përgjigje¹⁶⁸ të tij, subjekti deklaroi se është në pritje të nisjes së dokumenteve nga shtetasi B. H. dhe do t’i vërë në dispozicion të Komisionit sapo t’i mundësohet.

iii) Kontributi i vëllait/shtetasi B. Sh. në vlerë të papërcaktuar

5.23. Në deklaratën *Vetting* 2017 subjekti ka deklaruar se vëllai i tij B. Sh. ka kontribuar edhe në arredimin dhe rregullimin e banesës në ***, duke e shfrytëzuar bashkërisht sipas nevojave. Gjithashtu ka deklaruar se vlera e përgjithshme e kontributit të tij, ku përfshihet edhe kontributi në ndërtimin e banesës në rrugën “****”, është afërsisht në vlerën 27.000 euro, si dhe ka

¹⁶⁵Deklaratë noteriale nr. ***, datë 27.3.2010, të shtetasis B. H.

¹⁶⁶Shkresë e datës 3.6.2022.

¹⁶⁷Email datë 21.6.2022.

¹⁶⁸Protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.7.2022.

paraqitur deklaratën noteriale nr. ***, datë 24.1.2017, të shtetasit B. Sh., i cili deklaroi se: “Z. Kudus Shahu është vëllai im dhe për shkak të lidhjes familjare kam kontribuar në vite në ndërtimin e banesës në rrugën ‘****’, si dhe në blerjen dhe rikonstrukcionin e apartamentit të ndodhur në ***, Durrës... në vlerën monetare totale... 27.000 euro...”.

5.24. Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 1¹⁶⁹, i kërkoi subjektit të saktësonte shumën e kontributit të vëllait B. Sh. në pasurinë “banesë 2 kate + papafingo + bodrum” dhe në pasurinë apartament në ***, Kavajë. Gjithashtu, subjektit iu kërkua të specifikojë periudhën e përfitimit të kësaj vlere, mënyrën e përfitimit të saj (cash apo me transfertë bankare) dhe të paraqesë dokumentacion justifikues. Në përgjigje¹⁷⁰ të tij, subjekti deklaroi se shuma e kontributit të vëllait të tij për banesën në rrugën “****” dhe banesën në ***, Kavajë, ka qenë në total 27.000 euro dhe se kjo shumë është përfituar në vite dhe kontributi ka qenë formal, pa pasur nevojë për dokumentacion justifikues, pasi ka qenë marrëveshje ndërmjet vëllezërve. Për të ardhurat e realizuar nga vëllai i tij gjatë periudhës prill 1999 – korrik 2002 në shtetin anglez deklaroi se po bën kërkime për dokumentacionin përkatës dhe do ta vërë në dispozicion të Komisionit sapa t’i mundësohet. Ndërsa, për mënyrën e përfitimit, deklaroi se transferimi i të ardhurave në pjesën më të madhe është bërë nëpërmjet W. U., por është në vështirësi për të gjetur dokumentacionin përkatës për arsye se ky institucion nuk i ruan dokumentet për një periudhë më tepër se 5-vjeçare.

5.25. Sa më lart, subjekti nuk përcaktoi saktësisht vlerën e kontributit të vëllait në secilën banesë apo kontributin në arredimin e apartamentit në ***.

Lidhur me deklarinë se apartamenti është në bashkëpronësi me vëllain e tij B. Sh.

5.26. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm rezulton se në emër të subjektit figurojnë: (i) kontrata e sipërmarrjes nr. ***, datë 29.5.2009, për ndërtimin e apartamentit; (ii) kontrata nr. ***, datë 6.3.2012, për blerjen e truallit; (iii) leja e legalizimit; (iv) mandatpagesat e “Credins Bank” për tarifën e aplikimit për kalimin e pronësisë së truallit dhe blerjen e truallit; (v) kartela e pasurisë së paluajtshme e ASHK-së; dhe (vi) mandatarkëtimet e datave 9.5.2009, 29.5.2009, 16.6.2009 dhe 21.8.2010 në shumën totale 37.000 euro, ndërsa vëllai i tij B. Sh. figuron si arkëtues i shumës 10.000 euro në mandatarkëtimin e datës 30.7.2011.

5.27. Sa më sipër, nuk rezulton që shtetasi B. Sh. të ketë fituar bashkëpronësinë mbi apartamentin në një nga mënyrat e përcaktuara në Kodin Civil apo me ligj të veçantë. Deklarimi i subjektit se vëllai i tij B. Sh. ka kontribuar në blerjen e apartamentit në një shumë të caktuar, konfirmimi i këtij deklarimi nga ky i fundit, si dhe fakti që në mandatarkëtimin e datës 30.7.2011 ka paguar shumën 10.000 euro, nuk e bëjnë automatikisht bashkëpronar mbi pasurinë e mësipërme, në rastin konkret mund të jemi përpara lindjes së një marrëdhënieje detyrimi ndërmjet subjektit dhe vëllait të tij, ku ky i fundit ka të drejtë të kërkojë kthimin e shumës së dhënë, por jo përpara një marrëdhënieje bashkëpronësie.

5.28. Në kushtet kur subjekti nuk përcaktoi saktësisht vlerën e kontributit të vëllait në secilën banesë apo kontributin në arredimin e apartamentit në ***, Komisioni, duke konsideruar vlerën e apartamentit (57.000 euro), detyrimin e mbetur pa paguar (10.000 euro) dhe burimin e deklaruar në vitin 2009 (huaja 30.000 euro), vlerësoi se shuma e kontribuar nga ana e shtetasit

¹⁶⁹E-mail datë 21.6.2022.

¹⁷⁰Protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.7.2022.

B. Sh. në çmimin e apartamentit ka qenë 17.000 euro¹⁷¹, ndërsa vlera e kontribuar në arredim ka qenë 10.000 euro¹⁷². Për pasojë, Komisioni paraqiti vlerën 10.000 euro si shpenzime arredimi në vitin 2011.

5.29. Nga shqyrtimi i deklarimeve të subjektit lidhur me burimin e blerjes së apartamentit në ***, Kavajë dhe kontributin e vëllait të tij, konstatohet se: (i) në DIPP/2009 ka deklaruar si burim vetëm huan e marrë nga kushëriri (B. H.) në shumën 30.000 euro; (ii) në DIPP/2011¹⁷³ ka deklaruar se apartamenti është në bashkëpronësi me vëllain i cili ka detyrimin për të paguar pjesën tjetër të vlerës prej 27.000 euro; (iii) në deklaratën *Vetting* ka deklaruar se vëllai i tij ka kontribuar në ndërtimin e banesës në rrugën “***” dhe në arredimin e rregullimin e banesës në ***, në shumën totale 27.000 euro; (iv) në përgjigje të pyetësorit standard¹⁷⁴ nuk ka deklaruar bashkëpronësinë me vëllain, por deklaroi si burim të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes, si dhe huan nga i afërmi i tij B. H. në shumën 30.000 euro; (v) përpara ILDKPKI-së¹⁷⁵ ka deklaruar se apartamenti është në bashkëpronësi me vëllain e tij, i cili ka investuar 27.000 euro për blerje dhe arredim.

5.30. Nga krahasimi i deklarimeve konstatohet se subjekti ka bërë deklarime të ndryshme lidhur me burimin e krijimit të pasurisë së apartamentit në ***, Kavajë, si dhe me kontributin e vëllait të tij.

5.31. Në përfundim të analizës së tre burimeve, Komisioni kreu analizën financiare për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit dhe personave të lidhur për vitet 2009, 2010 e 2011 dhe rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime të ligjshme financiare për blerjen e apartamentit në ***, Kavajë, për kryerjen e shpenzimeve, shlyerjen e detyrimeve dhe shtesën e kursimeve, me një balancë negative prej 10.883.467 lekësh për vitet 2009, 2010 dhe 2011.

5.32. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi barrën e provës dhe i kërkoi subjektit të rivlerësimit të paraqesë shpjegime në lidhje me konstatimet se: (i) lidhur me pagesat e kryera ndër vite për shoqërinë “***” sh.p.k. ka mospërputhje ndërmjet deklarimeve të subjektit në DIPP-të vjetore me dokumentacionin e administruar (mandatarkëtimet e përcjella nga shoqëria); (ii) mungon dokumentacioni justifikues ligjor për të provuar të ardhurat e shtetasit B. H. për dhënien e huas në vlerën 30.000 euro; (iii) mungon dokumentacioni justifikues ligjor për të provuar të ardhurat e vëllait që kanë kontribuar në blerjen dhe arredimin e apartamentit në ***, Kavajë; (iv) subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime të ligjshme financiare për blerjen e apartamentit në ***, Kavajë, për kryerjen e shpenzimeve, shlyerjen e detyrimeve dhe shtesën e kursimeve, me një balancë negative prej 10.883.467 lekësh për vitet 2009, 2010 dhe 2011.

5.33. Në përgjigje të tij¹⁷⁶, subjekti i rivlerësimit parashtrroi shpjegimet vijuese.

¹⁷¹57.000 euro (vlera e apartamentit) – 10.000 euro (detyrimi i mbetur ndaj shoqërisë) – 30.000 euro (huaja e deklaruar si burim) = 17.000 euro.

¹⁷²27.000 euro (vlera totale e kontributit) – 17.000 euro (vlera e kontribuar në çmimin e blerjes) = 10.000 euro.

¹⁷³Kur subjekti ka deklaruar për herë të parë bashkëpronësinë me vëllain.

¹⁷⁴Email datë 27.7.2020.

¹⁷⁵Procesverbali i datës 1.2.2016.

¹⁷⁶(i) Parashtrime dhe prova të dorëzuara në datën 28.10.2022, me nr. *** prot., si dhe me email-in e datës 24.10.2022 dhe datës 25.10.2022; (ii) prova të dorëzuara në datën 2.11.2022 në seancë dëgjimore; (iii) prova të dorëzuara në datën 3.11.2022, me nr. *** prot.; (iv) prova të dorëzuara në datën 21.11.2022, me nr. *** prot.; (v) parashtrime dhe prova të dorëzuara në datën 2.12.2022, me nr. *** prot.; (vi) parashtrime dhe prova të dorëzuara në datën 5.12.2022, me nr. *** prot., si dhe me email-in e datës 3.12.2022 dhe datës 4.12.2022.

5.34. *Së pari, lidhur me kontributin e vëllait*, subjekti shpjegoi se vëllai i tij ka kontribuar në vlerën totale prej 27.000 euro për të dyja pronat, konkretisht për pronën në Kavajë ka kontribuar në një vlerë të përafërt prej 17.000 euro, ndërkohë në lidhje me arredimin nuk ka kontribuar në masën 10.000 euro, pasi kjo vlerë është përdorur në një masë të përafërt për banesën në rrugën “****”, nd. ***, Tiranë. Apartamenti nuk ka sende me vlerë të veçantë apo mobilie të kushtueshme që e kalojnë vlerën 2.500 euro dhe se ka bërë një arredim normal me kursimet e tij ndër vite, për të cilat nuk ka mbajtur shënime, pasi nuk e ka pasur detyrim ligjor, sqaroi subjekti.

5.35. Për sa i përket të ardhurave të ligjshme të vëllait, subjekti shpjegoi se kontributi prej 27.000 euro i është dhënë për shkak të mundësisë që ka pasur vëllai i tij, pasi nga viti 1999 deri në gusht të vitit 2001 ka qenë emigrant në Mbretërinë e Bashkuar, kjo e mbështetur me kopjen e dokumentit të lëshuar në datën 9.8.2002 nga *United Kingdom I. S.* në emër të shtetasit B. Sh., si dhe me *email-in* e datës 30.11.2022 të ***, ku përcillet informacion lidhur me qëndrimin e vëllait (pretendime të trajtuara në paragrafët 3.47- 3.48 të këtij vendimi).

5.36. *Së dyti, lidhur me bashkëpronësinë e vëllait në apartament*, subjekti sqaroi se neni 455 i Kodit Civil parashikon mënyrën e ekzekutimit të detyrimit dhe sipas tij, nëse nuk do t’i kthente vëllait të tij shumën e paguar, ky fakt do ta çonte në bashkëpronësi të pronës së krijuar me kontributin e tij nëpërmjet përdorimit të mjeteve ligjore të përcaktuara në Kodin Civil dhe në Kodin e Procedurës Civile.

5.37. *Së treti, lidhur me huan e marrë nga shtetasi B. H., në shumën 30.000 euro*, subjekti sqaroi se ky shtetas është kushëri i tij, pjesë e familjes H. që jeton në Francë¹⁷⁷. Me ardhjen e tyre të herëpashershme në Shqipëri, pasi i ka dërguar në banesën e tij në ***, familja H. ka shprehur vullnetin për t’u bërë pjesë e këtij apartamenti që ta shfrytëzonin për pushime gjatë verës dhe për këtë qëllim ata vendosën që pjesë-pjesë t’i jepnin shumën 30.000 euro (kjo shumë është dhënë në varësi të personave të familjes që lëviznin në Shqipëri). Duke qenë se më pas këta familjarë nuk shprehën më interes për këtë apartament dhe për shkak se subjekti kishte përdorur tashmë shumën 10.500 euro, për të qenë korrekt me ta, subjekti ka bërë deklaratën noteriale nr. ***, datë 27.3.2010, me kushëririn e tij B. H.¹⁷⁸, i ndodhur në atë kohë në Tiranë. Pra, me fjalë të tjera, ky ka qenë një kontribut i gjithë familjes Sh. H. dhe shumat e depozituara prej tyre ishin të dorëzuara pranë subjektit me qëllimin që në të ardhmen të bënin blerjen e apartamentit, shpjegoi subjekti.

5.38. Për vërtetimin e shpjegimeve të tij subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. ***, datë 22.10.2022, të kunatës së subjektit B. H., znj. M. H., e cila konfirmon deklarinimin e mësipërm të subjektit¹⁷⁹.

¹⁷⁷Subjekti shpjegoi se: “*Babai i kushëririn B. H., i ndjeri Sh. M. H., është një nga vëllezërit e gjyshes time të ndjerë M. M. H. (gjyshja nga ana e nënës time N. Sh.), që jetojnë në Paris, Francë që nga vitet 1960. Pas hapjes së regjimit ata kanë ardhur dhe për shkak edhe të rrethanave familjare dhe ekonomike, kemi krijuar një lidhje shumë të fortë me dajën Sh. dhe fëmijet e tij, që janë F., Sh., A., M., Y., D., e B. H.*”.

¹⁷⁸Subjekti shpjegoi se: “*Kjo kontratë më shumë kishte qëllim formalizimin me një akt të shkruar të këtij detyrimi, pavarësisht lidhjes gjinore dhe besimit tek njëri tjetri, edhe për faktin se në këtë shumë nuk ishte vetëm një person kontribuues. Deklarimi në deklaratën periodike të shumës së huas në vlerën 30.000 euro kishte për qëllim vetëm evidentimin e kësaj huaje. Në këtë deklaratë nuk kam saktësuar se sa nga kjo hua është përdorur për blerjen e apartamentit*”.

¹⁷⁹Subjekti shpjegoi se: “*Në kushtet e afati të shkurtër gjatë këtij procesi kam komunikuar më kushërinjtë e mi dhe duke qenë se bashkëshortja e A., M. H., ka udhëtuar në datën 21.10.2022 dhe ka ardhur e ka bërë një deklaratë noteriale nr. ***, datë 22.10.2022, ku deklaroi llojin e borxhit ndaj familjes H. Bashkëngjitur është një tjetër deklaratë dorë nga B. H. që rikonfirmon huadhënien, si dhe një dokument i taksave që tregon sasinë dhe banesat e tyre që kanë secili në *** Parsi Francë*”. Bashkëlidhur edhe lëvizjet sipas sistemit TIMS për shtetasit M. D. dhe B. H..

5.39. Për të provuar të ardhurat e ligjshme, subjekti ka paraqitur një ekstrakt regjistrimi të shoqërisë “****”, nxjerrë nga Regjistri Kombëtar i Tregtisë dhe Shoqërive (RKTSH) Francë¹⁸⁰.

5.40. Më tej¹⁸¹, subjekti shpjegoi se pasaktësia e tij në deklaratimet e kryera lidhet kryesisht me deklarin e shumave të përdorura nga vëllai dhe nga gjendjet monetare të dorëzuara nga të afërmit e tij, sipas deklaratës noteriale me kushëririn B. H. në lidhje me blerjen e apartamentit në ***. Subjekti vijoi duke shpjeguar se: *“Nga huaja e deklaruar nga kushëririn B. H. janë përdorur vetëm rreth 10.500 euro, pavarësisht se është deklaruar huaja në shumën 30.000 euro. Siç kam shpjeguar edhe më lart, deklarata noteriale me kushëririn B. H. kishte si qëllim njohjen e këtij detyrimi, tashmë pasi nga ana ime ishte përdorur shuma prej 10.500 euro nga shuma prej 30.000 euro të lëna në ruajtje. Në kushtet kur unë dhe im vëlla ndodheshim përpara këtij investimi dhe dijenisë së afërmit të mi që unë kisha marrë hua dhe akoma të pashlyera për blerjen e apartamentit në rrugën ‘***’, si dhe gjithashtu kisha detyrime kontraktuale lidhur me këtë apartament, nga ana e tyre (kushërinjtë të mi) pjesa tjetër e huas m’u la në përdorim dhe pa afat kthimi derisa të kaloja këtë situatë financiare. Kështu, nga pjesa tjetër e huas e shumës 30.000 euro, nga ana ime janë përdorur në vitet pasardhëse për shlyerjen e detyrimit kundrejt shoqërisë ‘***’ sh.p.k.”.*

5.41. Në vijim, subjekti paraqiti një analizë financiare për vitet 2009, 2010 dhe 2011, për të cilën shpjegoi se: (i) nga shuma 30.000 euro në vitin 2009 është përdorur gati 10.500 euro për pagesat e kryera në shumën totale prej 27.000 euro. Më tej, në vitin 2010 është kryer një pagesë prej 10.500 euro dhe në vitin 2011 një pagesë prej 9.000 euro për shoqërinë “****” sh.p.k.; (ii) në analizë janë përfshirë si të ardhura të ligjshme të ardhurat e bashkëshortes nga kurset private të mësimdhënies, si të ardhura të deklaruara në deklaratat periodike për të cilat janë paguar edhe tatimet në burim; (iii) shpenzimet e udhëtimit janë zvogëluar për pjesën në të cilën ka dorëzuar dokumentacion (deklarata) që janë përballuar nga miqtë apo familjarët e tij; (iv) në vitin 2011 është përfshirë gjithashtu kontributi i gjyshërve prej 5.000 euro, dhënë djalit të subjektit për blerjen e garazhit dhe përdorur nga subjekti gjatë atij viti.

5.42. Në përfundim, subjekti paraqiti analizën financiare për vitet 2009, 2010 dhe 2011, të paraqitur me balancat negative përkatëse prej 89.079 lekësh, 97.787 lekësh dhe 92.502 lekësh.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

5.43. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

5.44. *Së pari*, për sa i përket konstatimit të Komisionit se lidhur me pagesat e kryera ndër vite për shoqërinë “****” sh.p.k. ka mospërputhje ndërmjet deklaratimeve të subjektit në DIPP-të vjetore me dokumentacionin e administruar, subjekti nuk dha shpjegime specifike, por në analizën financiare të paraqitur prej tij, vërehet se janë reflektuar pagesat e kryera sipas

¹⁸⁰Në provat e dorëzuara në datën 21.11.2022, me nr. *** prot., ndodhet një dokument në gjuhën frënge, i përkthyer dhe noterizuar (nr. *** rep., datë 7.11.2022).

¹⁸¹Parashtrime dhe prova të dorëzuara në datën 5.12.2022, me nr. *** prot., si dhe me email-in e datës 3.12.2022 dhe datës 4.12.2022.

dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria “****” sh.p.k., siç pasqyrohet edhe në analizën financiare të Komisionit.

5.45. Për rrjedhojë, lidhur me pagesat e kryera për këtë apartament subjekti ka paraqitur në mënyrë të pasaktë vlerën e paguar në vitin 2009, si dhe nuk ka deklaruar pagesat e kryera në vitet 2010 dhe 2011.

5.46. Gjithashtu, subjekti nuk ka deklaruar në DIPP-të e viteve 2009, 2010 2011 dhe 2012 detyrimin ndaj shoqërisë “****” sh.p.k. në kundërshtim me germën “dh” të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003.

5.47. *Së dyti*, lidhur me deklarinë se apartamenti është në bashkëpronësi me vëllain e tij B. Sh., Komisioni arsyeton si në vijim:

5.48. Ligji nr. 84/2016, në pikën 1 të nenit 32 parashikon se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, duhet të paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

5.49. Gjithashtu, në pikën 7 të udhëzimit nr. *** prot., datë 10.10.2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së¹⁸², përcaktohet shprehimisht se: *“Për çdo pasuri në pronësi, të paluajtshme, të luajtshme, likuiditete, vlerën e aksioneve, letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim etj., subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të duhet të deklarojnë burimin në momentin e krijimit për secilën prej tyre, duke bashkëlidhur dokumentacionin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit për secilën pasuri, në momentin e fitimit të tyre”*.

5.50. Kodi Civil në nenin 163 ka përcaktuar në mënyrë të qartë se: *“Pronësia fitohet nëpërmjet mënyrave të caktuara në këtë Kod dhe mënyrave të tjera të caktuara me ligj të veçantë”*. Në vijim, në nenet 164-190 Kodi Civil ka përcaktuar edhe mënyrat e fitimit të pronësisë (me kontratë, trashëgim etj.). Nga hetimi administrativ nuk rezulton që shtetasi B. Sh. të ketë fituar bashkëpronësinë mbi apartamentin në një nga mënyrat e përcaktuara në Kodin Civil apo me ligj të veçantë. Deklarimi i subjektit se vëllai i tij B. Sh. ka kontribuar në blerjen e apartamentit në një shumë të caktuar, konfirmimi i këtij deklarinë nga ky i fundit, si dhe fakti që në mandatarëkëtimin e datës 30.7.2011 ka paguar shumën 10.000 euro nuk e bëjnë atë automatikisht bashkëpronar mbi pasurinë e mësipërme, në rastin konkret mund të jemi përpara lindjes së një marrëdhënieje detyrimi ndërmjet subjektit dhe vëllait të tij, ku ky i fundit ka të drejtë të kërkojë kthimin e shumës së dhënë, por jo përpara një marrëdhënieje bashkëpronësie. Nga marrëdhënia e detyrimit nuk mund të kalohet në marrëdhënien e pronësisë, të cilat janë dy institute të ndryshme që kanë një rregullim të veçantë në Kodin Civil¹⁸³.

5.51. Si pasojë, deklarinë e subjektit në deklaratën *Vetting* dhe në DIPP/2011, se vëllai i tij është bashkëpronar në pasurinë apartament në ****, Kavajë, mbetet në nivel deklarativ dhe nuk mbështetet në dokumentacionin ligjor justifikues, për aq kohë sa dokumenti i pronësisë nga ASHK-ja vërtetohet se pronarët ligjorë të pasurisë janë subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij.

5.52. Komisioni, duke u bazuar: (a) në deklarinë e bërë nga subjekti në deklaratën *Vetting* se vëllai i tij ka kontribuar në arredimin dhe rregullimin e banesës në ****, me qëllim shfrytëzimin

¹⁸²“Për mënyrën e deklarinë të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarinë të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, ‘Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’”.

¹⁸³Vendimi nr. 7, datë 16.1.2002, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

bashkërisht sipas nevojave; (b) se shtetasi B. Sh.¹⁸⁴ konfirmon se ka kontribuar në blerjen dhe rikonstrukcionin e apartamentit të ndodhur në ***, me qëllim për të qenë pjesë në shfrytëzimin e tij sipas nevojave; (c) në faktin që subjekti nuk ka paraqitur dokumentacionin justifikues që provon bashkëpronësinë e shtetasit B. Sh. në apartamentin në ***, vlerëson se marrëdhënia e krijuar në rastin konkret ndërmjet subjektit dhe vëllait të tij plotëson elementet e kontratës së “dhurimit me kusht”, të parashikuar nga nenet 761, 764 dhe 768/185 të Kodit Civil, pasi njëra palë i ka kaluar palës tjetër një shumë të hollash pa kundërshtim për blerjen e apartamentit me kushtin që ta shfrytëzojë dhe ai sipas nevojave dhe pala tjetër ka pranuar shumën e dhënë, si dhe të drejtën (kushtin) e palës dhuruese për shfrytëzimin e apartamentit.

5.53. Sa më sipër, bazuar në nenin 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, shtetasi B. Sh. konsiderohet “person tjetër i lidhur” me subjektin e rivlerësimit, për shkak të marrëdhënies që ekziston ndërmjet tyre dhe të pranuar nga të dyja palët dhe në zbatim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, subjekti ka detyrimin të paraqesë dokumentacionin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës së dhënë nga shtetasi B. Sh.

5.54. Referuar deklaratimeve të subjektit në përgjigje të barrës së provës, kontributi i personit tjetër të lidhur/z. B. Sh. për këtë apartament ka qenë në shumën 2.703.590 lekë¹⁸⁶.

5.55. Në përfundim të arsytimit në paragrafin 3.60 të këtij vendimi, Komisioni konkludon se subjekti i rivlerësimit ka dështuar të provojë të ardhurat e ligjshme të personit tjetër të lidhur/vëllait për të justifikuar kontributin prej 2.703.590 lekësh për krijimin e kësaj pasurie.

5.56. Për sa i përket huas nga shtetasi B. H. në shumën 30.000 euro, fillimisht Komisioni çmon se nuk mund të pranohet shpjegimi i subjektit se shuma e dhënë hua ka qenë kontribut i gjithë familjes H., pasi ky pretendim është ngritur për herë të parë pas kalimit të barrës së provës, ndërkohë që subjekti i kishte të gjitha mundësitë ta sqaronte këtë situatë në DIPP-në vjetore përkatëse apo në deklaratën *Vetting*.

5.57. Po kështu, vlerësohet si i pabazuar edhe pretendimi i subjektit për shpërndarjen e kësaj huaje sipas viteve kur janë kryer pagesat për apartamentin, pasi kjo hua është deklaruar vetëm në DIPP/2009. Nëse kjo hua do të ishte përdorur sipas mënyrës së shpjeguar nga subjekti në prapësime, fillimisht ajo do të duhej të ishte deklaruar si shtesë likuiditetesh *cash* në DIPP/2009 e më tej, duhet të ishte deklaruar pakësimi i tyre në DIPP-të vijuese, kjo bazuar në legjislacionin në fuqi¹⁸⁷.

5.58. Më tej, Komisioni, pasi analizoi ekstraktin e shoqërisë “***”, ku konstatohet se ajo është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila e ka filluar veprimtarinë në datën 1.9.1991 dhe ka

¹⁸⁴Në deklaratën noteriale nr. ***, datë 24.1.2017.

¹⁸⁵Kodi Civil, neni 761 parashikon: “Dhurimi është një kontratë me anë të së cilës njëra palë i kalon në pronësi pa shpërblim palës tjetër një send të caktuar ose një të drejtë reale të cilat kjo i pranon”; neni 764: “...në qoftë se ka për objekt sende të luajtshme, ai është i vlefshëm kur ato specifikohen duke treguar edhe vlefshëm e tyre në kontratën e dhurimit...”; neni 768: “Dhurimi mund të rëndohet me kusht ose me barrë. Dhuruesi është i detyruar të përmbushë barrën brenda kufijve të vlefshëm të sendit të dhuruar...”.

¹⁸⁶Referuar analizës financiare të paraqitur nga subjekti, kjo vlerë përlllogaritet si diferencë e vlerës 3.703.590 lekë (27.000 euro x 137,17) me 1.000.000 lekë të deklaruara si kontribut në banesën në rrugën “***”.

¹⁸⁷Referuar nenit 4, pika “d” e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, parashikohet se subjektet detyrohen të deklarojnë vlerën e likuiditeteve, gjendjen *cash* jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj dhe referuar nenit 7, pika 1 e ligjit më sipër, në deklaratimin periodik jepen vetëm ndryshimet e ndodhura në pasuritë, detyrimet financiare dhe interesat privatë.

si administrator shtetasin Y. H., vlerëson se ky dokument nuk provon as lidhjen e huadhënësit/shtetasit B. H. me këtë shoqëri dhe as të ardhurat e realizuara nga kjo shoqëri.

5.59. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dështuar të provojë të ardhurat e ligjshme të personit tjetër të lidhur/shtetasit B. H., për të justifikuar huan në vlerën 30.000 euro, të deklaruar të përdorur për krijimin e kësaj pasurie.

5.60. Për sa i përket shpjegimeve të dhëna nga subjekti lidhur me analizën financiare për vitet 2009, 2010 dhe 2011, Komisioni arsyeton si në vijim:

5.61. Lidhur me huan në vlerën 30.000 euro, referuar arsyetimit dhe konkluzionit në paragrafët e mësipërm, Komisioni nuk e paraqiti këtë vlerë në analizën financiare. Po kështu, pretendimet lidhur me pasqyrimin e të ardhurave të bashkëshortes nga kurset private të mësimdhënies dhe të ardhurave nga qiraja, si dhe lidhur me reduktimin e shpenzimeve të udhëtimit, u konsideruan të pabazuara dhe nuk u paraqitën në analizën financiare, referuar trajtimit dhe arsyetimit të kryer respektivisht në pikat 10, 11 dhe 15.10 të këtij vendimi.

5.62. Komisioni korrigjoi analizën financiare duke e pranuar pretendimin e subjektit lidhur me moskryerjen e shpenzimeve të mobilimit/arredimit në vlerën 10.000 euro nga ana e vëllait të tij, por mbajti në konsideratë deklaratimet e subjektit lidhur me mungesën e vlerës së këtij shpenzimi në vlerësimin tërësor të çështjes.

5.63. Për sa i përket pretendimit të subjektit se në vitin 2011 është përdorur shuma 5.000 euro e kontributit të gjyshërve dhënë djalit të subjektit për blerjen e garazhit, Komisioni e gjen atë të pabazuar, në kushtet që subjekti nuk e ka deklaruar këtë kontribut as në DIPP/2011 dhe as në deklaratën *Vetting* si burim për blerjen e kësaj pasurie.

5.64. Në përfundim të analizës së tri burimeve për blerjen e këtij apartamenti në ***, Kavajë, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie, për kryerjen e shpenzimeve, shlyerjen e detyrimeve dhe shtesën e kursimeve, me një balancë negative prej 9.558.467 lekësh për vitet 2009, 2010 dhe 2011 (vitet gjatë të cilëve janë kryer pagesat për këtë apartament), duke u gjendur në kushtet e germës “b” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

6. Garazh me sipërfaqe 24,5 m², në Tiranë, me vlerë 10.000 euro

6.1. Në deklaratën *Vetting* 2017 subjekti ka deklaruar garazh me sip. 24,8 m², në rrugën “****” (kontratë nr. ***, datë 26.2.2015). Certifikatë pronësie z. k. ***, nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, në vlerën 10.000 euro. Si burim krijimi deklaroi pakësim të kursimeve të mëparshme të deklaruara në vite nga dhënia me qira e apartamentit në rrugën “****” dhe një pjesë kontribut i prindërve të tyre. Në seksionin e të dhënave konfidenciale ka deklaruar: “*Në blerjen e garazhit krahas investimeve tona familjare, ka kontribuuar në vlerë 5.000 euro, të ndarë në pjesë të barabarta si dhuratë nga prindërit e mi dhe të bashkëshortes*”. Për vërtetimin e deklaratimeve subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues¹⁸⁸.

6.2. Rezulton se me kontratën nr. ***, datë 26.2.2015¹⁸⁹, subjekti ka blerë nga shtetasi A. D. pasurinë garazh me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, në rrugën “****”, në shumën 10.000 euro. Kontrata parashikon se blerësi ka paguar paraprakisht të gjithë çmimin e shitjes

¹⁸⁸Certifikatë për vërtetim pronësie datë 19.3.2015, në emër të shtetasit Kudusi Shahu; kartelë e pasurisë së paluajtshme; kontratë shitjeje nr. ***, datë 26.2.2015.

¹⁸⁹Administruar dhe noter M. D. me shkresën nr. *** prot., datë 4.4.2022, si dhe nga ASHK-ja me shkresën datë 21.4.2022 (nga sistemi elektronik).

sipas mandateve të datave 19.2.2015 dhe 25.2.2015. Bashkëlidhur kontratës së shitjes¹⁹⁰, ndër të tjera, është administruar edhe vërtetimi nr. *** prot., datë 20.12.2014, i lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k., i cili vërtetoi se z. Kudusi Shahu ka blerë parkimin nr. ***, me sipërfaqe ndërtimi në total 24.8 m².

6.3. Shoqëria “****” sh.p.k.¹⁹¹ ka përcjellë dy mandatdepozitime në llogarinë bankare pranë BKT-së të noteres M. D., konkretisht në datën 19.2.2015 vlerën 5.000 euro dhe në datën 25.2.2015 vlerën 5.000 euro. Në të dyja rastet depozitimet janë kryer nga shtetasja Xh. T., me përshkrimin “lik. detyrimi parkim ‘***’, Kudusi Shahu”.

6.4. Nga analizimi i deklarimeve të subjektit lidhur me burimin e krijimit të pasurisë garazh, rezultoi se: (i) në deklaratën *Vetting* 2017 në seksionin e deklaramit të pasurive dhe burimit të tyre deklaroi si burim të pasurisë garazh *pakësim të kursimeve të mëparshme të deklaruara në vite*, ndërsa në seksionin e të dhënave konfidenciale deklaroi: “...*krahas investimeve tona familjare ka kontribuar në vlerën 5.000 euro, të ndarë në pjesë të barabarta si dhuratë nga prindërit e mi dhe të bashkëshortes*”; (ii) në DIPP/2015 deklaroi si burim: “...*pakësim të kursimeve të mëparshme të deklaruara në vite, një pjesë e kontributit edhe e familjarëve tanë (prindërve tanë)*”; (iii) në pyetësorin standard¹⁹² ka deklaruar: “...*burim i krijimit i financimit janë pakësim i kursimeve të mëparshme të deklaruara në vite nga dhënia me qira e apartamentit në ‘***’ dhe një pjesë kontribut i prindërve tanë*”; (iv) në pyetësorin nr. 1 fillimisht deklaroi se: “... *në vitin 2015 për shkak se garazhi është blerë në datën 26 shkurt i duhej të pakësonte kursimet e viteve të mëparshme dhe, si pasojë, ka pakësuar rreth 1.400.000 lekë, gjendjen cash të deklaruar më parë...*” dhe, më pas, lidhur me pyetjen e Komisionit se cili është burimi i krijimit të shumave të dhëna dhuratë nga prindërit e tij dhe të bashkëshortes së tij, deklaroi se vjehri i tij ka kontribuar në shumën 5.000 euro.

6.5. Si pasojë e deklarimeve kontradiktore të subjektit të rivlerësimit në deklaratën *Vetting* 2017 dhe në deklarimet përgjatë procesit të rivlerësimit, është krijuar pamundësi objektive për të identifikuar faktet që pasqyrojnë situatën e vërtetë të burimit të pasurisë në fjalë duke krijuar vështirësi për të kontrolluar ligjshmërinë e burimeve të krijimit të tyre. Sa më sipër, Komisioni, duke iu referuar qëllimit dhe objektit të kontrollit të pasurisë sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit¹⁹³, të cilët kanë përcaktuar qartësisht se procesi i rivlerësimit fillon nga deklarimet e subjektit të rivlerësimit për efekt të procesit të rivlerësimit, mori në analizë dhe verifikoi burimet e krijimit të pasurisë garazh të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting* 2017 si vijon:

i) *Kursime të deklaruara ndër vite në shumën 5.000 euro*

6.6. Nga analizimi i deklarimeve të subjektit lidhur me likuiditetet *cash* ndër vite (trajtuar në pikën 12 të këtij vendimi) rezultoi se deri në fund të vitit 2014 gjendja e likuiditeteve jashtë sistemit bankar ka qenë në vlerën 1.400.000 lekë.

6.7. Komisioni kreu analizën financiare për periudhën gjatë së cilës janë krijuar këto kursime, konkretisht për vitet 2013 dhe 2014 dhe rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur

¹⁹⁰Në kopjen e përcjellë nga shoqëria “****” dhe nga noterja M. D.

¹⁹¹Shkresë nr. *** prot., datë 26.4.2022.

¹⁹²Email datë 27.7.2020, dorëzuar në Komision me nr. *** prot., datë 28.7.2020.

¹⁹³Vendim nr. 33, datë 3.11.2021 (JR) (paragrafët 26-27).

mungesë të burimeve të ligjshme financiare për shtesën e kursimeve dhe krijimin e shpenzimeve gjatë vitit 2014, me një balancë negative prej 809.336 lekësh.

ii) *Kontributi i prindërve të tij dhe të bashkëshortes në shumën 5.000 euro*

6.8. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* 2017 se shuma 5.000 euro është kontribut i prindërve të tij dhe të bashkëshortes në pjesë të barabarta si dhuratë. Në kushtet kur subjekti deklaron se kontributi i prindërve të tij dhe i prindërve të bashkëshortes është dhuratë, referuar pikës 14 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, prindërit e subjektit dhe prindërit e bashkëshortes së subjektit konsiderohen “persona të tjerë të lidhur” dhe, si pasojë, bazuar në pikën 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2018 subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumave të dhuruara.

6.9. QKB-ja¹⁹⁴ informon se shtetasi H. B. figuron se ka qenë ortak dhe administrator i disa shoqërive tregtare, konkretisht: (i) ortak, zotërues 49% i kuotave në shoqërinë “****” sh.p.k., e regjistruar në datën 15.5.2017, aktualisht e pezulluar; (ii) administrator dhe ortak i vetëm i shoqërisë “****” sh.p.k., e regjistruar në datën 5.5.2008, ku në datën 6.9.2013 është larguar si ortak i shoqërisë, aktualisht me status “çregjistruar pa likuidim”; (iii) administrator dhe ortak i vetëm i shoqërisë “****” sh.p.k., ku në datën 14.10.2021 është larguar si ortak i shoqërisë dhe në datën 29.10.2021 është larguar si administrator i shoqërisë; (iv) ka qenë administrator i shoqërisë “****” sh.p.k. dhe në datën 27.7.2012 është larguar si administrator i shoqërisë; ka qenë anëtar i Këshillit Mbikëqyrës në shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime K.” sh.a. dhe në datën 12.2.2015 është larguar si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës. Gjithashtu, QKB-ja ka përcjellë edhe licencat e shoqërive sipas llojit të ushtrimit të veprimtarive.

6.10. Sa më lart, dokumentacioni i paraqitur nga subjekti dhe ai i administruar nga hetimi nuk justifikon të ardhurat e ligjshme të prindërve të bashkëshortes për dhurimin e vlerës 2.500 euro.

6.11. Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 1¹⁹⁵, i kërkoi subjektit të rivlerësimit të deklarojë se cili është burimi i krijimit të shumave të dhëna dhuratë nga prindërit e tij dhe të bashkëshortes së tij, si dhe të paraqesë dokumentacionin justifikues. Në përgjigje¹⁹⁶, subjekti deklaroi se kontribuuesi kryesor ka qenë vjehri i tij H. B., i cili ka ndërruar jetë në vitin 2021. Lidhur me burimin e të ardhurave të tij, subjekti deklaron se gjatë gjithë kohës ai ka punuar si inxhinier gjeolog dhe ka pasur zyrën e tij private ku punonte me nxjerrjen e licencave minerare dhe ka pasur mundësi për ta ndihmuar në shumën 5.000 euro. Për të vërtetuar të ardhurat e vjehrit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin provues¹⁹⁷, ndërsa lidhur me burimin e shumën 2.500 euro, të dhuruar nga prindërit e tij, nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues.

6.12. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të paraqesë shpjegime lidhje me konstatimin se *subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime të ligjshme financiare për blerjen e garazhit në vlerën 10.000 euro (ekuivalenti 1.404.600 lekë), pasi: (i) lidhur me vlerën 5.000 euro duket se subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e likuiditeteve cash që kanë shërbyer për blerjen e këtij garazhi, si edhe për kryerjen e shpenzimeve, për vitin 2014, me një balancë*

¹⁹⁴Shkresë nr. *** prot., datë 11.4.2022.

¹⁹⁵Email datë 21.6.2022.

¹⁹⁶Protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.7.2022.

¹⁹⁷(1) Kopje të ekstraktit të QKB-së së shoqërisë “****” sh.p.k.; (2) kopje të licencës së subjektit “****” sh.p.k.; (3) dorëshkrim të gjetur në zyrën e të ndjerit me listën e detyrimeve të subjekteve.

negative prej 809.336 lekësh; (ii) lidhur me vlerën 2.500 euro, dhuruar nga prindërit e bashkëshortes së subjektit, mungon dokumentacioni ligjor justifikues për të justifikuar të ardhurat e ligjshme të dhuruesve; (iii) lidhur me vlerën 2.500 euro, dhuruar nga prindërit e subjektit, mungon dokumentacioni ligjor justifikues për të justifikuar të ardhurat e ligjshme të dhuruesve.

6.13. Në përgjigje¹⁹⁸ të tij, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se kontribuuesi kryesor për blerjen e kësaj pasurie ka qenë vjehri i tij H. B., i cili ka ndërruar jetë në vitin 2021. Në vijim, shpjegoi se gjatë gjithë kohës i ndjeri, vjehri i tij, ka punuar si inxhinier gjeolog dhe ka pasur zyrën e tij private ku punonte me nxjerrjen e licencave minerare dhe ka pasur mundësi për ta ndihmuar me shumën 5.000 euro. Subjekti ka paraqitur dokumentacion¹⁹⁹ lidhur me të ndjerin, vjehrin e tij, ndër të tjera edhe lëvizjet e llogarisë bankare të “Raiffeisen Bank” për të provuar aftësinë paguese, duke qenë se në këtë llogari konstatohen kreditime nga paga dhe shërbimet që ka kryer kundrejt të tretëve. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur dokumentacion lidhur me të ardhurat nga pensioni të prindërve të tij²⁰⁰, por nuk ka dhënë shpjegime të qarta lidhur me kontributin e tyre.

6.14. Më tej, subjekti shpjegoi se: *“Arsyeja e blerjes së këtij garazhi ka qenë kërkesa e djalit tim drejtuar gjyshërve të tij, të cilët ia mundësuan që në vitin 2011, por për shkak të nevojave të mia në shlyerjen e detyrimeve që kisha për pasuritë e paluajtshme, u përdorën nga unë gjatë atij viti duke i premtuar djalit plotësimin e shumës dhe blerjen me mundësinë e parë të krijuar, gjë e cila u mundësua në vitin 2015. Në deklarin për blerjen e garazhit kam deklaruar që blerja e tij është bërë nga pakësimi i gjendjes cash, gjendje në shumën 1.400.000 lekë, po kaq kushtonte edhe garazhi dhe kontributi i familjarëve, në të cilën kam nënkuptuar pikërisht origjinën e shumës dhe qëllimin e dhënies së saj nga gjyshërit”.*

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

6.15. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, propësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

6.16. Pavarësisht se dokumentacioni i paraqitur potencialisht provon mundësinë e kontributit në vlerën 5.000 euro, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka krijuar një

¹⁹⁸(i) Parashtrime dhe prova të dorëzuara në datën 28.10.2022, nr. *** prot., si dhe me *email* në datat 24.10.2022 dhe 25.10.2022; (ii) prova të dorëzuara në datën 2.11.2022, në seancë dëgjimore; (iii) prova të dorëzuara në datën 3.11.2022, nr. *** prot., (iv) prova të dorëzuara në datën 21.11.2022, nr. *** prot.; (v) parashtrime dhe prova të dorëzuara në datën 2.12.2022, nr. *** prot., (vi) parashtrime dhe prova të dorëzuara në datën 5.12.2022, nr. *** prot., si dhe me *email* datë 3.12.2022 dhe datë 4.12.2022.

¹⁹⁹(i) Leje profesionale, CV, diplomë, librezë pune, certifikatë trajnimi, formular deklarami për gjendjen gjyqësore për shtetasin H. B.; (ii) ekstrakt nga QKB-ja dhe licencë nga QKL-ja për shoqërinë “*****”; (iii) vendim për lëshimin e trashëgimisë ligjore nr. ***; (iv) lëvizjet e llogarive bankare pranë “Raiffeisen Bank”; (v) listëpagesa dhe formulari i deklaramit dhe pagesës për shoqërinë “*****”, periudha qershor 2021; (vi) urdhërxhirim datë 7.7.2021, nga shoqëria “*****”, për pagesën e qirasë; (vii) vërtetim nr. *** datë 31.7.2019, DRT Tiranë; (viii) leje legalizimi për një godinë banimi 3-katëshe, në emër të shtetasve H. dhe E. B.; (ix) urdhër për lirimin nga detyra nr. *** datë 30.12.2005, nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës; (x) vërtetim për pagën referuese për efekt të përfitimit të pensionit shtetëror suplementar dhe vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare; (xi) kontratë nr. *** datë 4.1.2013 për shitjen e kuotave nga shoqëria “*****” sh.p.k., (xii) aktmiratimi nr. *** për shoqërinë “*****” sh.p.k.; (xiii) kontratë depozite bankare dhe lëvizjet e llogarive pranë “Credins Bank”.

²⁰⁰(i) Lëvizjet e llogarive bankare të babait të subjektit pranë “Intesa Sanpaolo Bank”, në valutën dollar dhe në lekë; (ii) kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme datë 29.9.2000, shitës H. Sh.; (iii) vërtetim datë 24.6.2022, shoqëria “*****” sh.a., mbi pagat *bruto* dhe *neto* për shtetasin H. Sh., për periudhën korrik 2010 – shtator 2014; (iv) vërtetim nr. *** datë 24.6.2022, nga DRSSH Kukës, për nënën e subjektit dhe nr. *** datë 17.10.2022, për babain e subjektit.

situatë kaotike lidhur me mënyrën e krijimit të kësaj pasurie, duke bërë të pamundur identifikimin e situatës faktike lidhur me krijimin e kësaj pasurie, mbi bazën e së cilës do të mund të kryhej kontrolli dhe vlerësimi i kësaj pasurie sipas përcaktimeve në legjislacionin e zbatueshëm në fuqi për rivlerësimin kalimtar.

6.17. Ky konkluzion bazohet në analizimin e deklarimeve të subjektit ndër vite, ato gjatë procesit të rivlerësimit dhe veçanërisht deklaramit të subjektit në prapësime, i cili e zhvendos kontributin e pretenduar prej 5.000 euro, nga viti 2015 në vitin 2011, një pretendim ky i paraqitur për herë të parë vetëm pas kalimit të barrës së provës.

6.18. Për rrjedhojë, Komisioni krijoi bindjen se pasaktësitë në deklaramet e subjektit të rivlerësimit e bëjnë në këtë rast deklaramin e tij të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, germa “a” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

7. Tokë arë në * Tiranë, në vlerën 200.000 lekë**

7.1. Në deklaratën *Vetting* 2017 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar tokë arë në ***, Tiranë, me sip. 400 m², z. k. ***, nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, ***, me vlerë 200.000 lekë, në bashkëpronësi të familjes në pjesë të barabarta. Si burim krijimi deklaroi deklaratë heqjeje dorë nga trashëgimia (babai) nr. ***.

7.2. Për vërtetimin e deklarimeve subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues²⁰¹.

7.3. Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* 2017 (të administruar edhe nga notere M. Ll.²⁰²) rezulton se shtetasi H. Sh. me kontratën nr. ***, datë 6.9.2011, ka blerë nga shtetasi H. dhe V. A. pasurinë e llojit “arë” me nr. pasurie ***, me sip. 400 m², z. k. ***, vol. ***, f. ***, me vendndodhje ***, Tiranë, kundrejt çmimit 2.000.000 lekë. Në kontratë përcaktohet se kjo vlerë është likuiduar nga ana e blerësit në favor të shitësve jashtë zyrës noteriale.

7.4. Më pas, rezulton se sipas dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. ***, datë 19.10.2016, shtetasi H. Sh. ka ndërruar jetë 22.10.2014 dhe trashëgimtarët ligjorë të tij janë përcaktuar shtetasi N. Sh., bashkëshortja, B. D. (Sh.) e bija, Z. M. (Sh.) e bija, Kudusi Shahu, i biri, dhe B. Sh., i biri. Gjithashtu rezulton se me anë të deklaratës noteriale nr. ***, datë 5.12.2016 (të administruar nga noter N. Gj.²⁰³) shtetasi B. D., B. Sh., N. Sh. dhe Z. M. kanë hequr dorë nga pjesa e tyre takuese në pasurinë nr. ***, me sip. 400 m², z. k. ***, vol. ***, f. ***, me vendndodhje ***, duke i kaluar pjesën e tyre subjektit. Si pasojë, subjekti figuron pronar i vetëm i kësaj pasurie.

7.5. Rezulton se subjekti në deklaratën *Vetting* 2017 ka vendosur si vlerë të kësaj pasurie shumë 200.000 lekë, ndërsa në kontratën e shitjes nr. ***, datë 6.9.2011, rezulton se i ndjeri H. Sh. e ka blerë këtë pasuri kundrejt shumë 2.000.000 lekë²⁰⁴. Gjithashtu, konstatohet se pasuria nr. ***, z. k. ***, me sip. 400 m² është në kufi (ngjitur) me pasurinë nr. ***, me sip. 600 m², të analizuar në pikën 1 të vendimit dhe sikurse është pasqyruar në paragrafin 1.3, mbi këtë pasuri pozicionohet ndërtesa me nr. pasurie ***, në pronësi të shtetasi S. S. J.

²⁰¹Certifikatë për vërtetim pronësie datë 15.12.2016; kartelë e pasurisë së paluajtshme nr. ***, z. k. ***, harta treguese e regjistrimit; vendim dëshmi trashëgimie ligjore nr. ***, datë 19.10.2016; deklaratë noteriale nr. ***, datë 5.12.2016, për heqjen dorë nga pjesa takuese; kontratë shitjeje nr. ***, datë 6.9.2011.

²⁰²Shkresë datë 9.6.2022.

²⁰³Shkresë datë 10.4.2022.

²⁰⁴Ndërsa pala shitëse sipas kontratës nr. ***, datë 17.6.2002, e ka blerë kundrejt shumë 200.000 lekë.

7.6. Në këto kushte, Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 1²⁰⁵, i kërkoi subjektit të sqaronte vlerën e pasurisë nr. ***, z. k. ***, si dhe arsyen e blerjes së pasurisë nr. ***, z. k. ***, në vitin 2011, nga babai i tij, në kushtet kur kjo pasuri ishte e zënë nga objekti i ndërtuar nga shtetasi S. S. J.

7.7. Në përgjigje²⁰⁶, subjekti sqaron se pasuria e mësipërme është përfituar prej tij pas vdekjes së babait të tij me anë të trashëgimisë dhe ndryshimi i vlerave nuk ka asnjë rëndësi nga ana e tij, si pasojë është e kuptueshme që ka qenë një lapsus nga ana e tij, si dhe sqaron se informacioni i ASHK-së se mbi këtë pasuri pozicionohet ndërtesa nr. *** në pronësi të shtetasit S. J. është gabim i ASHK-së, pasi referuar hartës treguese të pronës nr. ***, prona me nr. *** është pronë kufitare me pronën e trashëguar dhe, sipas tij, ndërtesa me nr. *** shtrihet mbi pasurinë nr. ***. Gjithashtu, shpjegon se prona nr. *** është e lirë dhe në posedimin e tij dhe nuk ka asnjë ndërtim mbi të. Lidhur me arsyen e blerjes së kësaj pasurie shpjegon se këtë pasuri e ka fituar nëpërmjet trashëgimisë, duke qenë se babai i tij ka ndërruar jetë. Për vërtetimin e deklaramit subjekti ka paraqitur dokumentacionin provues²⁰⁷.

7.8. Në përfundim, Komisioni arrin në përfundim në lidhje me këtë pasuri se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin dhe është krijuar nga një burim i ligjshëm.

8. Depozitë kursimi në “Credins Bank” në shumën 1.243.000 lekë

8.1. Në deklaratën *Vetting* 2017 subjekti ka deklaruar depozitë kursimi pranë “Credins Bank”, depozituar e çelur në datën 30.3.2011, në shumën 1.000.000 lekë. Vlera: 1.243.666 lekë, në bashkëpronësi të familjes në pjesë të barabartë. Si burim krijimi deklaron gjendje nga llogaria në lekë me nr. *** pranë “Credins Bank”. Për vërtetimin e deklarimeve subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues²⁰⁸.

8.2. “Credins Bank”²⁰⁹ konfirmon depozitën e kursimit me gjendje 1.243.666 lekë në datën 31.12.2016. Nga analizimi i lëvizjeve të llogarisë konstatohet se kjo depozitë është krijuar nga: (i) transfertë nga llogaria e pagës në datën 30.3.2011 të shumës 1.000.400 lekë, burim i së cilës janë pagat e kredituara përgjatë periudhës janar 2010 – mars 2011; (ii) interesat bankare ndër vite, në vlerën *neto* 243.266 lekë. Efekti i shtesave dhe pakësimeve të kësaj llogarie reflektohet në analizën financiare të vitit përkatës kalendarik.

8.3. Në përfundim, Komisioni vlerëson se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar nga “Credins Bank”.

9. Depozitë kursimi në Bankën Kombëtare Tregtare në shumën 1.034.359 lekë

9.1. Në deklaratën *Vetting* 2017 subjekti ka deklaruar: “*Depozitë kursimi në lekë pranë BKT-së, çelur në datën 2.7.2014, në shumën 1.000.000 lekë*”. Vlera: 1.034.359 lekë, në bashkëpronësi të familjes në pjesë të barabartë. Si burim krijimi deklaron *tërhequr nga depozita*

²⁰⁵Email datë 21.6.2022.

²⁰⁶Protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.7.2022.

²⁰⁷Shkresë datë 7.7.2022, nga ASHK Kamëz - Vorë, e nënshkruar elektronikisht; planet e rilevimit të pasurive nr. *** dhe nr. ***, z. k. ***, fotografim ajror nga Google.

²⁰⁸Konfirmime nr. ***, datë 21.10.2016 dhe nr. ***, datë 20.1.2017, nga “Credins Bank”, për depozitën në shumën 1.243.666 lekë; kopje librezë depozite në “Credins Bank”; urdhërxhirim i brendshëm datë 25.10.2011, i “Credins Bank”; pasqyrë e veprimeve në llogari (*statement*) datë 25.1.2017.

²⁰⁹Shkresë nr. *** prot., datë 29.10.2020.

e kursimit nr. *** pranë “Credins Bank”, në datën 2.7.2014, në shumën 1.000.000 lekë. Për vërtetimin e deklarimeve subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues²¹⁰.

9.2. BKT-ja²¹¹ konfirmon çeljen e depozitës në datën 2.7.2014, me vlerë 1.000.000 lekë. Nga analizimi i lëvizjeve të llogarisë konstatohet se kjo depozitë është krijuar me një depozitim në datën 2.7.2014, me vlerë 1.000.000 lekë, me përshkrimin “Kudusi H. Shahu, derdhje në *** (tërhequr nga ‘Credins Bank’)” dhe po në të njëjtën datë është krijuar edhe depozita me afat, e cila është maturuar në datën 30.5.2017. Si burim për këtë shumë të depozituar subjekti ka deklaruar tërheqjen *cash* nga llogaria e tij në “Credins Bank”, në shumën 1.057.220 lekë, datë 2.7.2014, veprim i cili konfirmohet edhe nga hetimi i Komisionit²¹².

9.3. Komisioni analizoi më tej burimin e shumës 1.057.220 lekë, e cila rezultoi e krijuar nga: (i) transfertë nga llogaria e pagës në datën 16.10.2012, e shumës 1.000.000 lekë, burim i së cilës janë pagat e kredituara përgjatë periudhës prill 2011 - tetor 2012; (ii) interesat bankare ndër vite, në vlerën *neto* 57.220 lekë. Efekti i shtesave dhe pakësimeve të kësaj llogarie reflektohet në analizën financiare të vitit përkatës kalendarik.

9.4. Në përfundim, Komisioni vlerëson se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar nga Banka Kombëtare Tregtare.

10. Të ardhurat e bashkëshortes nga mësimdhënia

10.1. Në deklaratën *Vetting* 2017 subjekti ka deklaruar të ardhura nga mësimdhënia e bashkëshortes, kurse të gjuhës angleze në banesë në vitet 2006 – 2016, shuma 3.000.000 lekë.

10.2. Në DIPP-të vjetore subjekti ka deklaruar të ardhura nga mësimdhënia si në vijim:

- në DIPP/2006, të ardhura nga mësimdhënia e bashkëshortes, kurse të gjuhës angleze, me vlerë 450.000 lekë;
- në DIPP/2007, të ardhura nga mësimdhënia e bashkëshortes nga kurset e gjuhës angleze, si dhe qiraja e apartamentit në rrugën “***”, me vlerë 600.000 lekë.

Në këtë vit subjekti ka deklaruar një vlerë të vetme për të dyja burimet. Duke u nisur nga shuma totale prej 3.000.000 lekësh, e deklaruar në deklaratën *Vetting* për të ardhurat nga mësimdhënia, duket se deklarimi në DIPP/2007 i referohet vlerës 300.000 lekë për të ardhurat nga mësimdhënia²¹³ dhe vlerës 300.000 lekë²¹⁴ për të ardhurat nga qiraja, si vijon:

- në DIPP/2008, të ardhura nga kurset e gjuhës angleze në banesë me vlerë 600.000 lekë;
- në DIPP-të e viteve 2009, 2010 dhe 2011 ka deklaruar të ardhura nga mësimdhënia e bashkëshortes (kurse të gjuhës angleze), me vlerë 250.000 lekë për secilin vit;
- në DIPP/2012 nuk ka deklaruar të ardhura nga mësimdhënia;
- në DIPP/2013, të ardhura nga mësimdhënia e bashkëshortes (kurse të gjuhës angleze), me vlerë 300.000 lekë (muaj);
- në DIPP-të e viteve 2014 dhe 2015, të ardhura nga mësimdhënia e bashkëshortes (kurse të gjuhës angleze), me vlerë 300.000 lekë;

²¹⁰Vërtetim *extra* datë 21.10.2016, nga Banka Kombëtare Tregtare; mandatdepozitimi *cash* i BKT-së në shumën 1.000.000 lekë, datë 2.7.2014; mandattërheqjeje *cash* në “Credins Bank”, në shumën 1.057.220 lekë, datë 2.7.2014.

²¹¹Shkresë nr. *** prot., datë 24.7.2020.

²¹²Referuar lëvizjeve të përcjella nga “Credins Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 29.10.2020.

²¹³Diferenca midis vlerës së deklaruar në deklaratën *Vetting* (3.000.000 lekë) dhe totalit të vlerave të deklaruara në DIPP-të e tjera vjetore (2.700.000 lekë) është 300.000 lekë.

²¹⁴600.000 lekë minus 300.000 lekë.

- në DIPP/2016 nuk ka deklaruar të ardhura nga mësimdhënia.

10.3. Në procesverbalin e datës 1.2.2016 të ILDKPKI²¹⁵-së subjekti ka deklaruar se: *“Sqaroj se kurset janë kryer në ambientet e shtëpisë së banesës sime private, si rrjedhim nuk është mbajtur dokumentacion lidhur me këtë fakt”*.

10.4. Nga informacioni i administruar nga DPT-ja²¹⁶ dhe QKB-ja²¹⁷ shtetasja E. Sh. nuk ka aktivitet privat të regjistruar në emrin e saj.

10.5. Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 1²¹⁸, i kërkoi subjektit të rivlerësimit të deklarojë nëse është kryer pagesa e detyrimeve tatimore për këto të ardhura të deklaruara. Në përgjigje²¹⁹, subjekti shpjegon se bashkëshortja nuk ka paguar tatim mbi të ardhurat e realizuara dhe, për këtë, mori masa duke kryer deklarimin e tyre sipas legjislacionit në fuqi nëpërmjet deklarimit në DIVA-n e vitit 2019, duke u paguar detyrimi tatimor i lindur. Në cilësinë e provës subjekti paraqiti urdhërpagesën e formularit të tatimit mbi të ardhurat në emër të znj. E. Sh., për periudhën janar - dhjetor 2019, vlera 495.000 lekë, si dhe dokumentin bankar për pagesën e kësaj vlere në datën 6.7.2022.

10.6. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi barrën e provës dhe i kërkoi subjektit të rivlerësimit të paraqesë shpjegime në lidhje me konstatimin se *mungon dokumentacioni ligjor justifikues për të ardhurat e përfituara nga mësimdhënia e bashkëshortes në banesë, vlera 3.000.000 lekë, si dhe dokumentacioni ligjor për pagimin e detyrimeve tatimore për vitet 2006 – 2016 brenda afatit ligjor*.

10.7. Në përgjigje²²⁰ subjekti i rivlerësimit shpjegoi se ka bërë deklaratimet e këtyre të ardhurave përgjatë viteve në ILDKPKI, si dhe ka paguar tatimin mbi këto të ardhura. Në vijim, shpjegoi se bashkëshortja e tij në dhënien e kurseve të gjuhës angleze nuk kishte detyrim të lidhte kontratë dhe as të lëshonte faturë tatimore dhe ligji i aplikueshëm i kohës nuk ka të parashikuar detyrim ligjor që në këto raste duhet ta ushtronte aktivitetin në një nga format juridike apo të pajisej me NIPT. Gjithashtu, bashkëshortja e tij ka realizuar të ardhura minimale mujore dhe, për pasojë, duhet të merren në konsideratë, vijoi subjekti.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

10.8. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

10.9. Komisioni, bazuar në qëndrimin orientues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në lidhje me pagesat me vonesë të detyrimeve tatimore, nëse ato do të mundësojnë legjitimitimin e të

²¹⁵Shkresë nr. *** prot., datë 8.4.2022.

²¹⁶Shkresë nr. *** prot., datë 12.8.2020.

²¹⁷Shkresë nr. *** prot., datë 14.7.2020.

²¹⁸Email datë 21.6.2021.

²¹⁹Protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.7.2022.

²²⁰(i) Parashtrime dhe prova të dorëzuara në datën 28.10.2022, me nr. *** prot., si dhe me *email* në datat 24.10.2022 dhe 25.10.2022; (ii) parashtrime dhe prova të dorëzuara në datën 5.12.2022, me nr. ***prot., si dhe me *email* në datat 3.12.2022 dhe 4.12.2022.

ardhurave të krijuara, çmon se vlerësimi i tyre është bërë duke pasur në vëmendje disa rrethana. Së pari, duhet që të provohet bindshëm vetë ekzistenca e të ardhurave në kohën e krijimit të tyre, pasi pagimi i detyrimit tatimor nuk mund të shërbejë si një mjet për të provuar krijimin e të ardhurave që nuk provohen me mjete të tjera. Së dyti, në konsideratë mbahet sjellja e subjektit në raport me mospagimin në kohë të tyre. Brenda këtij kriteri, Komisioni ka vlerësuar rrethanat që kanë shkaktuar mospagimin në kohë të detyrimit për të përcaktuar nëse mospagimi ka qenë pasojë e ndonjë pakujdesie apo paqartësie apo një qëllim për t'u arritur.

10.10. Lidhur me ekzistencën e të ardhurave rezulton që subjekti ka deklaruar të ardhura nga mësimdhënia në DIPP-të vjetore, sikurse pasqyrohet në paragrafin 10.2. Gjithashtu, në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar se aktiviteti i mësimdhënies është ushtruar në ambientet së banesës së tij dhe nuk ka dokumentacion lidhur me këtë fakt. Komisioni arsyeton se ligji nr. 84/2016, në nenin 32, pika 5 parashikon se deklaratat e pasurisë të paraqitura më parë në ILDKPKI mund të përdoren si provë nga organet e rivlerësimit. Këto deklaratat, së bashku me provat e tjera, vlerësohen në tërësi me rrethanat e çështjes, për të arritur në një konkluzion sa më të drejtë për verifikimin dhe vlerësimin e deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, por formularët e deklarimit të pasurive dhe të burimit të krijimit të tyre i nënshtrohen kontrollit, ndaj dhe nuk përbëjnë akt zyrtar, në kuptim të fuqisë provuese të parashikuar nga neni 253 i Kodit të Procedurës Civile. Sipas informacionit të administruar nga DPT-ja dhe QKB-ja shtetasja E. Sh. nuk ka aktivitet privat të regjistruar në emrin e saj apo të ketë deklaruar të ardhura të realizuara nga mësimdhënia. Gjithashtu, subjekti nuk ka paraqitur ndonjë dokument apo provë nga ato që parashikohen në nenin 49 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar ushtrimin e aktivitetit të mësimdhënies nga bashkëshortja e tij. Në këto kushte, deklarimi i subjektit për realizimin e të ardhurave nga mësimdhënia e bashkëshortes së tij mbeten në nivel deklarativ.

10.11. Lidhur me sjelljen e subjektit Komisioni konstaton se në përgjigje të pyetësorit nr. 1 ai ka deklaruar se bashkëshortja e tij nuk ka paguar tatim për të ardhurat e realizuara dhe mori masat për deklarimin e tyre në DIVA-n e vitit 2019, duke paraqitur urdhërpagesën për tatimin mbi të ardhurat individuale për periudhën janar - dhjetor 2019 dhe mandatpagesën e datës 6.7.2002 të "OTP Bank". Nga analizimi i dispozitave të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, rezulton se në nenin 7 parashikohet se të gjithë individët rezidentë i nënshtrohen detyrimit për tatimin mbi të ardhurat personale dhe në nenin 8 (i ndryshuar me ligjin nr. 9161/2003) përcakton si të ardhura të tatueshme të ardhurat e realizuara nga individë rezidentë me burim në Republikën e Shqipërisë, ku sipas udhëzimit nr. ***, të ministrit të Financave përfshiheshin edhe të ardhurat nga mësimdhënia. Gjithashtu, neni 35 i ligjit ka parashikuar se paguesi i shumave duhet të deklarojë dhe të derdhë tatimin e mbajtur në burim në llogaritë e organeve tatimore deri në datën 20 të muajit pasardhës të muajit të pagesës. Sa më sipër, Komisioni konstaton se shlyerja me vonesë e detyrimeve tatimore për vitet 2006 – 2016 gjatë procesit të hetimit administrativ është bërë për t'i shërbyer procesit të rivlerësimit dhe nuk e shëron paligjshmërinë e këtyre të ardhurave në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës.

10.12. Pretendimi i subjektit lidhur me përfshirjen e këtyre të ardhurave në analizën financiare për shkak se ka bërë deklarimin e tyre gjatë viteve dhe ka paguar tatimin mbi këto të ardhura, nuk qëndron, pasi pavarësisht deklarimit në DIPP-të vjetore, nuk provohet bindshëm ekzistenca e këtyre të ardhurave në kohën e krijimit të tyre me ndonjë dokument ligjor justifikues, përveçse

me këtë deklaram. Në këto kushte, këto të ardhura nuk mund të merren në konsideratë në analizimin e burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive të subjektit të rivlerësimit.

10.13. Pra, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte ekzistencën e marrëdhënies së mësimdhënies, për të cilën janë paguar detyrimet tatimore me vonesë, për këtë shkak kjo pagesë e kryer nuk ka efekt në drejtim të provueshmërisë së ligjshmërisë së këtyre të ardhurave.

10.14. Për shkak të këtyre rrethanave që lidhen me mungesën e dokumentacionit justifikues të realizimit të të ardhurave nga mësimdhënia dhe me qasjen dhe sjelljen e personit për mospagimin në kohë të detyrimeve tatimore, Komisioni nuk i mori në konsideratë të ardhurat e deklaruara nga subjekti në analizën financiare, duke u gjendur në kushtet e germës “b” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

11. Të ardhura nga qiraja

11.1. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: “*Dhënia e apartamentit me qira në rrugën ‘***’ nga vitet 2007 – 2016. Në pjesën më të madhe është dhënë pa kontratë qiraje me afat 1-vjeçar. Për rastet që është mbajtur kontratë bashkëlidhur formularit kopje të kontratës. Shuma: 10.200 euro dhe 550.000 lekë*”.

11.2. Në deklaratimet periodike vjetore subjekti ka deklaruar: (i) në DIPP/2007, të ardhura nga mësimdhënia e bashkëshortes dhe qira nga apartamenti në rrugën “*****”, ***, me vlerë 600.000 lekë” (sipas arsytimit në paragrafin 10.2, të ardhurat nga qiraja në vlerën 300.000 lekë dhe të ardhurat nga mësimdhënia në vlerën 300.000 lekë); (ii) në DIPP/2008, vlerën 400.000 lekë; (iii) në DIPP/2009, vlerën 150.000 lekë; (iv) në DIPP/2010, vlerën 200.000 lekë; (v) në DIPP/2011, vlerën 200.000 lekë; (vi) në DIPP/2012 nuk ka deklaruar të ardhura; (vii) në DIPP/2013, vlerën 225 euro/muaj²²¹; (viii) në DIPP/2014, vlerën 300 euro/muaj; (ix) në DIPP-të e viteve 2015 dhe 2016 ka deklaruar të ardhura nga qiraja e apartamentit në Tiranë (deklaruar më parë qira jo me periudha të rregullta kohore, ndaj dhe kontratat janë me periudhë deri në një vit), me vlerë 300 euro/muaj.

11.3. Në procesverbalin e datës 1.2.2016, të ILDKPKI-së²²², subjekti ka deklaruar se apartamenti nuk është i regjistruar në ZVRPP dhe, si rrjedhim, nuk janë hartuar kontrata të rregullta qiraje. Gjithashtu, ka paraqitur dokumentacionin provues²²³.

11.4. Për vërtetimin e të ardhurave të realizuara nga dhënia me qira e apartamentit në rrugën “*****”, subjekti, në deklaratën *Vetting* 2017 ka paraqitur si provë kopje të kontratave të qirasë, të datave 1.2.2015, 28.9.2015 dhe 1.11.2016, ndërsa në përgjigje të pyetësorit standard²²⁴ ka paraqitur kontratat e mësipërme, si dhe kontrata të qirasë të datave 1.3.2017, 5.1.2018, 5.1.2019 dhe 4.6.2019.

11.5. DRT-ja Tiranë²²⁵ informon se shtetasi Kudus Shahu nuk ka aktivitet privat të regjistruar në emrin e tij, si dhe është regjistruar për përgjegjësinë tatimore DIVA dhe ka kryer deklaratimet për vitet 2015, 2016, 2017, 2018 dhe 2019.

11.6. Nga analizimi i llogarive bankare konstatohet se në llogarinë e subjektit pranë BKT-së është kryer një depozitim nga shtetasi V. K., me vlerë 15.500 lekë, në datën 11.10.2013, me

²²¹Derdhur në BKT.

²²²Shkresë nr. *** prot., datë 8.4.2022.

²²³Kontratën e qirasë datë 1.2.2015 dhe kontratën e qirasë 28.9.2015.

²²⁴Email datë 27.7.2020.

²²⁵Shkresë nr. *** prot., datë 12.8.2020.

përshkrimin “pagese qiraje”. Gjithashtu, ka depozituar vlerën 1.390 euro²²⁶ në vitin 2013 dhe vlerën 440 euro²²⁷ për vitin 2014, por pa përshkrim specifik.

11.7. Referuar nenit 8, germa “d” e ligjit nr. 8438/1998, “Për tatimin mbi të ardhurat personale”, i ndryshuar, të ardhurat nga qiraja janë të ardhura të tatueshme dhe, për pasojë, në zbatim të nenit 29 të ligjit të mësipërm subjekti është i detyruar t’i deklarojë brenda datës 31 mars të vitit pasardhës. Gjithashtu, konstatohet se kontratat e qirasë të datave 1.2.2015 dhe 28.9.2015, të paraqitura nga subjekti në deklaratën *Vetting* 2017 janë lidhur me individë dhe, për pasojë, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 8438/1998, i ndryshuar, subjekti kishte detyrimin për mbajtjen në burim të vlerës së tatimit mbi të ardhurat dhe derdhjen e tyre në llogari të organeve tatimore.

11.8. Komisioni kërkoi informacion pranë DRT-së Tiranë për të kryer verifikime të mëtejshme në kontabilitet për pagesat e kryera për tatimin në burim të qirasë dhe, në përgjigje, DRT-ja²²⁸ konfirmon se subjekti është i regjistruar vetëm për përgjegjësinë tatimore “Deklaratë individuale vjetore të të ardhurave (DIVA)”, si dhe nuk ka depozituar dhe nuk ka deklaruar pranë DRT-së kontrata qiraje. Nga analizimi i deklaratimeve DIVA, konstatohet se në DIVA-n e vitit 2015 nuk janë deklaruar të ardhura nga qiraja, ndërsa në atë të vitit 2016 janë deklaruar të ardhura *bruto* nga qiraja në vlerën 414.000 lekë dhe në datën 18.5.2017 ka paguar detyrimin prej 62.100 lekësh.

11.9. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimin të paraqesë shpjegime në lidhje me konstatimin se *mungon dokumentacioni ligjor justifikues për pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat nga qiraja për periudhën 2007 – 2015*.

11.10. Në përgjigje²²⁹ të tij, subjekti i rivlerësimin shpjegon se në Aneksin e Kushtetutës nuk përcaktohet se kur duhet të jenë paguar detyrimet tatimore për t’i konsideruar të ardhurat e ligjshme dhe në dispozitat e legjislacionit tatimor, si dhe nuk ka asnjë pengesë për kohën e pagimit të detyrimeve tatimore, e cila në rast vonesash shoqërohet me penalitete, që është gjoba dhe kamatëvonesa. Më pas shpjegon se referuar neneve 73 dhe 100 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me kalimin e afatit prej 5 vitesh për të drejtën e institucioneve tatimore për vjeljen e detyrimeve tatimore dhe për fillimin e procedurave për këtë qëllim, tatimpaguesi nuk ka asnjë detyrim për të paguar ndonjë tatim për shkak të efekteve të parashkrimit shues. Si rrjedhim, nuk mund të konsiderohet si subjekt që nuk ka paguar tatimin.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

11.11. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimin në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimin gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

²²⁶Datë 6.6.2013, 660 euro; datë 7.8.2013, 260 euro; datë 3.9.2013, 250 euro; datë 5.12.2013, 220 euro.

²²⁷Datë 10.1.2014, 220 euro dhe datë 3.2.2014, 220 euro.

²²⁸Shkresë nr. *** prot., datë 15.6.2022.

²²⁹Email datë 25.10.2022.

11.12. Subjekti ka kryer deklarime kontradiktore lidhur me vlerën e të ardhurave të përfituara ndër vite, pasi referuar deklarimeve në DIPP-të vjetore, totali i të ardhurave të deklaruar nga qiraja është 1.250.000 lekë dhe 13.500 euro përkundrejt shumës 550.000 lekë dhe 10.200 euro, të deklaruar në deklaratën *Vetting*.

11.13. Subjekti ka paraqitur kontrata qiraje nga periudha 1.2.2015 e në vijim, por jo për periudhën e mëparshme.

11.14. Të ardhurat nga qiraja të deklaruar nga subjekti për periudhën 2007 – 2015 nuk plotësojnë kriterin e parashikuar nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe, për pasojë, nuk mund të merren në konsideratë si të ardhura të ligjshme në analizën financiare. Për pasojë, Komisioni i qëndroi konkluzionit në rezultatet e hetimit dhe pasqyroi në analizën financiare të ardhura nga qiraja vetëm për vitin 2016, në vlerën 414.000 lekë, pasi subjekti ka paguar detyrimet tatimore për vlerën 414.000 lekë, referuar deklaramit në DIVA-n e vitit 2016.

11.15. Për shkak të këtyre rrethanave që lidhen me mospagimin e detyrimeve tatimore, Komisioni nuk i mori në konsideratë të ardhurat e deklaruar nga subjekti në analizën financiare, duke u gjendur në kushtet e germës “b” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

12. Deklarimet e subjektit ndër vite lidhur me gjendjen e likuiditeteve *cash*

12.1. Subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting* 2017, nuk ka deklaruar gjendje të likuiditeteve *cash* jashtë sistemit bankar.

12.2. Ndërsa në deklaratat periodike vjetore ndër vite, subjekti ka deklaruar: *“Në deklaratën e parë të pasurisë viti 2003, gjendje cash 8.000 USD, banesë, kursime në vite; në DIPP/2004, tërheqje gjendje cash 8.000 USD, përdorim për ndërtim shtëpie; në DIPP/2005 nuk ka deklaruar shtesa/pakësime/gjendje të likuiditeteve cash²³⁰; në DIPP/2006 deklaroi si burim për krijimin e pasurisë apartament pakësim me 800.000 lekë të deklaruar në deklaratën e mëparshme; në DIPP-të e viteve 2007, 2008, 2009, 2010 dhe 2011 nuk ka deklaruar shtesa/pakësime/gjendje të likuiditeteve cash; në DIPP/2012, pakësim të gjendjes cash për likuidim detyrim (1.000.000 lekë)²³¹; në DIPP/2013, shtim të gjendjes cash për likuidim detyrim (5.000.000 lekë); në DIPP/2014, shtim të gjendjes cash për likuidim detyrim (9.000.000 lekë); në DIPP/2015, shtim të gjendjes cash për likuidim detyrim (1.100.000 lekë); në DIPP/2016, shtim të gjendjes cash për likuidim detyrim (1.000.000 lekë)”*.

12.3. Në procesverbalin e datës 1.2.2016, të ILDKPKI-së²³², subjekti ka sqaruar se shtesat në vitin 2013 në shumën 5.000.000 lekë dhe në vitin 2014, në shumën 9.000.000 lekë, janë lapsus në deklaram, pasi i ka deklaruar në të vjetra, si dhe saktëson se shtesat kanë qenë në vlerën 500.000 lekë (viti 2013) dhe 900.000 lekë (viti 2014). Gjithashtu ka saktësuar se gjendja *cash* në datën 31.12.2014 ka qenë në shumën 1.400.000 lekë.

12.4. Me anë të pyetësorit nr. 1²³³, Komisioni i kërkoi subjektit: (i) sqarime lidhur me deklaramin e tij në DIPP/2006, konkretisht të shpjegonte se cilave likuiditeteve i referohej lidhur me pakësimin e shumës 800.000 lekë të përdorur për blerjen e apartamentit; (ii) sqarime lidhur me deklaramin e tij në DIPP/2015, konkretisht se cilave kursimeve i është referuar dhe sa është

²³⁰Subjekti ka deklaruar shtesë depozite nga paga në “Raiffeisen Bank” në shumën 450.000 lekë, por jo likuiditete jashtë sistemit bankar.

²³¹Më tej, tek seksioni i detyrimeve ka deklaruar se vlera për shlyerjen e detyrimit prej 1.500.000 lekësh ka si burim vlerën 1.000.000 lekë nga pakësimi i gjendjes dhe vlerën 500.000 lekë nga kursimet dhe pagat e vitit 2012.

²³²Shkresë nr. *** prot., datë 8.4.2022.

²³³Email datë 21.6.2022.

vlera e pakësuar për blerjen e garazhit; (iii) të shpjegonte se çfarë nënkuptonte me togfjalëshin “shtim likuiditetesh për likuidim detyrimi” në DIPP-të e viteve 2013 – 2016; (iv) të saktësonte gjendjen e likuiditeteve *cash* jashtë sistemit bankar në fund të secilit vit kalendarik, periudha 2013 – 2016; (v) të deklaronte burimin e gjendjes *cash*.

12.5. Në përgjigje²³⁴ të tij, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar si në vijim:

▪ *Lidhur me pikën (i)*, deklaroi se i referohej deklaramit në deklaratën e vitit 2003, ku është deklaruar gjendja *cash* në shumën 8.000 USD. Kjo shumë, deklaroi subjekti, është konvertuar me kursin 1 USD = 100 lekë, duke u përfituar shuma 800.000 lekë²³⁵.

▪ *Lidhur me pikën (ii)*, deklaroi se në vitin 2015 për shkak se garazhi është blerë në datën 26 shkurt i duhej të pakësonte kursimet e viteve të mëparshme dhe, si pasojë, ka pakësuar rreth 1.400.000 lekë, gjendjen *cash* të deklaruara më parë dhe po në të njëjtin vit me të ardhurat e përfituara gjatë vitit ka kursyer dhe deklaruar shtesë të gjendjes *cash* në shumën 1.100.000 lekë, e cila ka qenë edhe gjendja totale në atë vit.

▪ *Lidhur me pikën (iii)*, sqaron se në DIPP/2013 ka deklaruar gjendje *cash* 5.000.000 lekë, por shuma e deklaruar ka qenë një lapsus dhe konfuzion nga ana e tij të shumave në lekë të reja dhe në lekë të vjetra dhe, si pasojë, shuma që ka dashur të deklarojë, siç është edhe logjike bazuar në të ardhurat e tij, ka qenë në vlerën 500.000 lekë. E njëjta situatë ka ndodhur edhe në DIPP/2014. Gjithashtu, sqaron se në deklaramet për gjendjen *cash*, duke filluar nga viti 2006 ka pasur një detyrim në shumën 5.000.000 lekë dhe ky detyrim është shlyer totalisht në vitin 2012. Qëllimi i kursimeve familjare, deklaroi subjekti, ka qenë ai i shlyerjes së detyrimit dhe kjo terminologji ka mbetur në plotësimin e kursimeve edhe të gjendjes *cash*. Lidhur me burimin financiar të këtij likuiditeti, deklaroi se kanë qenë të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes, si dhe të ardhurat e përfituara nga kurset private që organizonte bashkëshortja e tij.

▪ *Lidhur me pikën (iv)*, deklaroi këto gjendje: vlerën 500.000 lekë në fund të vitit 2013, vlerën 1.400.000 lekë në fund të vitit 2014, vlerën 1.100.000 lekë në fund të vitit 2015 dhe vlerën 2.100.000 lekë në fund të vitit 2016.

▪ *Lidhur me pikën (v)*, deklaroi se burimi financiar i likuiditeteve *cash* kanë qenë të ardhurat e përfituara nga paga e tij dhe e bashkëshortes, si dhe të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja nga kurset private që ajo organizonte.

12.6. Sa më lart, duke u bazuar në deklaramet e subjektit në DIPP-të vjetore, si dhe saktësimin të vlerës së pakësuar në vitin 2014 sipas përgjigjeve të pyetësorit (në DIPP subjekti ka deklaruar pakësim, por jo vlerën specifike), Komisioni konstaton se në deklaratën *Vetting* 2017 subjekti nuk ka deklaruar gjendje të likuiditeteve *cash*, ndërkohë që referuar deklaramet periodike vjetore dhe shpjegimeve të dhëna në pyetësorin nr. 1, gjendja në fund të vitit 2016 rezulton në shumën 2.100.000 lekë.

12.7. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të paraqesë shpjegime në lidhje me konstatimin se *ka mospërputhje midis gjendjes së likuiditeteve*

²³⁴Protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.7.2022.

²³⁵Komisioni konstaton se subjekti është kontradiktor në deklaramet e tij, pasi nga analizimi i DIPP-ve për periudhën 2003 – 2005, rezultoi se likuiditetet *cash* në vlerën 8.000 USD, të deklaruara në deklaratën e parë të pasurisë së vitit 2003, janë pakësuar 1 vit më vonë, pra në vitin 2004. Sipas deklaramit në DIPP/2004, vlera prej 8.000 USD është përdorur për ndërtimin e banesës 2 kate + papafingo në Tiranë dhe, për rrjedhojë, nuk mund të kenë shërbyer për blerjen e apartamentit në Tiranë.

cash të deklaruar në deklaratën Vetting (0 lekë) dhe asaj të përlogaritur nga deklaratimet periodike vjetore (2.100.000 lekë).

12.8. Lidhur me këtë konstatim subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime në prapësimet e tij.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

12.9. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

12.10. Subjekti i rivlerësimit nuk dha shpjegime lidhur me konstatimin e mësipërm dhe, për rrjedhojë, mospërputhja e evidentuar midis shumës së likuiditeteve *cash* të deklaruar në deklaratën *Vetting* 2017 dhe asaj të përlogaritur referuar deklarimeve vjetore, do të vlerësohet në tërësi me rrethanat e çështjes që janë përcaktuese për vlerësimin e pasurive.

KONSTATIME TË TJERA

13. Apartament 2+1 i blerë nga Enti Kombëtar i Banesave, në rrugën “**”, Tiranë**

13.1. Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* 2017, administruar edhe nga EKB-ja²³⁶, rezulton se ndërmjet Drejtorisë Rajonale të EKB-së Tiranë dhe subjektit është lidhur kontrata provizore “Për shitje apartament banimi”, e datës 8.2.1995 për shitjen e apartamentit me adresë: ***, (2+1). Në kontratë parashikohet që me nënshkrimin e saj blerësi detyrohet të paguajë këstin prej 90.000 lekësh, si dhe detyrimi që merr subjekti për pagimin e kësteve. Në vijim, ndërmjet EKB-së Tiranë dhe shtetasve Kudusi Shahu, H. Sh., N. Sh., B. Sh., B. Sh. dhe E. Sh., është lidhur kontrata “Për shitje apartamenti me pagesë me këste” e datës 25.6.1996, për objektin me adresë rruga “****”, sip. 76.36 m², pallati nr. ***, h. ***, Tiranë.

13.2. Më pas, ndërmjet Drejtorisë Rajonale të EKB-së Tiranë dhe shtetasve Kudusi Shahu dhe E. Sh. është lidhur kontrata noteriale “Shitje me kusht” nr. ***, datë 20.4.1999, me objekt shitjen e apartamentit të përshkruar më sipër, ku përcaktohet edhe një herë çmimi i shitjes pas zbritjeve të punimeve deri në datën 31.12.1992, në masën 34.763 lekë, çmimi i apartamentit është në shumën 1.361.389 lekë.

13.3. Në përfundim, ndërmjet Drejtorisë Rajonale të EKB-së dhe shtetasve Kudusi Shahu, H. Sh., N. Sh., B. Sh., B. Sh. dhe E. Sh. është lidhur kontrata përfundimtare me nr. ***, datë 6.10.2004, e shitjes së apartamentit. Në dokumentacionin e përcjellë nga EKB-ja gjendet mandatarkëtimi nr. ***, datë 4.3.2003, në të cilin pasqyrohet: “*Arkëtuar nga Kudusi Shahu shuma në lekë 175.176, cash*”, si dhe mandatarkëtimi nr. ***, datë 4.3.2003, në të cilin pasqyrohet “*Arkëtuar nga Kudusi Shahu shuma 211.360 lekë për likuidim kësti + kamata*”.

13.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë nga EKB-ja rezulton se subjekti i rivlerësimit ka përfituar apartamentin si punonjës i Prokurorisë së Përgjithshme i transferuar,

²³⁶Shkresë nr. *** prot., datë 7.4.2022.

në zbatim të pikës 6²³⁷ të VKM-së Nr. 530, datë 17.10.1994, “Për mënyrën e ndarjes së apartamenteve të ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave”.

13.5. Rezulton që subjekti i rivlerësimit në seksionin e të dhënave konfidenciale të deklaratës *Vetting* 2017, pasi përshkruan si burim të ardhurat në vitet 1991 – 2004 dhe shitjen e apartamentit në rrugën “***” të përfituar nga EKB-ja në shumën 2.000.000 lekë, ka deklaruar se ky apartament përfundimisht është blerë në vlerën 175.176 lekë dhe se kjo kredi është likuiduar e gjitha nga babai i tij H. Sh. nga kursimet e tij.

13.6. Në procesverbalin e datës 1.2.2016, të ILDKPKI-së²³⁸, lidhur me kërkesën e inspektorit për sqarimin e arsyes së mosdeklarimit të shlyerjes në vitin 2004 të detyrimit ndaj EKB-së subjekti sqaron se: “*Kredia nga EKB-ja me VKM-në në atë periudhë është falur dhe unë kam paguar një diferencë të vogël në shumën rreth 200.000 lekë ...*”.

13.7. Në përfundim, Komisioni vëren se: (i) subjekti në deklaratën *Vetting* 2017 ka deklaruar se kredia me EKB-në është likuiduar e gjitha nga babai i tij H. Sh. nga kursimet e tij; (ii) në procesverbalin e datës 1.2.2016, të ILDKPKI-së²³⁹ ka deklaruar shlyerjen e kredisë në shumën 200.000 lekë, (iii) në mandatarëtimet që ndodhen në dosjen e dërguar nga EKB-ja²⁴⁰ lidhur me pagimin e kësteve të kredisë dhe në mandatarëtimet e mbylljes së kredisë²⁴¹ pasqyrohet se arkëtimet janë bërë nga z. Kudus Shahu; (iv) në pyetësorin nr. 1 subjekti ka deklaruar përfundimisht se kredia me EKB-në është shlyer nga ana e tij.

13.8. Sa më sipër, konstatohet se deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën *Vetting* 2017 se babai i tij ka shlyer kredinë me EKB-në nuk mbështetet në dokumentacionin justifikues.

13.9. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të paraqesë shpjegime në lidhje me konstatimin se *deklarimi i subjektit në deklaratën Vetting 2017 se babai i tij ka shlyer kredinë me EKB-në nuk mbështetet në dokumentacionin justifikues.*

13.10. Lidhur me këtë konstatim subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime në prapësimet e tij.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

13.11. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

13.12. Subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti shpjegime dhe dokumentacion në lidhje me konstatimin e Komisionit *se deklarimi i subjektit në deklaratën Vetting 2017 se babai i tij ka shlyer kredinë me EKB-në nuk mbështetet në dokumentacionin justifikues*, për rrjedhojë,

²³⁷“6. Ministrinë dhe institucionet shtetërore buxhetore bëjnë kërkesë pranë Këshillit të Ministrave për plotësimin e nevojave të punonjësve të tyre të lartë, ushtarakëve dhe zyrtarëve të tjerë të transferuar...”.

²³⁸Shkresë nr.*** prot., datë 8.4.2022.

²³⁹Shkresë nr. *** prot., datë 8.4.2022.

²⁴⁰Mandatarëtimet nr. ***, nr. ***, nr. ***, datë 30.9.1996, nr. *** dhe nr. ***.

²⁴¹Mandatarëtimet nr. ***, datë 4.3.2003, nr. ***, datë 4.3.2003.

subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin në deklaratën *Vetting* lidhur me shlyerjen e kredisë për këtë apartament nga babai i tij.

14. Automjet tip “Renault”, me targa *, me vlerë 600.000 lekë**

14.1. DPSHTRR-ja²⁴² informon se subjekti i rivlerësimit ka pasur të regjistruar automjetin me targa ***. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë rezulton se me kontratën e shitblerjes së automjetit të datës 23.8.1997 subjekti i rivlerësimit ka blerë nga shtetasi Sh. T. automjetin tip “Renault”, me nr. shasie ***, me ngjyrë të bardhë me targa ***, kundrejt vlerës 600.000 lekë, vlerë e cila është likuiduar në dorë. Gjithashtu, nuk konstatohet që ky automjet është çregjistruar.

14.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti në procesverbalin e datës 1.2.2016, të ILDKPKI-së²⁴³, konstatohet vërtetim i datës 22.11.2005, i DRSHTRR-së Tiranë me anë të të cilit ky institucion vërteton se automjeti me targa ***, tip “Renault”, forma autoveturë, me nr. identifikimi ***, në pronësi të shtetasit Kudusi Shahu, nuk ka paguar taksat e regjistrimit për vitet 2000 – 2005 dhe taksën e qarkullimit për vitin 2004 - 2005 pranë DRSHTRR-së Tiranë.

14.3. Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 1²⁴⁴, i kërkoi subjektit të shpjegonte burimin financiar të blerjes së automjetit, të deklaronte nëse e ka ende në pronësi dhe nëse jo, të paraqesë dokumentacion ligjor justifikues. Në përgjigje²⁴⁵ të tij, subjekti deklaroi se nga ana e tij janë bërë përpjekje për verifikimin e kësaj kontrate dhe nuk është bërë e mundur gjetja e saj. Gjithashtu deklaroi se do të japë shpjegime të mëtejshme vetëm pasi të sigurojë kopje të saj.

14.4. Më tej, subjekti depozitoi²⁴⁶ pranë Komisionit kopje të shkresës nr. *** prot., datë 13.7.2022, të DPSHTRR-së, nëpërmjet së cilës ky institucion informon subjektin se automjeti me targa *** ka ardhur nga automjeti me targa ***. Në vijim, sqaron se përpara vitit 1999 targa ish-in të riciklueshme dhe pasi automjeti i mësipërm ka kaluar në DPSHTRR Tiranë, targa *** i ka kaluar një automjeti tjetër që është autobus. Më pas, sqaroi se automjeti me targa ***, aktualisht, mban statusin çregjistrim i përhershëm për shkak se nuk ka kryer veprime në DPSHTRR që nga viti 2011 e më parë. Bashkëlidhur, i ka vënë në dispozicion kontratën e blerjes së automjetit. Gjithashtu, paraqiti kopje të kallëzimit penal të datës 15.7.2022 dhe vendimin e datës 25.7.2022, “Për mosfillimin e procedimit penal”, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.

14.5. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së kallëzimit penal dhe vendimit të prokurorisë rezulton se subjekti ka depozituar kallëzim penal ndaj noteres H. G. për kryerjen e veprës penale “falsifikim të dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, duke pretenduar se kontrata e shitblerjes së automjetit tip “Renault”, me targa ***, është e falsifikuar. Për vërtetimin e pretendimeve subjekti, në cilësinë e kallëzuesit, ka paraqitur aktekspertimin grafik të datës 15.7.2022. Në përfundim, prokurori i çështjes ka vendosur mosfillimin e çështjes me arsyetimin se vepra penale është parashikuar.

²⁴²Shkresë nr. *** prot., datë 21.7.2020

²⁴³Shkresë nr. *** prot., datë 8.4.2022.

²⁴⁴Email datë 21.6.2022.

²⁴⁵Protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.7.2022.

²⁴⁶Protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 1.8.2022.

14.6. DPSHTRR-ja²⁴⁷ informon Komisionin se automjeti me targa *** nuk ka kryer veprime pranë këtij institucioni, që kur është regjistruar në pronësi të z. Kudusi Shahu dhe sipas ligjit nr. 33/2017, automjeti është konsideruar jashtë qarkullimit, por pa bërë ndërhyrje në sistem apo në dosjen fizike, pasi ai nuk është çregjistruar me vullnet nga pronari i tij. Më pas sqaron se sipas sistemit të vjetër automjeti është në pronësi të z. Kudusi Shahu dhe se ky automjet nuk rezultoi në sistemin e ri, pasi nuk ka kryer veprime që kur është regjistruar nga z. Kudusi Shahu, për rrjedhojë as pagesa taksash.

14.7. Referuar fakteve të mësipërme, Komisioni, bazuar në nenin 659, e vijues të Kodit Civil dhe nenet 253 dhe 254²⁴⁸ të Kodit të Procedurës Civile, vlerëson se informacioni i paraqitur nga DPSHTRR-ja vërtetohet se automjeti me targa *** është në pronësi të subjektit. Kjo mbështetet edhe nga vërtetimi i datës 22.11.2005, i DRSHTRR-së Tiranë, i paraqitur nga ana e subjektit në procesverbalin e datës 1.2.2016, të ILDKPKI-së²⁴⁹. Si pasojë, duke iu referuar ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”²⁵⁰, vlerëson se mospagimi i taksave kombëtare të regjistrimit dhe qarkullimit të automjetit nuk është në përputhje me etikën e një magjistrati jashtë ushtrimit të funksionit të tij²⁵¹.

14.8. Për sa i përket analizimit të burimit për blerjen e kësaj pasurie, Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 1993 – 23.8.1997, duke konsideruar: (i) të ardhurat nga pagat e subjektit²⁵²; (ii) shpenzimet e jetesës; (iii) pagesat për EKB-në; (iv) blerjen e automjetit, nga ku rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime të ligjshme financiare në vlerën 390.206 lekë për blerjen e automjetit në datën 23.8.1997.

14.9. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi barrën e provës dhe i kërkoi subjektit të rivlerësimi të paraqesë shpjegime në lidhje me konstatimin se *subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime të ligjshme financiare në vlerën 390.206 lekë për blerjen e automjetit në datën 23.8.1997*.

14.10. Në përgjigje të rezultateve të hetimit²⁵³ subjekti i rivlerësimit shpjegoi se ky automjet nuk ka qenë asnjëherë në pronësinë e tij. Ai sqaron se sapo mori dijëni në lidhje me dosjen e këtij automjeti nga DPSHTRR-ja, ka bërë kallëzim në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kukës ndaj noteres H. G., për kryerjen e veprës penale “falsifikim të dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Për vërtetimin e pretendimeve të tij në cilësinë e kallëzuesit ka paraqitur aktekspertimin grafik të datës 15.7.2022, ku vërtetohet se shkrimi dhe nënshkrimi nën emrin e tij në cilësinë e blerësit në kontratën e datës 23.8.1997, nuk janë shkruar dhe nënshkruar

²⁴⁷Shkresë nr. *** prot., datë 22.7.2022.

²⁴⁸Neni 253 parashikon: “Aktet zyrtare që përpilohen nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë të deklarimeve që janë bërë përpara tyre për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre. Lejohet të provohet e kundërta vetëm kur pretendohet se shkresa është e falsifikuar”. Neni 254 parashikon: “Aktet zyrtare që dalin nga organet shtetërore dhe që përmbajnë një urdhër, një vendim ose çdo masë tjetër të marrë prej tyre ose që tregojnë kryerjen e një veprimi nga ana e këtyre organeve, përbëjnë provë të plotë për përmbajtjen e tyre. Lejohet të provohet e kundërta vetëm kur pretendohet se shkresa është e falsifikuar”.

²⁴⁹Shkresë nr. *** prot., datë 8.4.2022.

²⁵⁰Ligjit të kohës kur janë kryer këto veprime.

²⁵¹Vendimi nr. 75, datë 10.4.2002, i Gjykatës Kushtetuese.

²⁵²(1) Vërtetimi nr. ***, datë 24.10.2016, nga Prokuroria e Përgjithshme (për vitin 1994); (2) vërtetimi nr. ***, datë 25.10.2016, nga Prokuroria e Përgjithshme.

²⁵³(i) Parashtrime dhe prova të dorëzuara në datën 28.10.2022, me nr. *** prot., si dhe me email në datat 24.10.2022 dhe 25.10.2022; (ii) parashtrime dhe prova të dorëzuara në datën 5.12.2022, me nr. *** prot., si dhe me email në datat 3.12.2022 dhe 4.12.2022.

nga ana e tij. Po kështu, shpjegon subjekti, konstatohen gjeneralitete të pasakta që i përkasin atij.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

14.11. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

14.12. Pas analizimit të dokumentacionit të paraqitur dhe shpjegimeve të subjektit, duke konsideruar veçanërisht pasaktësitë e gjeneraliteteve të paraqitura në kontratën e shitblerjes së automjetit, të datës 23.8.1997, konkretisht të emrit dhe vitit të lindjes, Komisioni e vlerëson si të drejtë pretendimin e tij dhe, për rrjedhojë, nuk e përfshiu në analizën financiare vlerën prej 600.000 lekësh.

15. Analiza financiare për periudhat 1993 – 2003 dhe 2004 – 2016

15.1. Komisioni kreu analizën financiare kronologjike për periudhën 1993 – 2003 dhe analizën financiare vjetore për periudhën 2004 – 2016, për të ardhurat, shpenzimet, pasuritë dhe detyrimet e subjektit dhe personave të lidhur, duke i vendosur në dispozicion subjektit të rivlerësimit aneksin nr. 1 me emërtim “Analiza financiare” dhe aneksin nr. 2, me emërtim “Metodika e analizës financiare”.

15.2. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit në lidhje me konstatimet se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh financiare të ligjshme ndër vite, konkretisht: (i) për periudhën 1993 – 2003, mungesë në vlerën 8.373.890 lekë, barra e provës për të cilën ishte kaluar edhe në pikën 3.64 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) për vitin 2004, mungesë në vlerën 698.124 lekë, barra e provës për të cilën ishte kaluar edhe në pikën 3.64 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht; (iii) për vitin 2005, mungesë në vlerën 168.290 lekë për kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën në kursime, paraqitur e detajuar në aneksin nr. 1; (iv) për vitin 2006, mungesë në vlerën 462.762 lekë, barra e provës për të cilën ishte kaluar në pikën 4.37 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht për një balancë negative prej 800.000 lekësh; (v) për vitin 2007, mungesë në vlerën 209.225 lekë për kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën në kursime, paraqitur e detajuar në aneksin nr. 1; (vi) për vitin 2008, mungesë në vlerën 762.946 lekë për shlyerjen e detyrimeve dhe kryerjen e shpenzimeve, paraqitur e detajuar në aneksin nr. 1; (vii) për vitet 2009-2010-2011, mungesë në vlerën 10.883.467 lekë, barra e provës për të cilën ishte kaluar edhe në pikën 5.53 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht; (viii) për vitin 2012, mungesë në vlerën 1.013.488 lekë për shlyerjen e detyrimeve dhe kryerjen e shpenzimeve, paraqitur e detajuar në aneksin nr. 1; (ix) për vitin 2014, mungesë në vlerën 809.336 lekë, barra e provës për të cilën kishte kaluar në pikën 6.26 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht për një balancë negative prej 1.404.600 lekësh; (x) për vitin 2015, mungesë në vlerën 768.862 lekë, paraqitur e detajuar në aneksin nr. 1; (xi) për vitin 2016, mungesë në vlerën 350.736 lekë, paraqitur e detajuar në aneksin nr. 1.

15.3. Në përgjigje të rezultateve të hetimit²⁵⁴, subjekti i rivlerësimit parashtrroi edhe një herë pretendimet e tij lidhur me përllogaritjen e shpenzimeve për jetesë, përllogaritjen e gabuar të vlerës së shlyerjes së tokës në shumën 7.200 USD, përcaktimin e vlerës së banesës 2 kate + papafingo + bodrum me sip. totale 436,1 m², me vlerë 4.000.000 lekë, në Tiranë, mospërfshirjen e të ardhurave të siguruar nga mësimdhënia e bashkëshortes, analizën e gabuar për sa i përket vitit 2006 lidhur me pasurinë apartament me sip. 60 m², me vlerë 50.500 euro në Tiranë, mospërfshirjen e të ardhurave nga vëllai B. Sh., mospërfshirjen e të ardhurave nga qiraja, mospërfshirjen e huas nga shtetasi B. H. (të afërmit e tij në Francë), përdorimi i shumës prej 30.000 euro dhe lidhur me burimin e pasurisë garazh.

15.4. Më tej, subjekti parashtrroi pretendime lidhur me përllogaritjen e shpenzimeve për udhëtimet e tij dhe të familjarëve jashtë vendit, duke pretenduar që këto shpenzime janë përllogaritur tej normës së duhur, çka ka shkaktuar rëndimin e këtij zëri, në kushtet që subjekti ka deklaruar që këto shpenzime janë përballuar nga të afërmit e tij, duke depozituar edhe deklaratat nga mikpritësit.

15.5. Gjithashtu, në lidhje me shlyerjen e detyrimit kundrejt shtetasit F. K. në shumën 1.500.000 lekë në vitin 2012, subjekti sqaroi se në likuiditetin e disponuar nga ana e tij në këtë vit, ka qenë e përfshirë edhe një huadhënie afat shkurtër marrë shtetasit Sh. Xh., në shumën 5.500 euro dhe kthyer në vitin pasardhës në dhjetor të vitit 2013 (me aktivitet tregtar në mallra ushqimor). Subjekti shpjegoi se nuk e ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2012, pasi mendonte që do ta likuidonte për një kohë të shkurtër dhe, nisur nga fakti që nuk ishte formalizuar me deklaratë noteriale, nuk e deklaroi në deklaratën periodike përkatëse.

15.6. Për sa i përket shpenzimit të kryer në SHBA, në vlerën e 121.735 lekë, subjekti sqaroi se ky shpenzim ka qenë për blerjen e dy lojrave *play station* të kërkuara nga një mik i tij dhe se në çdo rast nuk do t'i duheshin dy lojra të tilla për fëmijët e tij.

15.7. Në përfundim, bashkëlidhur parashtrimeve të tij²⁵⁵, subjekti paraqiti tabelën e analizës financiare dhe shpjegoi se të ardhurat totale për të gjithë periudhën 1991 – 2016 janë në shumën 39.917.130 lekë, ndërsa pasuria *neto* e krijuar për të gjithë periudhën që nga viti 1991 deri në vitin 2016 është në shumën 26.361.012 lekë. Diferencat negative prej 481.560 lekësh të paraqitura në këtë analizë janë minimale dhe ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzimet e jetesës dhe me mosdeklarimin e të ardhurave nga qiraja në vitet 2011 - 2012 dhe mosdeklarimin e të ardhurave të bashkëshortes nga kurset private të mësimdhënies në vitin 2012, vijoi subjekti. Këto diferenca negative në vlera të vogla, nisur nga parimi i proporcionalitetit dhe qëndrimet tashmë të konsoliduara të vetë Komisionit apo edhe Kolegjit nuk janë penalizuese, përfundoi subjekti.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

15.8. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe

²⁵⁴(i) Parashtrime dhe prova të dorëzuara në datën 28.10.2022, me nr. *** prot., si dhe me *email* në datat 24.10.2022 dhe 25.10.2022; (ii) parashtrime dhe prova të dorëzuara në datën 5.12.2022, me nr. *** prot., si dhe me *email* në datat 3.12.2022 dhe 4.12.2022.

²⁵⁵Parashtrime dhe prova të dorëzuara në datën 5.12.2022, me nr. *** prot., si dhe me *email* në datat 3.12.2022 dhe 4.12.2022.

provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

15.9. Për sa i përket pretendimeve të subjektit të shtjelluara në paragrafin nr. 15.3, Komisioni vëren se ato janë trajtuar dhe arsyetuar në paragrafët përkatës të këtij vendimi.

15.10. Lidhur me vlerën e shpenzimeve të udhëtimit, Komisioni çmon të theksojë se këto shpenzime janë përllogaritur bazuar në praktikën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit²⁵⁶, siç është shpjeguar në metodikën e analizës financiare, e cila i është vënë në dispozicion subjektit bashkëlidhur relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht. Në përputhje me këtë praktikë, për udhëtimet gjatë të cilëve subjekti dhe familjarët kanë qëndruar tek të afërm dhe miq, konfirmuar nga këta të fundit, Komisioni ka përllogaritur shpenzime qëndrimi në masën 5 euro/ditë përkundrejt masës prej 50 euro/dita që do të ishte përllogaritur në rastet e udhëtimeve të tjera. Pretendimi i subjektit se nuk janë konsideruar shpjegimet dhe dokumentacioni i paraqitur nga ana e tij lidhur me udhëtimet tek të afërmit, nuk është i bazuar dhe, për rrjedhojë, ky zë shpenzimi mbetet i pandryshuar në analizën financiare.

15.11. Komisioni nuk i gjen bindëse shpjegimet e subjektit lidhur me marrëdhënien e huas afatshkurtër me shtetasin Sh. Xh., pasi kjo hua nuk është deklaruar në DIPP-të përkatëse, sipas kërkesave ligjore dhe, për më tepër, ky pretendim është ngritur për herë për parë pas kalimit të barrës së provës, çka krijon bindjen se ky shpjegim është diktuar nga rezultati i analizës financiare.

15.12. Për sa i përket pretendimit lidhur me blerjet e kryera në SHBA, Komisioni i vlerëson bindëse shpjegimet e subjektit, duke konsideruar natyrën e kësaj blerjeje dhe, për rrjedhojë, korrigjoi analizën financiare duke mos e pasqyruar këtë shpenzim.

15.13. Në përfundim të arsyetimit lidhur me të gjitha pretendimet e subjektit, Komisioni paraqiti analizën financiare përmbledhëse, si në tabelën vijuese.

Tabela nr. 2 – analiza financiare

Viti	Pasuri	Ndryshim likuiditete <i>cash</i>	Ndryshim likuiditete bankë	Të ardhurat	Detyrimet	Shpenzime	Diferenca për shpenzime
1993 – 2003	7,529,870	869,520	0	4,775,773	0	2,476,953	-6,100,570
2004	4,000,000	-869,520	0	3,018,277	0	585,921	-698,124
2005	0	0	518,987	1,036,340	0	685,643	-168,290
2006	6,173,120	0	-157,885	1,247,301	5,000,000	694,828	-462,762
2007	0	0	397,444	1,280,081	0	1,091,862	-209,225
2008	0	0	-439,123	1,497,040	-1,500,000	1,199,109	-762,946
2009	7,552,500	0	804,350	1,665,170	2,975,000	1,016,735	-4,733,415
2010	0	0	1,093,821	1,866,961	-1,388,100	1,527,492	-2,142,452
2011	0	0	816,561	1,938,209	-2,383,000	1,421,248	-2,682,600
2012	0	0	-229,760	1,701,669	-1,500,000	1,444,917	-1,013,488
2013	0	500,000	-79,203	2,009,586	0	1,584,686	4,104
2014	0	900,000	-82,110	2,228,284	0	2,097,994	-687,600
2015	1,404,600	-300,000	118,795	2,313,419	0	1,858,886	-768,862
2016	0	1,000,000	112,988	2,614,124	0	1,851,872	-350,736
TOTAL	26,660,090	2,100,000	2,874,866	29,192,234	1,203,900	19,538,145	-20,776,967

²⁵⁶Vendim nr. 11-2019 (JR), datë 22.5.2019.

15.14. Komisioni mban në konsideratë që në këtë rezultat nuk janë përfshirë shpenzimet e mobilimit për katër banesat e subjektit, çka do të thotë që balanca negative do të duhet të ishte më e thelluar.

15.15. Në përfundim, përveç konkluzioneve mbi balancat negative në momentin e krijimit të pasurive, me një vlerë totale prej 17.157.161 lekësh, trajtuar në seksionin përkatës të pasurisë²⁵⁷, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë mungesë të burimeve të ligjshme financiare për kryerjen e shpenzimeve, shtesën e kursimeve dhe shlyerjen e detyrimeve, në vlerën 3.961.148 lekë, për vitet 2005, 2007, 2008, 2012, 2014, 2015 dhe 2016, duke u gjendur në kushtet e germës “b” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

Konkluzioni lidhur me vlerësimin e pasurisë

15.16. Në vlerësim të sa më sipër, trupi gjykues i Komisionit vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësim të pasurisë dhe gjendet në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

1. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 4.8.2020, të deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 4.8.2020, të KDZH-së, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

2. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit Kudus Shahu: (a) ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar; (b) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ai në deklaratën për kontrollin e figurës; (c) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat të mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

3. Komisioni kërkoi nga DSIK-së rishikimin e raportit mbi kontrollin e figurës të z. Kudus Shahu. DSIK-ja me shkresën nr. ***, datë 31.5.2022, informon se nuk u administruan të dhëna shtesë lidhur me subjektin dhe, si pasojë, nuk ndryshon konstatimi fillestar për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.

4. Pavarësisht raportit të dërguar nga DSIK-ja, Komisioni ka kryer hetim administrativ, prej të cilit rezulton se konstatimet e Grupit të Punës për kontrollin e figurës janë të sakta.

²⁵⁷Për pasurinë banesë 2 kate + papafingo + bodrum me sipërfaqe totale 436,1 m², në Tiranë (në vlerën 6.100.570 lekë gjatë periudhës 1993 – 2003 dhe 698.124 lekë gjatë vitit 2004); për pasurinë apartament banimi me sip. 60 m², me vlerë 50.500 euro, në Tiranë (në vlerën 800.000 lekë, në datën 15.9.2006); për pasurinë apartament me sip. 95 m², me vlerë 57.000 euro në ***, Kavajë, për 9.558.467 lekë për vitet 2009, 2010 dhe 2011).

5. Bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni vlerëson se: (a) subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratën për kontrollin e figurës në kohën e përcaktuar nga ligji nr. 84/2016; (b) nuk ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar; (c) nuk ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kontrollin e figurës, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

1. Sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, relatori përgatit relacionin për vlerësimin e aftësive profesionale mbështetur në raportin e inspektorëve, informacionin e marrë nga burime të tjera, si dhe në kriteret e vlerësimit, të parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve dhe akteve të tjera ligjore.

2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

3. Ky raport i ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) aftësive profesionale;
- b) aftësive organizative;
- c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale;
- ç) aftësive personale dhe angazhimit profesional.

4. Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit së bashku me tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin, të paraqitura nga subjekti; (ii) pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga 23 prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë, Drejtorisë së Përgjimeve të Telekomunikimit dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informativë dhe Zyra e Informacionit të Klasifikuar, sektori i protokoll-arkivit, si dhe burimet arkivore të sektorit të burimeve njerëzore dhe marrëdhënieve me publikun në Prokurorinë e Përgjithshme.

5. Nga shqyrtimi i të dhënave në dosjen personale konstatohet se subjekti i rivlerësimit në periudhën 30.7.1991 – 19.10.1995 ka ushtruar detyrën e hetuesit, fillimisht në Kukës dhe më pas në Prokurorinë e Përgjithshme. Në datën 1.2.1995 është emëruar prokuror ushtarak në Drejtorinë e Ushtrisë në Prokurorinë e Përgjithshme. Në datën 9.12.1996 komandohet prokuror në Prokurorinë e Apelit Ushtarak Tiranë. Në datën 8.1.1998 emërohet prokuror ushtarak në Prokurorinë e Përgjithshme. Në datën 18.6.2008 caktohet zv/Drejtues në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në datën 28.5.2013 emërohet prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme. Në datën 8.1.2015 transferohet prokuror në Prokurorinë për Krimet e Rënda. Në datën 14.12.2015 transferohet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në datën 12.12.2019, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor, kthehet si prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

Aftësitë profesionale

Njohuritë ligjore

Nga analiza e tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, vëzhgimi i 4 dosjeve gjyqësore të shortuara dhe aktit të shfuqizimit, rezulton se prokurori Kudusi Shahu, sa i përket periudhës së rivlerësimit, shfaq aftësi në drejtim të zbatimit të ligjit dhe identifikon saktë normën ligjore të zbatueshme. Në vlerësimin e punës së subjektit të rivlerësimit, prokurorit Kudusi Shahu, për vitin 2016, të bërë nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se për aftësitë profesionale në cilësinë e prokurorit, ai është vlerësuar “shumë mirë”.

Arsyetimi ligjor

Nga analiza e tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, vëzhgimi i katër dosjeve gjyqësore të shortuara dhe aktit të përpiluar nga prokurori në Prokurorinë e Përgjithshme, evidentohet se subjekti i rivlerësimit Kudusi Shahu shfaq aftësi në arsyetimin ligjor. Tek aktet e përgatitura nga subjekti i rivlerësimit konstatohet se nga ana e tij bëhet analizë mbi rrethanat e faktit dhe provave të mbledhura, duke shprehur qëndrimin e tij logjik mbi zgjidhjen ligjore.

Hetimi i Komisionit

Pavarësisht raportit të dërguar nga KLP-ja, Komisioni kreu një hetim të pavarur në lidhje me tri dokumentet e përzgjedhura nga subjekti dhe me pesë dosjet e shortuara sipas një shorti objektiv. Pas analizimit të tyre u konstatuan problematika dhe u kërkuan shpjegime për dosjen nr. 2 të shortuar si vijon:

Lidhur me dosjen nr. 2, që i përket procedimit penal nr. ***, viti 2014, datë 28.9.2015, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë të regjistruar për veprën penale “trafikim i personave të rritur”, të parashikuar nga neni 110/a/1 i Kodit Penal. Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit për konstatimin se *subjekti nuk ka administruar pyetjen e shtetasit G. P. nga autoritetet maqedonase*.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit²⁵⁸ subjekti i rivlerësimit shpjegon se vendimi i datës 28.9.2015 për pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. ***, viti 2014, është marrë shkak për moskonsumimin e afateve të hetimit të procedimit penal. Gjithashtu shpjegon se vendimi është logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje dhe se argumentet e pjesës arsyetuese janë të bazuara dhe të lidhura logjicisht në arsyet e vendimmarrjes në këtë rast.

Analiza e Komisionit

Nga shqyrtimi i akteve të dosjes penale rezulton se në datën 26.4.2014 është paraqitur në Komisarjatin e Policisë Kavajë shtetasja E. B., e cila ka kallëzuar se është trafikuar nga shtetasi A. H.. Në kallëzimin e saj kjo shtetase deklaroi se ka shkuar në Maqedoni nëpërmjet një mikut të saj dhe shtetasit A. H. (i cili i ka thënë se i kishte gjetur një burrë në Maqedoni për lidhje serioze). Fillimisht ka folur në internet me këtë shtetas, i quajtur G. P., bashkë me A.. Më pas, në datën 18.4.2014, shtetasi A. H. së bashku me G. e nënën e tij dhe një djalë tjetër si përkthyes, kanë shkuar tek banesa e E. dhe janë takuar më të dhe me nënën e saj. Nga aty ata janë nisur për në Maqedoni së bashku me E.. Kur kanë shkuar në Maqedoni, në Ohër, ku banonte G. P.,

²⁵⁸Shpjegime shtesë lidhur me relacionin e rezultateve të hetimit kryesisht për kriterin e rivlerësimit të figurës dhe të aftësive profesionale (protokolluar me nr. *** prot., datë 2.12.2022 në Komision).

ata kanë ndenjtur një kohë të shkurtër e më pas A. është kthyer për në Shqipëri. Para se të ikte, A. ka qëndruar për pak minuta vetëm me G. P., ndërkohë, E. ka dëgjuar gjatë bisedave me njëritjetrin fjalët “pare pare”. Ditën e nesërme, G. ka pyetur E. se çfarë pune dinte të bënte dhe ajo i ka thënë se kishte rreth 5 vjet që punonte si parukiere. Ai e ka pyetur nëse bënte punë tjetër, ajo e habitur e ka pyetur se për çfarë pune e kishte fjalën. G. P. i ka thënë se i kishte dhënë A. 1.200 euro për të punuar diçka tjetër e jo parukiere, ndërkohë E. i ka thënë se kishte shkuar atje sepse donte të fejohej dhe jo për të punuar nga ato punë që mund të mendonte ai. Në këto kushte, E. i ka kërkuar G. P. të kthehet në Shqipëri, por ai i ka thënë se pa ardhur A. dhe pa i kthyer eurot që ka marrë nuk do ta linte të ikte për në Shqipëri. Nga këmbëngulja e saj, G. P. ka rënë dakord se do ta kthente pas disa ditësh në Shqipëri. Në datën 22.4.2014, kur është kthyer, E. i ka kërkuar A. sqarime dhe, pas kësaj, ka bërë kallëzim në Komisariatin e Policisë Kavajë.

Komisioni arsyeton se nga analizimi i elementeve të figurës së veprës penale “trafikim të personave të rritur”, të parashikuar nga neni 110/a²⁵⁹ i Kodit Penal, rezulton se që të ketë ekzistencën e veprës penale “trafikim të njerëzve”, normalisht, duhet të jenë të pranishëm elementi i veprimit, i qëllimit dhe mjeti kriminal që synon arritjen e qëllimit të shfrytëzimit (veprimi, mjeti dhe qëllimi).

Në rastin konkret rezulton se subjekti i rivlerësimit, me vendimet e datës 19.2.2015, 19.5.2015 dhe 19.8.2015, ka vendosur zgjatjen e afatit të hetimeve, pasi ka çmuar, ndërmjet të tjerave, se do të shihet mundësia e dërgimit të letërporosisë autoritetit gjyqësor kompetent të shtetit të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë për pyetjen e disa shtetasve maqedonas, në cilësinë e personave që kanë dijani për veprën penale. Në vijim, konstatohet se me shkresën nr. ***, prokuroria e shkallës së parë i është drejtuar Drejtorisë së Bashkëpunimit Gjyqësor Ndërkombëtar duke kërkuar që të pyetet shtetasi G. P. nëse njihet me shtetasen E. B., me personat që e kanë prezantuar dhe me shtetasin A. H. etj. Kjo shkresë i është përcjellë Ministrisë së Drejtësisë së ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë me shkresën e datës 4.6.2015 nga Ministria e Drejtësisë. Nga shqyrtimi i dosjes penale nuk rezulton që të jetë administruar pyetja e shtetasit G. P. nga autoritetet maqedonase. Gjithashtu, në vendimin e pushimit subjekti nuk ka parashtruar arsyet e mosadministrimit të marrjes në pyetje të këtij shtetasi dhe nuk ka arsyetuar pse ka çmuar që marrja në pyetje e tij konsiderohet e panevojshme për hetimin.

Lidhur me shpjegimin e subjektit të rivlerësimit se vendimi i është marrë për shkak të moskonsumimit të afateve të hetimit, Komisioni arsyeton se neni 324²⁶⁰ i Kodit të Procedurës

²⁵⁹Kodi Penal, neni 110/a parashikon: “Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e personave nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës ose përfutimit nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike ose dhënies apo marrjes së pagesave ose përfutimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër, me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, të skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, të vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, dënohen me burgim nga tetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Kur kjo veprë kryhet ndaj një personi të rritur të gjinisë femërore dënohet me burgim nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet. Organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të personave dënohen me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet. Kur kjo veprë kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë, shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike ndaj të dëmtuarit, për të kryer veprime të ndryshme, sjell pasojë të rënda për shëndetin, ose rrezikon jetën e tij, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet. Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm. Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik, dënimi me burgim shtohet me ¼ e dënimit të dhënë”.

²⁶⁰Kodi i Procedurës Penale, neni 324 parashikon: “Zgjatje të mëtejshme, secila për një kohë jo më shumë se tre muaj, mund të bëhen nga prokurori në rastet e hetimeve komplekse ose të pamundësisë objektive për t'i përfunduar ato brenda afatit të zgatur. Kohëzgjatja e hetimeve paraprake nuk mund të kalojë dy vjet. Tejt afatit 2-vjeçar, në raste të jashtëzakonshme, afati i

Penale parashikon zgjatje të afateve të hetimeve në rastet kur hetimet janë komplekse ose në pamundësi objektive për t'i përfunduar ato brenda afatit, të cilat nuk mund të kalojnë 2 vjet. Megjithatë, tej afatit 2-vjeçar, në raste të jashtëzakonshme, afati i hetimit mund të zgjatet me miratim të Prokurorit të Përgjithshëm deri në 1 vit. Në rastin konkret, procedimi penal është regjistruar në datën 2.5.2014 dhe në datën 19.5.2014 është regjistruar emri i personit të cilit i atribuohet vepra penale, ndërsa vendimi i subjektit për pushimin e procedimit penal është marrë në datën 28.9.2015 (pas pothuajse 1 viti e 4 muaj), shumë kohë përpara përfundimit të afatit maksimal të zgjatjes së hetimeve. Sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit kishte të gjitha mundësitë ligjore për zgjatjen e afatit të hetimeve deri në administrimin e marrjes në pyetje të shtetasit G. P. nga autoritetet e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Gjithashtu, rezulton se në vendimin e pushimit subjekti i rivlerësimit nuk ka parashtruar arsyet e mosadministrimit të marrjes në pyetje të shtetasit G. P., arsye të cilat i paraqiti vetëm gjatë shpjegimeve lidhur me rezultatet e hetimit të Komisionit.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore bazuar në treguesin e aftësisë së përgjithshme për të interpretuar ligjin, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj dhe në aspektin e arsytimit ligjor bazuar në treguesin e cilësisë së analizës, kriteret të parashikuara nga pikat 2 dhe 3 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

Aftësitë organizative

Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit, për periudhën e punës si prokuror pranë gjykatave të rrethit, ka trajtuar 226 çështje. Nga gjetjet në dokumentet ligjore të përzgjedhura në bazë të shortit të zhvilluar për periudhën e vlerësimit tetor 2013 – tetor 2016, rezulton se nga ana e prokurorit Kudusi Shahu tregohet vëmendje në kryerjen e veprimeve hetimore në dinamikë dhe në respektim të afateve ligjore të kërkuara, duke i dhënë një zgjidhje të shpejtë çështjeve të trajtuara.

Aftësia për të kryer procedurat hetimore/ gjyqësore

Konstatohet se, nga ana e subjektit të rivlerësimit, veprimet dhe procedurat në kuadër të procedimeve penale dhe materialeve kallëzuese u referohen dispozitave ligjore përkatëse, duke mbledhur provat dhe aktet e nevojshme dhe konkluduar në një vendimmarrje. Lidhur me njoftimet e vendimmarrjeve konstatohet se është respektuar detyrimi për të kryer njoftimet përkatëse subjekteve.

Aftësia për të administruar dosjet

Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira në drejtim të përfundimit të hetimeve, rregullsisë së akteve dhe mbajtjes së tyre. Dosjet e vëzhguara janë të rregullta, të plota dhe aktet procedurale të përpiluara, janë të strukturuar dhe në respektim të normave të drejtshkrimit.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

Etika në punë

Rezulton se nuk janë gjetur të dhëna që të tregojnë se nga ana e subjektit të jenë kryer veprime apo mbajtur qëndrime të tilla, jo në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

hetimit mund të zgjatet vetëm me miratim të Prokurorit të Përgjithshëm deri në 1 vit, për çdo zgjatje jo më shumë se tre muaj, pa cenuar afatet e kohëzgjatjes së paraburgimit”.

Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Kudusi Shahu. Në asnjë prej dokumenteve dhe dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Gjithashtu, asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

Aftësia e komunikimit

Nga tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë dosjet e rëna në short vihet re se komunikimi është në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

Aftësia për të bashkëpunuar

Rezulton se nga subjekti i rivlerësimit është treguar kujdes i veçantë për bashkëpunimin me institucionet e tjera, të cilat janë të angazhuara me ndjekjen penale. Gjithashtu rezulton se subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë e bashkëpunimit në vlerësimin e vitit 2016 të Prokurorit të Përgjithshëm.

Gatishmëria për t’u angazhuar

Prokurori Kudusi Shahu, nga të dhënat në dosjen personale, ka pjesëmarrje në 7 trajnime. Lënda e trajnimeve ku ka marrë pjesë ka lidhje me detyrën e prokurorit.

Të dhëna nga burimet arkivore të KLP-së dhe Prokurorisë së Përgjithshme

6. Nga verifikimi në arkivin e Prokurorisë së Përgjithshme rezulton se z. Kudusi Shahu, me detyrë prokuror aktualisht në Prokurorinë e Përgjithshme, ka pasur një masë disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra” në vitin 2004, që korrespondon me kohën kur ka qenë me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

6.1. Nga verifikimet pranë prokurorive të rretheve gjyqësore për kallëzime ose procedime në të cilat përmendet emri i prokurorit Kudusi Shahu, Këshilli i Lartë i Prokurorisë është informuar se:

6.2. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka informuar Këshillin e Lartë të Prokurorisë se ka regjistruar kallëzimin penal nr. *** në ngarkim subjektit të rivlerësimit Kudusi H. Shahu, për të cilin është marrë vendimi i mosfillimit të procedimit penal në datën 19.9.2018.

6.3. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka informuar se ndaj shtetasit Kudusi Shahu është regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda kallëzimi penal me nr. ***, viti 2019, për të cilin pas verifikimit është vendosur mosfillim procedimi.

Hetimi i Komisionit

*Lidhur me kallëzimin penal nr. ***, të regjistruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë i ka dërguar për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës kallëzimin penal të bërë nga shtetasit P. T. dhe H. T., të cilët kanë kallëzuar faktin se kanë blerë një banesë tek ish-*** nga shtetasit S. dhe S. T., objekt i vetëdeklaruar për legalizim me nr. ***, datë 13.9.2006, por vëllezërit B. dhe K. C., fqinjë, po mundohen me të gjitha mënyrat për t'i përzënë nga kjo banesë pasi kanë pretendime pronësie. Këta persona pretendojnë që banesa është e tyre dhe se me veprime konkrete kanë shkatërruar banesën, e cila tashmë është bërë e pabanueshme. Për këtë problem kanë bërë kallëzime disa herë si në polici ashtu edhe në prokurori. Kallëzimi i fundit është hetuar nga prokurori Kudusi Shahu, i cili, sipas kallëzuesve, ka mbajtur një qëndrim të njëanshëm duke favorizuar palën e kallëzuar dhe me vendimin e datës 11.4.2018, duke vendosur pushimin e hetimeve pasi nuk ka vepër penale. Me shkresën nr. *** prot., datë 13.9.2018, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka dërguar aktet e kallëzimit penal nr. ***, datë 30.3.2018, në Prokurorinë e Rrethit Durrës.*

Nga shqyrtimi i dosjes penale që i përket kallëzimit penal nr. ***, datë 30.3.2018, dhe materialeve kallëzuese të administruara, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit për konstatimin se *subjekti nuk ka kryer veprimet hetimore pasi: (i) nuk ka caktuar një ekspert për verifikimin e dëmit të shkaktuar; (ii) nuk ka administruar dokumentacionin e paraqitur nga kallëzuesi dhe i kallëzuar pranë ALUIZNI-t; (iii) nuk ka marrë në pyetje kallëzuesin.*

Në përgjigje të rezultateve të hetimit²⁶¹, subjekti i rivlerësimit ka dhënë këto shpjegime: *Lidhur me konstatimin e pikës (i) shpjegon se referuar procesverbalit të këqyrjes së vendngjarjes dhe tabelës fotografike rezulton se pasojat, haptazi, dukeshin se ishin të papërfillshme pasi bëhej fjalë për një banesë të ndërtuar me blloqe betoni, e amortizuar ndër vite dhe e pabanueshme, madje po t'i referohesh aktekspertimit të mëvonshëm rezulton se vlera e dëmit është 58.776 lekë. Lidhur me konstatimin e pikës (ii) shpjegon se në zyrat e ALUIZNI-t ka bërë vetëdeklarim për legalizim objekti në datën 13.9.2006 shtetasi S. T. e, më pas, në datën 29.9.2015, kanë bërë vetëdeklarim për legalizim objekti shtetasit P. dhe H. T., por nuk rezulton të ketë të dhëna se cilit objekt i referohen në vetëdeklarim. Gjithashtu, shpjegon se edhe në kallëzimet e tjera penale të këtyre shtetasve është vendosur mosfillimi i hetimeve, pasi fakti nuk parashikohej nga ligji si vepër penale. Lidhur me konstatimin e pikës (iii) nuk ka dhënë shpjegime.*

Analiza e Komisionit

Nga shqyrtimi i akteve të dosjes penale rezulton se në datën 26.3.2018, në Komisariatën e Policisë Nr. *** Tiranë, është paraqitur shtetasi H. A. T., i cili ka kallëzuar se ka një banesë në pronësinë e tij, i vetëdeklaruar për legalizim me nr. ***, datë 13.9.2006, me adresë rruga "****" ose me adresat e reja quhet rruga "****". Aktualisht, në këtë banesë nuk jeton njeri pasi jetojnë në Itali. Për këtë banesë vazhdimisht ka pasur konflikt me shtetasit K. C., B. C. dhe I. C., vëllezër me njëri-tjetrin, pasi, sipas tij, këta shtetas nuk e kanë lejuar që ta posedojë lirshëm këtë banesë. Gjithashtu ka pretenduar se në datën 22.3.2018 kohë kur është kthyer nga Italia, ka konstatuar se banesës i ishin hequr dritaret së bashku me zgarën metalike, si dhe nuk e kanë

²⁶¹Shpjegime shtesë lidhur me relacionin e rezultateve të hetimit kryesisht për kriterin e rivlerësimit të figurës dhe të aftësive profesionale (protokolluar me nr. *** prot., datë 2.12.2022, në Komision).

lejuar të futet në banesë, pasi pretendojnë se kjo banesë është e tyrja, ndonëse nuk disponojnë asnjë dokument pronësie. Subjekti i rivlerësimit, me vendimin e datës 11.4.2018, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal me arsyetimin se në rastin konkret kanë të bëjnë me një marrëdhënie juridiko-civile.

Kundër vendimit të subjektit të rivlerësimit ka bërë ankim kallëzuesi dhe rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. *** akti, datë 30.5.2018, ka vendosur pranimin e kërkesës së ankuesit H. T. dhe kthimin e akteve të kallëzimit penal nr. ***, të vitit 2018, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për vijimin e hetimeve, duke arsyetuar se prokurori nuk ka parashtruar në asnjë moment rezultatet e këqyrjes në terren nga Komisariati Nr. *** i Policisë Tiranë, e cila shoqërohet edhe me fotot përkatëse, ku evidentohet një banesë në gjendje të degraduar, porta hyrëse është e bllokuar dhe nuk pasqyrohet fakti se për të kaluar në këtë banesë grupi i këqyrjes ka përdorur hyrjen nga banesa e shtetasit B. C. Gjithashtu, arsyeton gjykata, nuk rezulton që shtetasi B. C. të jetë pyetur lidhur me hapjen e kësaj porte dhe mbylljen e portës kryesore dhe shtetasi H. T. vetëm ka paraqitur kallëzimin përpara oficerit të policisë gjyqësore, por nuk është marrë në pyetje. Në vendimin e mosfillimit, vijon arsyetimin gjykata, prokurori ka konstatuar dëmtimin e pronës, por nuk shprehet se këto dëmtime nuk kanë ardhur nga shtetasi B. C..

Komisioni, duke analizuar elementet e figurës së veprës penale “shkatërrim prone” të parashikuar nga neni 150²⁶² i Kodit Penal, arsyeton se objekti i kësaj vepre penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura nga shteti për siguruar paprekshmërinë e pronësisë mbi sendet e personave private, personave juridikë dhe të shtetit. Nga ana objektive kjo vepër penale konsumohet nëse i pandehuri me veprimet e mosveprimet e tij cenon një nga tagrat e të drejtës së pronësisë²⁶³ që konsistojnë në shkatërrimin apo dëmtimin e pronës. Shkatërrimi nënkupton asgjësimin e plotë të pasurisë, prishjen, thyerjen, prerjen etj., ndërsa dëmtimi nënkupton prishjen e pjesshme të vlerës ekonomike të pasurisë, keqësimin e cilësisë që nuk i përgjigjet më destinacionit pa u riparuar. Në lidhje me objektin material, ndaj të cilit drejtohen edhe veprimet e autorit të krimit të shkatërrimit të pronës, kërkohet që sendi pronë private ose publike të ketë vlerë ekonomike, të mos jetë hedhurinë. Në lidhje me anën subjektive vepra penale “shkatërrim prone”, parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal kërkon si formë faji dashjen e drejtpërdrejtë dhe e rëndësishme është që autori i saj të veprojë me vullnet dhe ndërgjegje të plotë për të shkatërruar me dashje pronën e tjetrit, qoftë ajo private apo publike. Në këtë kuptim, autori duket të ketë dijeni se sendi i shkatërruar apo dëmtuar i përket dikujt tjetër.

Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit në vendimin e mosfillimit të procedimit penal nuk ka marrë në konsideratë procesverbalin e këqyrjes së vendngjarjes, si dhe nuk ka analizuar nëse në rastin konkret vërehen ose jo elemente të shkatërrimit apo dëmtimit të banesës objekt hetimi. Dhe në vijim të ndjekjes logjike të hetimit, me qëllim provimin e pasojës së ardhur, nuk ka caktuar një ekspert për verifikimin e dëmit të shkaktuar. Në këto kushte rezulton se subjekti nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore në drejtim të verifikimit nëse është konsumuar elementi i anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal. Për sa i përket shpjegimit të tij në përgjigje të rezultateve të hetimit se dëmet ishin të papërfillshme pasi bëhej fjalë për një banesë të ndërtuar me blloqe betoni, e amortizuar ndër vite dhe e

²⁶²Kodi Penal, neni 150 parashikon: “Shkatërrimi apo dëmtimi me dashje i pronës, kur pasojat materiale nuk janë të lehta, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në 3 vjet”.

²⁶³Të cilat sipas neneve 149 dhe 259 të Kodit Civil janë gëzimi, disponimi dhe përdorimi i pronës.

pabanueshme, rezulton se ky arsyetim nuk pasqyrohet në vendimin e mosfillimit të procedimit penal.

Në vijim, rezulton që shtetasi i kallëzuar B. C. nuk është pyetur lidhur me mbylljen e portës kryesore të objektit të pretenduar nga shtetasi H. T.. Gjithashtu, rezulton se shtetasi H. T. vetëm ka paraqitur kallëzimin përpara oficerit të policisë gjyqësore, por nuk është marrë në pyetje.

Komisioni konstaton se si kallëzuesi dhe i kallëzuari kanë pretenduar që banesën objekt konflikti e kanë deklaruar për legalizim. Nga shqyrtimi i materialeve të dosjes penale nuk rezulton që subjekti të ketë administruar dokumentacionin e paraqitur nga të dyja palët pranë ALUIZNI-t, me qëllim qartësimin e faktit lidhur me përkatësinë e banesës objekt konflikti. Referuar dokumentacionit të administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës konstatohen 2 formularë vetëdeklarimi për legalizim, formulari i datës 23.8.2006 i shtetasit B. C. për objektin “godinë 2kt” me sipërfaqe ndërtimi 70 m², si dhe formulari i datës 13.9.2006, i shtetasit S. T. për objektin “shtëpi” me sip. ndërtimi 108 m², që duket se janë dy objekte të ndryshme. Administrimi dhe analizimi i dokumentacionit të mësipërm do t'i shërbente subjektit të rivlerësimit për verifikimin e faktit nëse autori i dyshuar ka pasur ose jo dijeni që objekti i shkatërruar apo dëmtuar i përket dikujt tjetër, me qëllim arritjen e përfundimit nëse nga autori i dyshuar është konsumuar ose jo elementi i anës subjektive i veprës penale të parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal. Si pasojë, rezulton se subjekti nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore në drejtim të verifikimit të anës subjektive të veprës penale të parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal.

Për sa i përket shpjegimit të subjektit të rivlerësimit se edhe pas heqjes dorë nga procedimi Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka kërkuar nga gjykata pushimin e procedimit penal me të njëjtat argumente, Komisioni arsyeton se bazuar në pikën 4 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, në vlerësimin e aftësive profesionale janë çmuar aftësitë e subjektit të rivlerësimit për të hetuar dhe për të ndjekur logjikisht hetimin pa gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore bazuar në treguesin e aftësisë së përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, kriter i parashikuar në pikën 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

DENONCIME

Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Kudus Shahu janë administruar 6 denoncime nga publiku. Referuar nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kërkoi shpjegime për 4 denoncime, si vijon:

7. Denoncimet nr. * prot., datë 16.1.2018, nr. *** prot., datë 23.1.2018 dhe nr. *** prot., datë 15.11.2018, të shtetasit B. B.**, i cili akuzon subjektin e rivlerësimit për moskryerjen e veprime hetimore dhe marrjen e vendimit për pushimin e procedimit penal nr. ***, datë 5.4.2017. Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit shpjegime lidhur me pretendimet e denoncuesit.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit²⁶⁴ subjekti i rivlerësimit shpjegon se ka trajtuar fillimisht materialin kallëzues të shtetasit B. B. për veprat penale “ndërtim i paligjshëm” dhe “shpërdorim detyrë” të parashikuara nga nenet 199/a dhe 248 të Kodit Penal dhe më pas në datën 17.5.2016

²⁶⁴Shpjegime shtesë lidhur me relacionin e rezultateve të hetimit kryesisht për kriterin e rivlerësimit të figurës dhe të aftësive profesionale (protokolluar me nr. *** prot., datë 2.12.2022, në Komision).

ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal. Në vijim shpjegon se në datën 24.5.2016 është bërë zëvendësimi i tij me prokuroren D. S. dhe, në këto kushte, mendon se denoncimi i shtetasit B. B. se hetimi është i paplotë dhe ka zgjatur 13 muaj, nuk i përket atij si prokuror. Për vërtetimin e deklarimeve të tij ka paraqitur dokumentacionin justifikues²⁶⁵.

Referuar dokumenteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni konstaton se subjekti, bazuar në materialin kallëzues të shtetasit B. B., me urdhrin “Për regjistrimin e procedimit penal”, datë 17.5.2016, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprat penale “ndërtim i paligjshëm” dhe “shpërdorim detyre” të parashikuara nga nenet 199/a dhe 248 të Kodit Penal. Më pas rezulton se Drejtuesi i Prokurorisë me vendimin “Mbi zëvendësimin e prokurorit”, të datës 31.5.2016, ka urdhëruar zëvendësimin e prokurorit Kudusi Shahu me prokuroren D. S. në ndjekjen, drejtimin dhe kontrollin e hetimeve të procedimit penal nr. ***, viti 2016. Më pas rezulton se prokurorja D. S. me vendimin e datës 5.4.2017 ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. ***, viti 2016. Sa më sipër, provohet se procedimi penal për të cilin ankohet denoncuesi B. B. nuk është ndjekur nga subjekti.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se nuk konstatohen problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

8. Denoncim anonim nr. *, datë 1.11.2022**, në të cilin denoncuesi ka akuzuar subjektin se në procedimin penal nr. ***, viti 2018, ka tejkalluar afatet ligjore, nuk ka bërë ankimin e detyruar, ka kërkuar shtyrjen e afatit të hetimeve pa arsyetim dhe, si pasojë, është kthyer procesi.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit²⁶⁶ subjekti i rivlerësimit shpjegon se në datën 22.4.2018 shtetasi A. M., duke qarkulluar me automjetin e tij, ka goditur shtetasin A. Sh., i cili po lëvizte me biçikletë. Si rezultat i goditjes, ky i fundit është rrëzuar në tokë duke pësuar dëmtime trupore dhe është dërguar në QSUT në gjendje të rëndë për jetën. Nga punonjësit e policisë rrugore është mbajtur procesverbali i kapjes në flagrancë dhe është arrestuar shtetasi A. M. Më pas, në datën 23.4.2018, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal nr. ***, në ngarkim të shtetasit A. M. për kryerjen e veprës penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, të parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal.

Lidhur me këtë ngjarje është kryer aktekspertimi mjeko-ligjor i datës 8.5.2018, ku janë konstatuar dëmtimet trupore të shtetasit A. Sh., si dhe fakti se këto dëmtime kanë qenë të rrezikshme për jetën në çastin e shaktimit të tyre. Gjithashtu, është kryer aktekspertimi autoteknik i datës 24.4.2018, ku është konkluduar se nga ana e drejtuesit të automjetit me targa ***, shtetasit A. M., nuk konstatohen shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor, ndërsa nga ana e drejtuesit të biçikletës, shtetasit A. Sh., konstatohen shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor dhe pikërisht të nenit 152, pika 1, germa “a”. Në kushtet kur nuk provohej se shtetasi A. M. ka konsumuar veprën penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, të parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal, i është kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë miratimi i pushimit të hetimeve për procedimin penal nr. ***, viti 2018.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. *** akti, datë 16.11.2018, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorisë, pushimin e procedimit penal nr. ***, viti 2018, në ngarkim

²⁶⁵Shkresa nr. *** prot., datë 1.4.2016, e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë; formular për trajtimin e materialit kallëzues datë 5.4.2016; urdher për regjistrimin e procedimit penal, datë 17.5.2016; vendim mbi zëvendësimin e prokurorit datë 31.5.2016; vendim për pushimin e procedimit penal nr. ***, viti 2017.

²⁶⁶Shpjegime shtesë lidhur me relacionin e rezultateve të hetimit kryesisht për kriterin e rivlerësimit të figurës dhe të aftësive profesionale (protokolluar me nr. *** prot., datë 2.12.2022, në Komision).

të personit nën hetim A. M. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 1.2.2019, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. *** akti, datë 16.11.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kthimin e akteve Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vazhdimin e hetimeve. Në përmbajtjen e vendimit Gjykata e Apelit ka arsyetuar se ka mangësi në lidhje me hetimin e çështjes, pasi aktekspertimi është kryer nga punonjës policie dhe jo nga ekspertë rrugorë, inxhinier autoteknik apo inxhinier mekanik, njohuritë e të cilit janë të domosdoshme për të përcaktuar dhe llogaritur distancat nga pikëpamja aritmetike dhe se duhet kryer riekspertimi nga një grup ekspertësh me njohuri të posaçme në këtë fushë. Në përfundim, Gjykata e Apelit Tiranë ka lënë afat për përfundimin e hetimeve brenda 60 ditëve. Rezulton se vendimi nr. *** akti, datë 16.11.2018, i ndryshuar, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është protokolluar në Prokurorinë e Rrethit Tiranë në datën 18.2.2019, ndërsa aktet i janë kthyer prokurorisë në datën 12.3.2019.

Në vijim, subjekti i rivlerësimit shpjegon se në datën 12.3.2019 ka vendosur kryerjen e riekspertimit autoteknik me grup ekspertësh, të cilët në aktekspertimin nr. ***, datë 21.3.2019, kanë konkluduar se shkakua determinant i ardhjes së pasojës është si rezultat i shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor nga drejtuesi i automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa ***, konkretisht nenit 139/1/2 të Kodit Rrugor me drejtues shtetasin A. M.. Si pasojë, vijon subjekti, në kushtet kur kishte një aktekspertim autoteknik që konkludonte se drejtuesi i automjetit nuk kishte faj dhe një akt tjetër që konkludonte se drejtuesi i automjetit kishte faj dhe sipas tij grupi i ekspertëve nuk i kishte dhënë përgjigje disa pyetjeve dhe nuk kishte sqaruar disa rrethana, në datën 6.5.2019 ka vendosur riekspertimin autoteknik me një grup prej 5 ekspertësh, të cilët në aktekspertimin nr. ***, datë 3.6.2019, kanë konkluduar se shkakua determinant i ardhjes së pasojës është shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor nga viktimja A. Sh., veprim i cili është në shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor, të përcaktuara nga neni 152, pika 1, germa “a”: “... ndryshimi i drejtimit apo korsisë ose manovra të tjera”. Gjithashtu, shpjegon subjekti i rivlerësimit, nga pamjet filmike të sekuestruara vërehet se shkakua kryesor i ardhjes së këtyre pasojave janë veprimet e gabuara të viktimës. Më pas, subjekti, me kërkesën e datës 17.6.2019, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për pushimin e procedimit penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. *** akti, datë 13.11.2019, vendosi kthimin e akteve prokurorisë për vazhdimin e hetimeve me arsyetimin se aktekspertimi autoteknik i datës 3.6.2019 është i papërdorshëm, pasi është realizuar tej afatit 60-ditor të përcaktuar nga vendimi nr. ***, datë 1.2.2019, i Gjykatës së Apelit Tiranë. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim shtetasi A. M. dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 19.10.2022, ka vendosur mospranimin e ankimit pasi ankuesi nuk legjitimohej.

Në vijim të shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit sqaron se si pasojë e vendimit nr. ***, datë 11.11.2019, të Gjykatës Administrative me urdhrin nr. ***, datë 12.12.2019, të Prokurorit të Përgjithshëm është kthyer në detyrën e prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme. Për vërtetimin e deklarimeve të mësipërme, subjekti ka paraqitur dokumentacionin provues²⁶⁷.

Analiza e Komisionit

Nga shqyrtimi i vendimeve gjyqësore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit rezulton se aktekspertimi autoteknik i datës 24.4.2018 është kryer nga punonjës policie dhe jo nga ekspertë

²⁶⁷Vendimi nr. *** akti, datë 16.11.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; vendimi nr. ***, datë 1.2.2019, i Gjykatës së Apelit Tiranë; vendimin nr. ***, datë 19.10.2022, i Gjykatës së Apelit Tiranë.

rrugorë, inxhinier autoteknik apo inxhinier mekanik, njohuritë e të cilit janë të domosdoshme për të përcaktuar dhe llogaritur distancat nga pikëpamja aritmetike. Si pasojë, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 179²⁶⁸ të Kodit të Procedurës Penale, pasi gjatë hetimeve paraprake ka administruar aktekspertimin autoteknik të hartuar nga persona që nuk kanë pasur njohuri të posaçme në këtë fushë.

Në vijim, Komisioni konstaton Gjykata e Apelit Tiranë, në vendimin nr. ***, datë 1.2.2019, ka lënë afat për përfundimin e hetimeve brenda 60 ditëve dhe vendimi i Gjykatës së Apelit është protokolluar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 18.2.2019, ndërsa aktet i janë kthyer prokurorisë në datën 12.3.2019. Kjo do të thotë se subjekti i rivlerësimit ka pasur afat për të administruar prova në kuadër të hetimeve deri në datën 11.5.2019. Në vijim, konstatohet se subjekti i rivlerësimit në datën 12.3.2019 ka vendosur kryerjen e riekspertimit autoteknik, duke caktuar një grup prej 3 ekspertësh. Në kushtet kur riekspertimi ka konkluduar se drejtuesi i automjetit është fajtor për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor, përfaqësuesi i tij ka bërë kërkesë për ribërjen e aktekspertimit autoteknik. Subjekti i rivlerësimit, me vendimin e datës 6.5.2019, ka vendosur kryerjen e riekspertimit nga një grup prej 5 ekspertësh, të cilët e kanë realizuar aktekspertimin në datën 3.6.2019, duke konkluduar se aksidenti ka ardhur si pasojë e shkeljes së rregullave të qarkullimit nga viktimat. Më pas, subjekti, me kërkesën e datës 17.6.2019, i është drejtuar gjykatës së rrethit për pushimin e procedimit penal. Sa më sipër, konstatohet se subjekti ka administruar aktekspertimin autoteknik të datës 3.6.2019, tej afatit 60-ditor të përcaktuar nga vendimi nr. ***, datë 1.2.2019, i Gjykatës së Apelit Tiranë, duke vepruar në kundërshtim me nenin 325 të Kodit të Procedurës Penale, që përcakton se: *“3/1. Kur ankimi pranohet, por hetimet duhet të vazhdojnë, gjykata urdhëron prokurorin t’i përfundojë ato brenda një afati të caktuar prej saj. Provat e marra brenda këtij afati janë të përdorshme”*. Si pasojë, subjekti ka administruar dhe ka paraqitur në gjykatë prova të papërdorshme.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në treguesin e aftësisë së përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore dhe për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, kritere të parashikuara në pikën 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

KONSTATIME TË TJERA

9. Nga informacioni i administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë²⁶⁹ lidhur me të dhënat e sistemit TIMS (duke përfshirë automjetet dhe personat me të cilët ka udhëtuar subjekti) rezulton se subjekti në datën 8.11.2016 ka dalë nga territor shqiptar në pikën kufitare K. me automjetin me targa ***, në pronësi të shtetasit N. P.. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë²⁷⁰ informon se ndaj shtetasit N. P. janë regjistruar 26 procedime penale në periudhën 2011 – 2022 për veprat penale: “mashttrim”, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal; “punësim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 170/a i Kodit Penal; “pengim i ekzekutimit të vendimeve të gjykatës”, parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal; “vetëgjyqësia”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal; “pastrimi i produkteve të veprës penale” dhe “falsifikim dokumentesh”, parashikuar nga nenet 287 dhe 186 të Kodit Penal; “vjedhje pasurie” dhe

²⁶⁸Kodi i Procedurës Penale, neni 179 parashikon: *“Caktimi i ekspertit bëhet duke e zgjedhur atë ndërmjet personave që janë regjistruar në librat e caktuar për këtë qëllim ose ndërmjet atyre që kanë njohuri të posaçme në degën përkatëse”*.

²⁶⁹Shkresë nr. *** prot., datë 8.4.2022.

²⁷⁰Shkresë nr. *** prot., datë 12.10.2022.

“shkatërrim prone”, parashikuar nga nenet 134 dhe 150 të Kodit Penal. Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit për konstatimin se *subjekti nuk ka treguar kujdesin e duhur në rastin e përdorimit të automjetit të shtetasit N. P. gjatë kohës që ky shtetas ishte i akuzuar për kryerjen e një vepre penale.*

9.1. Në përgjigje të rezultateve të hetimit²⁷¹ subjekti i rivlerësimit shpjegon se njohja me shtetasin N. P. dhe familjen e tij ka ndodhur në fillim të muajit tetor 2014, kur babai i tij H. Sh. ishte në spital, pikërisht në dhomën ku ndodhej i shtruar vjehri i tij, shtetasi Sh. H. Në vijim, shpjegon se gjatë qëndrimit në spital të babait të tij ka marrë vesh që ai ishte një nga ndërtuesit e parë, por nuk ka diskutuar lidhur me problemet e tij. Pas vdekjes së babait, shpjegon subjekti i rivlerësimit, kontaktet me këtë shtetas janë rralluar. Lidhur me përdorimin e automjetit shpjegon se lëvizja e tij ka qenë rastësore, pasi është takuar rastësisht me shtetasin N. P., i cili i ka thënë që do të nisej për në Greqi, ndërkohë që edhe ai planifikonte të shkonte në Greqi te djali i tezes, shtetasi S. H.. Në vijim, shpjegon se pavarësisht se duhet të ishte treguar më i kujdesshëm, mendon që kjo nuk përbën arsye të ketë konflikt interesi, sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016. Për të vërtetuar këtë deklaramin subjekti ka paraqitur kartelën mjekësore dhe vërtetimin nga QSUT-ja për shtetasit Sh. H. dhe H. Sh.

Analiza e Komisionit

Nga shqyrtimi i dosjeve penale të përcjella nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë rezulton se në datën 10.3.2015, Prokuroria, mbi bazën e kallëzimit të disa shtetasve, ka regjistruar procedimin penal nr. *** për veprën penale “mashttrim”, të parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal në ngarkim të shtetasit N. P. Po në këtë datë, shtetasi N. P. është arrestuar në flagrancë nga policia gjyqësore. Më pas rezulton se me vendimin nr. ***akti, datë 13.3.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur vleftësimin si të paligjshëm të “arrestit në flagrancë” dhe detyrimin e personit nën hetim N. P. për t’u paraqitur përpara policisë gjyqësore çdo ditë, ora 12:00. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 2.4.2015, ka vendosur mospranimin e ankimit.

Më pas rezulton se prokurori i çështjes, me vendimin e datës 25.1.2016, ka vendosur marrjen e shtetasit N. P. si të pandehur dhe njoftimin e akuzës dhe, në vijim, në shkurt të vitit 2016 (mungon data) ka paraqitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë kërkesën për gjykimin e çështjes në ngarkim të të pandehurit N. P., për veprën penale “mashttrim”, të parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 7.7.2016, ka vendosur pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit me arsyetimin se në rastin konkret nuk ka elemente të anës objektive dhe subjektive të figurës së veprës penale “mashttrim”, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal, pasi mosmarrëveshja është juridiko-civile, ku palët kanë të drejta dhe detyrime ndaj njëri-tjetrit dhe zgjidhet në një gjykim civil. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim prokuroria në datën 14.7.2016 dhe në seancën gjyqësore të datës 20.2.2019, në Gjykatën e Apelit Tiranë, prokurori ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga ankimi dhe si pasojë Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin e datës 28.2.2019, ka vendosur mospranimin e ankimit.

Sa më sipër, konstatohet se subjekti ka përdorur automjetin me targa ***, në pronësi të shtetasit N. P. gjatë kohë kur ky shtetas ishte i akuzuar për kryerjen e veprës penale “mashttrim”, të

²⁷¹Shpjegime shtesë lidhur me relacionin e rezultateve të hetimit kryesisht për kriterin e rivlerësimit të figurës dhe të aftësiwe profesionale (protokolluar me nr. *** prot., datë 2.12.2022, në Komision).

parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal dhe ndaj të cilit vijonte gjykimi. Komisioni vlerëson se pavarësisht se shtetasi N. P. nuk ishte i akuzuar për veprat penale të parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, subjekti i rivlerësimit duhet të kishte treguar kujdesin e duhur lidhur me kontaktet e tij me shtetasin N. P. dhe përdorimin e automjetit të tij.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka treguar kujdesin e duhur në rastin e përdorimit të automjetit në pronësi të shtetasit N. P., konstatim që është vlerësuar në tërësi me rrethanat e çështjes që janë përcaktuese në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

Përfundimet e Komisionit në lidhje me rivlerësimin e aftësive profesionale

Pavarësisht sa më sipër, në raport me të gjitha çështjet e analizuara, Komisioni, duke marrë në konsideratë numrin e çështjeve penale të analizuara në raport me çështjet penale të ndjekura nga subjekti i rivlerësimit për periudhën 8.10.2013 – 8.10.2016, faktin se nuk konstatohen raste të gjyqimeve me gabime thelbësore dhe serioze, bazuar edhe në parimin e proporcionalitetit, vlerëson se konstatimet e pasqyruara në kriterin e rivlerësimit të aftësive profesionale nuk plotësojnë kushtin e parashikuar nga pika 4 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, që subjekti i rivlerësimit të konsiderohet “i papërshtatshëm”.

Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit, në vlerësimin tërësor të kriterit të rivlerësimit të aftësive profesionale, vlerëson se subjekti i rivlerësimit Kudus Shahu është “i aftë”, pasi ka treguar cilësi të pranueshme në punë, ka respektuar të drejtat e palëve dhe është eficient në masë të pranueshme.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR LIDHUR ME PROCESIN E RIVLERËSIMIT

➤ Për kriterin e pasurisë

Lidhur me pasurinë banesë 2 kate + papafingo + bodrum me sipërfaqe totale 436.1 m², në Tiranë

- i. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të pasaktë në deklaratën e pasurisë *Vetting*, duke mos deklaruar kohën e fillimit dhe përfundimit të punimeve të ndërtimit, në kundërshtim me përcaktimet e nenit D, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe të shtojcës nr. 2 të ligjit nr. 84/2016, të cilat kërkojnë përcaktimin e qartë të kohës së krijimit të pasurive në pronësi, që deklarohen në deklaratën e pasurisë *Vetting*, situatë faktike, që bie ndesh me parashikimet e nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.
- ii. Subjekti dhe personat e lidhur kanë mungesë të burimeve të ligjshme financiare: (1) në vlerën 6.100.570 lekë gjatë periudhës 1993 – 2003 për kryerjen e shpenzimeve, shtesën e kursimeve, blerjen e pasurive dhe kryerjen e investimit në banesën objekt analize, duke u gjendur në kushtet e germës “b” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016; (2) në vlerën 698.124 lekë gjatë vitit 2004 për kryerjen e shpenzimeve dhe të investimit në banesën objekt analize, duke u gjendur në kushtet e germës “b” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me pasurinë apartament banimi me sip. 60 m², me vlerë 50.500 euro, në Tiranë

Subjekti dhe personat e lidhur kanë mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën 800.000 lekë, në datën 15.9.2006, për blerjen e apartamentit me sip. 60 m², në Tiranë, duke u gjendur në kushtet e germës “b” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me pasurinë apartament me sip. 95 m², me vlerë 57.000 euro, në ***, Kavajë

Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie, për kryerjen e shpenzimeve, shlyerjen e detyrimeve dhe shtesën e kursimeve, me një balancë negative prej 9.558.467 lekësh për vitet 2009, 2010 dhe 2011 (vitet gjatë të cilëve janë kryer pagesat për këtë apartament), duke u gjendur në kushtet e germës “b” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me pasurinë garazh me sip. 24.5 m², në vlerën 10.000 euro, në Tiranë

Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, germa “a” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me analizën financiare vjetore për vitet 2005, 2007, 2008, 2012, 2014, 2015 dhe 2016

Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë mungesë të burimeve të ligjshme financiare për kryerjen e shpenzimeve, shtesën e kursimeve dhe shlyerjen e detyrimeve, në vlerën 3.961.148 lekë, për vitet 2005, 2007, 2008, 2012, 2014, 2015 dhe 2016, duke u gjendur në kushtet e germës “b” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim të analizimit të kriterit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

➤ **Për kriterin e kontrollit të figurës**

Subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, duke u gjendur në kushtet e germës “b” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

➤ **Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale**

Subjekti i rivlerësimit arrin nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, duke u gjendur në kushtet e germës “c” të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në provat që disponon për vlerësimin e pasurisë, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, vendosi që subjekti i rivlerësimit Kudusi Shahu, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Prokurorisë së Përgjithshme, t’i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet Ç, D dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, si dhe në pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Kudusi Shahu, prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 12.12.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Suela ZHEGU
Kryesuese

Etleda ÇIFTJA
Relatore

Xhensila PINE
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Resilda Bilaj